ISSN 0253-1607

60
2021

monumentet

monumentet



60/2021

Monumentet

MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
TIRANË

Monumentet

60/2021

Redaksia

Prof. Dr.	Pirro THOMO	Kryeredaktor
	Arta DOLLANI	Zv. Kryeredaktor
Dr.	Rudina ZOTO	Anëtar
	Daniel PIRUSHI	Anëtar
Prof. Dr.	Florian NEPRAVISHTA	Anëtar
Prof. Dr.	Gjerak KARAISKAJ	Anëtar
Prof. Dr.	Iris POJANI	Anëtar
Dr.	Era XHAFERAJ	Anëtar
	Marsela PLYKU	Anëtar
	Mimoza ZERECI	Anëtar
	Joli MITROJORGJI	Anëtar

Ky numër i kushtohet personaliteteve të mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore të larguar nga jeta dhe atyre që kremtojnë përvjetorët e tyre.

ISSN 0253-1607

Copyright: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Botim i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

Tiranë, 2021

Në kopertinë: Kisha e Shën Salvadorit (Shpëtimtarit) në Rubik, Mirditë (Pas restaurimit, 2021)

Shtypshkronja: KRISTALINA-KH

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

Faqe

I. IN MEMORIAM 11

ARK. GANI STRAZIMIRI, veprimtaria 13
Gani STRAZIMIRI
Qytetet muze në R. P. të Shqipërisë, Qyteti Muze i Beratit 25

MAKS VELO, veprimtaria.....47
Maks VELO
Dekori i thjeshtë linear në gur.....53

KLITI KALLAMATA, veprimtaria 61
Kliti KALLAMATA
Mbi restaurimin e Pazarit të Korçës..... 69

MUSTAFA ARAPI, veprimtaria 75
Mustafa ARAPI
Konservimi dhe restaurimi i pjesës qendrore të ikonabartësit të
kishës së Evangjelizmos të Kalasë së Beratit 91

SULEJMAN DASHI, veprimtaria.....103
Sulejman DASHI
Kullat mesjetare në vendin tonë 109

II.ARTIKUJ, RECENSA 117

Elio HOBDARI

Jamarbër BUZO

Rudina PAPAVASILI

Ndërhyrje të propozuara restaurimi në nekropolin verilindor të Amantias 119

Petrit BILALI
Dr. Era XHAFERAJ
“Dy rrugët” – Kolë Idromeno. Drejt një riinterpretimi kritik të veprës 143

Dritan ÇOKU
Xhamia në fshatin Vokopolë të Beratit 151

Mariglen MESHINI
Kriledjan ÇIPA
Arjol PORJA
Dorina GJERGJI
Ela MIZIRI
Raporti paraprak i gërmimeve arkeologjike në Amantia gjatë vitit 2020 163

Frederik STAMATI
Migena DIBRA
Mbi konservimin e flamurit të Kongresi te Lushnjës 173

Prof. Dr. Aleksandër MEKSI
Gjerak Karaiskaj, Fortifikimet e Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës në Shqipëri,
qytete, kala, kështjella, Tiranë 2021, Recension 181

As. Prof. Dr. Armand VOKSHI
Pirro Thomo, Vendbanime e banesa të Shqipërisë Veriore, Tiranë, 2021, Recension 185

III. KRONIKË PUNIMESH RESTAURUESE 189

Kisha e Shën e Premtes, Lukovë 191
Ndërhyrje emergjente në kishën e Shën Kollit Vodicë, Kolonjë..... 197
Kisha e Shën Salvadorit (Shpëtimtarit) në Rubik, Mirditë..... 201
Kisha e Shën Ndoit në Kepin e Rodonit..... 209
Kulla C e mureve fortifikuese të Durrësit.....213
Ndërhyrje emergjente në Kullën e Sahatit në Kalanë e Krujës..... 221
Kisha e Shën Thanasit, Voskopojë 227

TABLE OF CONTENTS

Page

I. IN MEMORIAM 11

ARK. GANI STRAZIMIRI, activity 16

Gani STRAZIMIRI
Museum Cities in P. R. of Albania. Museum City of Berat..... 43

MAKS VELO, activity 49
Maks VELO
Simple linear decor in stone 59

KLITI KALLAMATA, activity 64
Kliti KALLAMATA
Sur la restoration du Bazar de Korça 74

MUSTAFA ARAPI, activity 78
Mustafa ARAPI
La conservation et la restauration de la partie centrale de l'iconostase
de l'eglise Evangelique dans la Citadelle de Berat 101

SULEJMAN DASHI, activity 106
Sulejman DASHI
Les tours de l'horloge moyenageuses de notre pays 115

II. ARTICLES, REVIEWS 117

Elio HOBDARI
Jamarbër BUZO
Rudina PAPAVASILI
Proposal for Restoration in Northeastern Necropolis of Amantia 142

Petrit BILALI
PhD. Era XHAFERAJ
“Two Paths of Life” – Kolë Idromeno. Toward a Reinterpretation
of the Painting 148

Dritan ÇOKU
The Mosque in the Vokopola Village of Berat 163

Mariglen MESHINI
Kriledjan ÇIPA
Arjol PORJA
Dorina GJERGJI
Ela MIZIRI
Preliminary Report of Archeological Excavations in Amantia during 2020 172

Frederik STAMATI
Migena DIBRA
On the Conservation of the Flag of Lushnja Congress 179

Prof. Dr. Aleksandër MEKSI
Gjerak KARAISKAJ, Late Antiquity and Medieval Fortifications in Albania,
Cities, Fortresses, Castles, Tirana 2021. Review 183

As. Prof. Dr. Armand VOKSHI
Pirro Thomo, Settlements and Dwellings of Northern Albania,
Tiranë, 2021, Review 187

III. CHRONICLE OF RESTORATION WORKS 189

Church of St. Friday, Lukova 191
Emergency intervention in the church of St. Nicolas Vodica, Kolonjë 197
Church of Ascension in Rubik, Mirdita 201
Church of St. Anthony on Cape Rodon 209
Tower C of the fortification walls of Durrës 213
Emergency intervention in the Clock Tower in Kruja Castle 221
Church of St. Athanasius, Voskopoja 227

IN MEMORIAM

ARKITEKT GANI STRAZIMIRI



Arkitekt Gani Strazimiri, Drejtor i parë i Institutit të Monumenteve të Kulturës, figurë e shquar e fushës të vlerësimit të monumenteve ndërtimore në Shqipëri.

Gani Strazimiri (1915-1993) ka lindur në Maqellarë (Peshkopi). Me prirje të theksuara për fushat e artit dhe veprimtarisë ndërtimore, kreu shkollën e mesme artistike në Tiranë, në degën e pikturës. Vazhdoi studimet e larta për arkitekturë në Universitetin Politeknik të Torinos, të cilat i ndërpreu për shkak të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Kthehet në atdhe dhe përfshihet në Luftën Antifashiste N. Çl. Pas çlirimit të vendit dhe përfundimit të Luftës II Botërore ai filloi studimet e larta në Moskë, në degën e arkitekturës.

Me kthimin në Atdhe, G. Strazimiri u emërua në ndërmarrjen 'Projekti', më e njohura për nivelin profesional dhe kërkesat e larta ndaj veprimtarive projektuese të objekteve shoqërore, krahas objekteve të banimit.

Në vitin 1957 G. Strazimiri kalon përfundimisht në fushën e studimeve të trashëgimisë arkitekturore dhe emërohet drejtues i Grupit të Kulturës Materiale të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë. Ky Grup formohej prej tre njësish: të Arkeologjisë, të Historisë së Artit dhe Arkitekturës, si dhe atij të Mbrojtjes dhe Restaurimit të Monumenteve.

G. Strazimiri dallohej për ndjekjen e vijueshme të veprimtarive kërkimore-studimore, përzgjedhjen e punonjësve kryesisht prej aftësisë dhe përkushtimit profesional. Edhe në këtë veprimtari, G. Strazimiri zbatoi parimin e ndarjes së fushave të studimit të kuadrove të reja. Sot, pas një përvoje krahasimisht të gjatë studimore, kjo ndarje e kryer prej drejtorit të Grupit të Kulturës Materiale shfaqet thellësisht e drejtë dhe frytdhënëse, duke rritur ndjeshëm profesionalizmin e kuadrove, e cila dha rezultatet e saj, si në vënien në mbrojtje të gjinive të ndryshme të monumenteve, në përkujdesjen dhe restaurimin e tyre, ashtu dhe në numrin e botimeve shkencore të artikujve dhe monografive.

Arritja madhore në këtë veprimtari ishte dhe vënia në mbrojtje shtetërore të qyteteve të Gjirokastrës dhe Beratit, nëntoka e Durrësit dhe pazari i Vjetër i Krujës, me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 172, dt. 2.06.1961. Krahas miratohet dhe

Rregullorja e administrimit të Qytetit-muze të Beratit. Edhe sot, mbas 60 vjetëve, kjo Rregullore mbetet model për kompetencën shkencore, për qartësinë, për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara të mbrojtjes së vlerave arkitekturore të qytetit të Beratit, duke krijuar njëkohësisht dhe një përvojë tashmë konkrete për vënien në mbrojtje dhe të Qendrave të tjera Historike të Shqipërisë. Referati i G. Strazimirit mbi vënien në mbrojtje të Qyteteve-muze të Beratit dhe Gjirokastrës, i mbajtur në Kongresin e ICOMOS-it në Selanik të Greqisë gjatë datave 3-10 tetor 1973 ishte një surprizë për pjesëmarrësit, ngjalli shumë komente dhe e renditi Shqipërinë në vendet pararojë të vlerësimit të Qendrave Historike. Kongresi i Selanikut kishte një pjesëmarrje shumë të gjerë, ku bënin pjesë shumë nga hartuesit e Kartës së Venecies, si Piero Gazzola, Raymond Lemaire, Gertrud Trip, Jan Zachwatovicz, Eustathios Stikas, si dhe personalitete të tjera të shquara nga bota e rajoni, si, G. Kozhuharov e R. Angelova nga Bullgaria, G. Jonesko dhe V. Dragut nga Rumania, B. Cipan nga ish Jugosllavia, N. Motsopoulos, G. Lavas etj. nga Greqia, C. Erder nga Turqia e shumë të tjerë nga bota.

Në 25-31 maj 1964, së bashku me A. Meksin, merr pjesë në Konferencën II Ndërkombëtare të Arkitektëve dhe Teknikëve të Monumenteve Historike në Venecie, ku votuan për miratimin e Kartës Ndërkombëtare të Konservimit dhe Restaurimit të Monumenteve dhe Siteve, që njihet si Karta e Venecies. Bashkë me Kartën e Venecies sollën dhe frymën e saj, që u bë për kuadrin e ri të fushës së monumenteve, ashtu si për gjithë botën, dokumenti bazë udhëheqës për mbrojtjen, studimin, konservimin e restaurimin e monumenteve të kulturës.

G. Strazimiri ishte i bindur se problematika tepër e gjerë e mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve nuk mund të zgjidhej nga organizimi aktual me varësi të trefishtë, nga Grupi i Kulturës Materiale, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë dhe Universiteti Shtetëror i Tiranës. Vështirësitë shfaqeshin si në shtimin e kuadrit, fondet e deri te strukturat ndihmëse, transportit, laboratorët etj., të cilat ndaheshin me fakultetet, katedrat e institucionet e shumta të Universitetit. Me insistimin e G. Strazimirit u bë e mundur që mbi bazën e sektorit të Mbrojtjes dhe Restaurimit të Monumenteve të Grupit të Kulturës Materiale të formohet në vitin 1965 Instituti i Monumenteve të Kulturës, drejtor i të cilit nga themelimi e deri sa doli në pension do të ishte themeluesi i Institutit, G. Strazimiri.

Dalja më vete e Institutit të Monumenteve të Kulturës shënoi një ngjarje të rëndësishme kulturore për vendin, që i dha një hov të veçantë mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve, e cila u duk në çdo aspekt organizativ. Ndërhyrjet në monumente siguroheshin nga një strukturë adekuate, nga një Institut me sektorët përkatës për çdo gjini apo periudhë historike, si dhe nga Degët e Atelietë e rretheve, Duke i shtuar këtij organizimi dhe një rrjet të dendur kujdestarësh, që sinjalizonin në çdo rast gjendjen e monumenteve, kujdesi për trashëgiminë ishte i shpërndarë në mënyrë kapilare dhe me një planifikim të drejtë fondesh për fuqi punëtore e bazë materiale.

Për t'ia bërë të njohura rezultatet e mbrojtjes dhe restaurimit të Institutit opinionit shkencor vendas e atij të huaj, më 1971 doli numri i parë i revistës prestigjioze "Monumentet" me një vlerë të spikatur dëshmuese për veprimtarinë shumëplanëshe të vlerësimit të monumenteve, e cila sot ka arritur në numrin 60 të saj.

Përkushtimi dhe ndjenja e përgjegjësisë ndaj detyrës si Drejtor i një Instituti të ngarkuar për mbrojtjen e vlerave të Trashëgimisë Kombëtare, e vuri Gani Strazimirin në pararojë të mbrojtjes

së kësaj trashëgimie, që u shfaq në shumë raste. Është i njohur tashmë denoncimi me forcë ndaj dëmtimeve dhe prishjeve të disa monumenteve deri në organet e drejtësisë, siç ishte rasti i prishjes së kishës së Vaut të Dejës, Bezistenit e Hamamit të Shkodrës e shumë të tjerave. Përpjekja për shpëtimin e monumenteve të kultit në vitin e mbrapsht 1967, kur pushteti i atëhershëm i privoi popullit të drejtën elementare të besimit, që u shoqërua me prishjen e objekteve fetare dhe kërkesën për uljen e numrit të tyre nga mbrojtja shtetërore, solli si rezultat, që duke argumentuar vlerat historike, arkitektonike e artistike të monumenteve dhe dëmin që mund të sillte prishja e tyre, u arrit që, në fazën e parë dhe me të egër, të mbaheshin në listë 140 monumente nga 214 që përmbante lista, të cilat me kalimin e kohës u shtuan.

Falë këtij përkushtimi, falë arritjeve në fushën e mbrojtjes dhe restaurimit te trashëgimisë kulturore, Gani Strazimiri fitoi një prestigj në rrethet shkencore të vendit dhe të jashtme dhe një autoritet të merituar, sa që edhe organet më të larta të pushtetit nuk merrnin vendime pa e pyetur atë.

Për meritat e punës, Gani Strazimiri është vlerësuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Urdhrin Naim Frashëri të klasit të Parë në vitin 1973, nga Presidenti i Republikës me Urdhrin “Mjeshtër i Madh i Punës”, më 1998 dhe Titullin “Kalorës të Urdhrit të Skënderbeut”, pas vdekjes, më 2020.

ARCHITECT GANI STRAZIMIRI

Architect Gani Strazimiri, a prominent figure in the field of evaluation of construction monuments in Albania, was the First Director of the Institute of Cultural Monuments.

Gani Strazimiri (1915-1993) was born in Maqellarë (Peshkopi). With strong tendencies in the fields of art and construction activity, he graduated from the artistic high school in Tirana, in the branch of painting. He continued his higher studies in architecture at the Polytechnic University of Turin, which he interrupted due to the occupation of Albania by fascist Italy. Returns to the homeland and is involved in the Antifascist National liberation War. After the liberation of the country and the end of World War II he began his higher studies in Moscow, in the field of architecture.

Upon returning to his homeland, G. Strazimiri started work at 'Projekti' enterprise.

In 1957 G. Strazimiri was fully engaged to the field of architectural heritage studies and was appointed head of the Material Culture Group of the Institute of History and Linguistics. This Group was formed of three units: Archeology, Art History and Architecture, and the Protection and Restoration of Monuments.

G. Strazimiri was distinguished for his continuous pursuit of research-study activities, for the selection of employees mainly by skill and professional dedication. Even in this activity, G. Strazimiri applied the principle of division of fields of study for the new staff. Today, after a relatively long study experience, this division carried out by the director of the Material Culture Group appears deeply fair and fruitful, significantly increasing the professionalism of the staff, which gave its results in the protection of different genders of monuments, in their care and restoration, as well as in the number of scientific publications, articles and monographs.

The greatest achievement was putting the cities of Gjirokastra and Berat, the underground of Durrës and the Old Bazaar of Kruja under state protection, with the Decision no. 172, dt. 2.06.1961 of the Council of Ministers. In addition, the Regulation on the Administration of the Museum-City of Berat was approved. Even today, after 60 years, this Regulation remains a model for its scientific competence, for its clarity, for solving the complex problems for protection of the architectural values of the city of Berat, creating at the same time an already concrete

experience for the protection of other historical Centers of Albania.

On May 25-31, 1964, Gani Strazimiri together with Aleksander Meksi participated in the Second International Conference of Architects and Technicians of Historic Monuments in Venice, where they voted for the approval of the International Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites, known as the Venice Charter. Together with the Venice Charter they brought in Albania its spirit, which became for the new cadres of the field of monuments, as well as for the whole world, the basic guiding document for the protection, study, conservation and restoration of cultural monuments.

Gani Strazimiri was convinced that the very wide range of issues for the protection and restoration of monuments could not be solved by the current organization with triple dependence: the Group of Material Culture, the Institute of History and Linguistics and the State University of Tirana. Gani Strazimiri insisted and made it possible to create the Institute of Cultural Monuments in 1965, on the basis of the sector of Protection and Restoration of Monuments, part of the Group of Material Culture. He was the founder and the director of this Institute, from its establishment until he retired.

The came out on its own of the Institute of Cultural Monuments marked an important cultural event for the country, which gave a special impetus to the protection and restoration of monuments. This impetus was evident in every organizational aspect.

In order to make known to the local and foreign scientific opinion, the results of the protection and restoration work done by this Institute, in 1971, the first issue of the prestigious magazine "Monuments" came out, a magazine with a remarkable value for the multifaceted evaluation activity concerning the monuments. Today, this magazine has reached number 60.

The full commitment and high sense of responsibility to the duty, as Director of an Institute in charge of protecting the values of the National Heritage, put Gani Strazimiri at the forefront of the protection of this heritage. Thanks to this dedication, thanks to the achievements in the field of protection and restoration of cultural heritage, Gani Strazimiri gained a high prestige and a deserved authority in the scientific circles of the country and abroad, so that even the highest authorities could not make decisions without asking him.

For the merits of his work, Gani Strazimiri was awarded by the Presidium of the People's Assembly with the "Order of Naim Frashëri of the First Class" in 1973.

The President of the Republic awarded the order "Grand Master of Work" in 1998 and the title "Knight of the Order of Skanderbeg", in 2020, after his death.







1. Gjatë ekspeditës shqiptaro-sovjetike më 1958 me profesorin bizantolog V. Llazariev, restauratorin Filatov dhe studiuesit shqiptarë V. Puzanova, Th. Popa e Dh. Dhamo

2. Gjatë Kongresit të ICOMOS-it në Selanik të Greqisë, tetor 1973

3. Bashkë me A. Meksin në Konferencën II Ndërkombëtare të Arkitektëve dhe Teknikëve të Monumenteve Historike në Venecie, maj 1964

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
VENDIM

Nr. 172 datë 2/6/1961 E HAPËT

MBI SHPALLJEN E QYTETEVE MUZE



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
V E N D I M
Nr. 172 datë 2/6/1961 E HAPËT
M B I
SHPALLJEN E QYTETEVE MUZE

Këshilli i Ministrave, në mbështetje të vendimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të P.P. Shqipërisë Nr. 228 datë 7.VII.1959 " Mbi traditat patriotike revolucionare të populIit tonë dhe duke patur parasysh veçoritë arkitektonike dhe pasuritë monumentale të disa qyteteve të vendit tonë, në mbledhjen e datës 2.VI.1961,

V E N D O S I :

1. Shpallen qytete-muze dhe si të tillë vihen në mbrojtje shtetërore të veçantë qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit, pjesa e vjetër dhe nëntoka e qytetit të Durrësit dhe Pazari i Vjetër, i qytetit të Krujës.

2. Ngarkohet Universiteti Shtetëror i Tiranës që, brenda vitit 1961, të përfundojë studimin dhe projektimin e zonifikimit të qytetit muze të Beratit dhe rregulloren përkatëse. Studimi, projektimi dhe rregullorja për qytetin-muze të Gjirokastrës, pjesën e vjetër dhe nëntokën e qytetit të Durrësit dhe Pazarin e Vjetër të qytetit të Krujës, të përfundojë gjer në fund të vitit 1962.

3. Gjersa të përfundojnë studimet, projektet dhe rregullo-ret për qytetin e Gjirokastrës,Durrësit dhe Krujës këto të mirëmba-hen, restaurohen dhe administrohen në analogji me dispozitat e rre-gullores së qytetit-muze të Beratit dhe në përputhje me udhëzimet e veçanta të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Arsi-mit dhe Kulturës.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (SPIRO RUSHA) d.v.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (MEHMET SHEHU) d.v.

Nr. 6/19
dt. 21.VI.1961

1. Shpallen qytete-muze dhe si të tillë vihen nè mbrojtje shtetërore të veçantë qytetet e Gjirokastrès dhe Beratit, pjesa e vjetër dhe nëntoka e qytetit të Durrësit dhe Pazari i Vjetër i qytetit të Krujès.
2. Ngarkohet Universiteti Shtetëror i Tiranës që, brenda vitit 1961, të përfundojë studimin dhe projektimin e zonifikinit të qytetit muze të Beratit dhe rregulloren përkatëse. Studimi, projektimi dhe rregullorja e për qytetin-muze të Gjirokastrës, pjesën e vjetër dhe nëntokën e qytetit të të Durrësit dhe Pazarin e Vjetër të qytetit të Krujës, të përfundojë deri në fund të vitit 1962.
3. Gjersa të përfundojnë studimet, projektet dhe rregulloret për qytetin e Gjirokastrës, Durrësit dhe Krujës, këto të mirëmbahen, restaurohen dhe administrohen në analogji me dispozitat e rregullores së qytetit – muze të Beratit dhe në përputhje me udhëzimet e veçanta të Universitetit Shtetëror të Tiranës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Kulturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (SPIRO RUSHA) d.v.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (MEHMET SHEHU) d.v.

Nr. 6/19
dt. 21.VI. 1961

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
NR. 170 DATË 2/6/1961 E HAPËT

MBI APROVIMIN E RREGULLORES
MBI ADMINISTRIMIN E QYTETIT-MUZE
TË BERATIT



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
V E N D I M
Nr. 170 datë 2/6/1961 E HAPËT
M B I
APROVIMIN E RREGULLORES MBI ADMINISTRIMIN E QYTETIT-MUZE
TË BERATIT

Këshilli i Ministrave, në vijim dhe në zbatim të vendimit Nr. 172 datë 2/VI/1961 mbi qytetet-muze, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, në mbledhjen e datës 2/6/1961,

V E N D O S I :

Aprovimin e rregullores " Mbi administrimin e qytetit-muze të Beratit" me përmbajtjen që vijon:

I. Ndarja e qytetit-muze në zona

Neni 1

Qyteti i Beratit ruan vlera të mëdha historike, artistike e kulturale jo vetëm me rëndësi lokale, por edhe me karakter kombëtar lidhur me zhvillimin e historisë, artit e kulturës, në përgjithësi në vendin tonë dhe prandaj vihet në mbrojtje shtetërore të veçantë.

Neni 2

Në qytetin-muze të Beratit ruhen dhe mbrohen nga shteti të gjitha ndërtimet që përbëjnë qytetin-muze, monumentet e kulturës, vendet historike, ansamblet arkitektonike, urbanistike dhe inxhinierike, silueta e qytetit dhe elementet krijonjëse të tij.

Neni 3

Qyteti-muze i Beratit ndahet në tri zona, simbas planit që i bashkëngjitet këtij vendimi si pjesë e pandarë e tij dhe që përshkruhen më poshtë:

a) Zona muze
b) Zona e mbrojtur
c) Zona e lirë

Këshilli i Ministrave, në vijim dhe në zbatim të vendimit Nr. 172 datë 02.06.1961 mbi qytetet-muze, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, në mbledhjen e datës 2/VI/1961,

V EN D O S I:

Aprovimin e rregullores “mbi administrimin e qytetit-muze të Beratit” me përmbajtjen si vijon:

I. Ndarja e qytetit muze në zona

Neni 1

Qyteti i Beratit ruan vlera të mëdha historike, artistike e kulturore jo vetëm me rëndësi lokale, por edhe me karakter kombëtar lidhur me zhvillimin e historisë, artit e kulturës në përgjithësi në vendin tonë dhe prandaj vihet në mbrojtje shtetërore të veçantë.

Neni 2

Në qytetin-muze të Beratit ruhen dhe mbrohen nga shteti të gjitha ndërtimet që përbëjnë qytetin-muze, monumentet e kulturës, vendet historike, ansamblet arkitektonike, urbanistike dhe inxhinierike, silueta e qytetit dhe elementet krijonjëse të tij.

Neni 3

Qyteti-muze i Beratit ndahet në tri zona, sipas planit që i bashkëngjitet këtij vendimi si pjesë e pandarë e tij dhe që përshkruhen më poshtë:

a) zona muze
b) zona e mbrojtur
c) zona e lirë

I. Zona muze, e cila ruan monumente të kategorisë së I-rë dhe të II-të, kufizohet: nga jugu me kodrën e Goricës, nga perëndimi kufiri kalon 60 m në perëndim të urës mbi lumin Osum dhe ndjek 20 m, në perëndim rrugën këmbësore që ngjitet në kala nga faqja, perëndimore e kodrës duke dalë në qafë të kalasë: nga verilindja me rrugën që lidh kalanë me qendrën e qytetit dhe nga juglindja me rrugën që kalon prapa Pallatit të Kulturës gjer te xhamie Beqarit, nga ku kalon lumin dhe del në anën lindore të lagjes Goricë (Partizani).

II.Zona e mbrojtur, e cila ruan vetëm monumente të kategorisë I-rë, kufizohet: nga jugu me lumin Osum, nga perëndimi me zonën-muze, nga verilindja në mënyrën zigzage përmbledh pjesën e fundit të lagjes "Ylli i Kuq" (Prroit) dhe kalon 100 m në verilindje të shtëpisë së Fazlli Bizbiqit dhe Toli Pines dhe nga juglindja bashkohet me lumin Osum, duke lënë nga perëndimi 100 m kishën e Shën-Mitrit.

III.Zona e lirë, e cila ruan vetëm monumente të izoluara të kategorisë I-rë është gjithë pjesa tjetër e qytetit, pa zonën-muze dhe pa zonën e mbrojtur.

Neni 4

Ansamblet që përbëjnë zonën muze janë:

a) Lagja Kala
b) Lagja Mangalem (sot lagja "17 Nëntori")
c) Lagja Partizani

Ansamblet në vetvehte janë monumente të kategorisë I-rë.

II. Kategoritë e monumenteve

Neni 5

Monumentet që përbëjnë zonën muze ndahen në dy kategori:

a) Monumente të kategorisë I-rë: që janë përfaqësuesit e tipave kryesorë të arkitekturës (ndërtimet shoqërore, ndërtimet e kultit, apo inxhinierike etj.) si dhe ato që ruajnë vlera të mëdha në lëmin e artit.
b) Monumente të kategorisë II-të: që janë të gjitha ato monumente (ndërtime shoqërore, kulti etj.), të cilat së bashku me monumentet e kategorisë I përbëjnë pjesë të pashkëputur të ansambleve të zonës muze.
Ndarja e monumenteve në kategori ka për qëllim praktik zbatimin e metodës së restaurimit, ruajtjes, mbrojtjes, adaptimit dhe shfrytëzimit të tyre.

Neni 6

Karakteristika kryesore të ansambleve që përbëjnë zonën muze dhe që ruhen, janë:

a) ndërtime në terren të pjerrët, të thepisur e shkëmbor, në ngastra individuale, dy dhe tre katëshe, të vendosura ngjitur me njëra-tjetrën dhe lirisht;
b) orientimi i ndërtimeve kryesisht nga rrugët kryesore, lumi Osum dhe qendra e qytetit;
c) katet e poshtme me gurë, ndërsa të sipërmet pjesa më e madhe me skelet druri të suvatuara dhe në përgjithësi të lyera me shërbet gëlqereje;
ç) kati i parë zakonisht pa dritare, kati i dytë dhe i tretë me dritare të shumta vertikale dhe me ndarje të shpeshta;

d) kur katet e sipërme janë me skelet druri (çatma) në më të shumtën e rasteve këto janë të dala nga jashtë (me konsole);
dh) çatitë janë katër ujse, me pjerrësi të ëmbël, të mbushura me tjegulla vendi dhe me strehë të dalura shumë;
e) rrugët janë të ngushta, me kalldrëm në formë korridoresh të lakuar e zigzake; aty këtu kthehen në shkallë guri dhe tarraca;
ë) shtëpitë me gjithë terrenin e pjerët edhe kur ngastra është e kufizuar, para mbrapa ose anës, në të shumtën e rasteve kanë oborr ose kopësht të vogël, rrallë të dyja së bashku. Në kompozimin e rrugëve luajnë rol me rëndësi, vendet boshe tip tarrace.

Të gjitha këto karakteristika të monumenteve dhe elementet e tjera krijuese të qytetit (ura, ujësjellësi, kanalizimet, rrugët etj.) përcaktojnë karakterin historik, arkitektonik dhe artistikk të ansambleve të zonës muze.

Neni 7

Monumentet e kategorisë së I-rë ruhen në tërësi, mund të shfrytëzohen vetëm atëherë kur një gjë e tillë nuk dëmton vlerat që e përcaktojnë atë si monument të kategorisë së I-rë. Propozimi për shfrytëzim bëhet nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit dhe vetëm pasi të merret aprovimi i Universitetit Shtetëror të Tiranës mund të fillojë shfrytëzimi.

Monumentet e kultit kur nuk kryejnë funksionin për të cilin janë ndërtuar, me aprovimin e Universitetit, mund të shfrytëzohen si muze ose për ndonjë qëllim tjetër, i cili nuk dëmton vlerat që e përcaktojnë atë si të tillë dhe krijon mundësi të plota për vizitimin, studimin, restaurimin e mirëmbajtjen pa kushte të tyre.

Monumentet shtëpi banimi ruhen në tërësi. Destinimi për të cilin janë ndërtuar këto është banimi. Këtë funksion e ruajnë edhe në të ardhmen. Vetëm në rastet kur masat për shfytëzim si banesë cënojnë monumentin, mundet të përdoret për qëllim tjetër që nuk cënon këto vlera, si kopësht e çerdhe fëmijësh, muze etj.

III. Restaurimi dhe mirëmbajtja e monumenteve

Neni 8

Restaurimi bëhet nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit nën drejtimin tekniko-shkencor dhe në bazë të projektit të hartuar nga Universiteti shtetëror i Tiranës (Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë).

Punimet për mirëmbajtjen dhe meremetimet urgjente të monumenteve bëhen nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit në bazë të udhëzimeve që jep në vend Universiteti shtetëror i Tiranës (Instituti i Historisë e Gjuhësisë).

Neni 9

Monumentet e kategorisë së II-të ruhen vetëm për pamjen e tyre të jashtme; brenda mund të ndryshohen e përshtaten sipas nevojave të përdorimit. Meqenëse këto monumente gjenden vetëm në zonën muze dhe janë pjesë përbërëse dhe të domosdoshme të ansambleve të kësaj zone duhet të ruhen, të mirëmbahen dhe të restaurohen nga jashtë.

Restaurimi (vetëm nga jashtë) bëhet sipas nenit 8. Adaptimi për shfrytëzimin bëhet me leje të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit, i cili në aprovimin e projektit udhëhiqet nga metoda e mbrojtjes së zonës muze duke ruajtur pamjen e jashtme, sipas nenit 6.

Zbatimi i punimeve për mirëmbajtjen dhe adaptimin e monumenteve, në bazë të projektit, bëhet nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit dhe, kur ndërtesa është pronë private, nga pronari. Në rastin e dytë, Komiteti Ekzekutiv është i detyruar të mbikëqyrë zbatimin e përpiktë të punimeve, në bazë të projektit të

aprovuar. Kur në këto monumente (sidomos në shtëpitë e banimit) ka pjesë ku ndodhen gdhendje druri, dekorime dhe piktura etj. punimet në këto ambjente bëhen nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit nën drejtimin tekniko-shkencor të Universitetit shtetëror të Tiranës (Instituti i Historisë e Gjuhësisë).

Neni 10

Punimet e restaurimit dhe të mirëmbajtjes së monumenteve të kategorisë I-rë dhe të kategorisë II-të (vetëm nga jashtë) kryhen me cilësi të lartë nga specialistë të aftë. Teknika e punimeve dhe materialet që përdoren duhet të jenë të njëjtë me teknikën dhe materialet e përdorura në monumentet kur janë ndërtuar.

Neni 11

Në zonën muze nuk lejohet asnjë prishje ose ndërtim i ri pa lejen e Universitetit Shtetëror të Tiranës (Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë).

Neni 12

Në zonën e mbrojtur hartimi i planit rregullues dhe ndërtimet e reja duhet të bëhen në mënyrë që të mos cënojnë monumentet që ruhen në këtë zonë dhe qytetin-muze në tërësi, në mënyrë që ambienti rrethues t'i vërë më në pah monumentet. Projekti i planit rregullues dhe i ndërtimeve të reja që do të bëhen në këtë zonë aprovohen nga Universiteti Shtetëror i Tiranës (Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë).
Në këtë zonë nuk lejohen ndërtime industriale.

Neni 13

Zhvillimi i qytetit në zonën e lirë, si plani rregullues ashtu dhe ndërtimet duhet të orientohen nga ato të qyteteve moderne, por duke pasur kurdoherë parasysh respektimin e monumenteve të izoluara që ndodhen në të dhe qytetin-muze në tërësi.
Plani rregullues i qytetit, para se të aprovohet nga Këshilli i Ministrave, duhet të shqyrtohet nga Universiteti Shtetëror i Tiranës (Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë), i cili jep pëlqimin e tij.

IV. Administrimi i qytetit-muze

Neni 14

Administrimi i qytetit-muze bëhet nga seksioni i arsimit dhe kulturës pranë Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit të Beratit. Për të drejtuar punën e mbrojtjes, merremetimit, restaurimit dhe administrimit të përgjithshëm të qytetit-muze, krijohet pranë Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit, Këshilli i qytetit-muze, i kryesuar nga kryetari i Komitetit Ekzekutiv, me anëtarët, shefin e seksionit të arsimit dhe kulturës, shefin e seksionit komunal, kryearkitektin e Komitetit Ekzekutiv, sekretarin e Këshillit të Frontit Demokratik të rrethit, sekretarin e organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës për rrethin, drejtorin e Shtëpisë së Kulturës, drejtorin e muzeumit, përgjegjësin e ateljesë së monumenteve dhe specialistë të ndryshëm si arkitektë, piktorë, skulptorë, shkrimtarë etj.

Neni 15

Këshilli i qytetit-muze ka për detyrë:

a) të aprovojë planin vjetor të punimeve për merremetime e restaurime dhe të masave të tjera mbrojtëse, hartuar nga seksioni i arsimit dhe kulturës në konsultim me Universitetin Shtetëror të Tiranës;
b) të hartojë planin e zhvillimit perspektiv të qytetit-muze, të disiplinojë ndërtimet e reja, duke iu përmbajtur dispozitave të kësaj rregulloreje;

c) të nxjerrë vendime, thirrje, rregulla etj. në përputhje me frymën e kësaj rregulloreje.

Neni 16

Me qëllim që të kontrollphet mirëmbajtja dhe ruajtja e tërë kompleksit të qytetit-muze, seksioni i arsimit dhe kulturës bën inventarizimin e plotë me përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së monumenteve që përbëjnë zonën-muze e të mbrojtur dhe monumentet e izoluara të qytetit, të ndarë në kategori, sipas udhëzimeve të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Neni 17

Mirëmbajtja dhe restaurimi i qytetit-muze të Beratit kryhet në bazë të një plani perspektiv 10-15 vjeçar të hartuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës në bashkëpunim me Komitetin Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit. Shpenzimet sigurohen nga fondet e caktuara nga Qeveria.

Neni 18

Fondet buxhetore të nevojshme për mbrojtjen dhe restaurimin e ndërtesave dhe kompleksit të qytetit-muze parashikohen nga këshilli i qytetit-muze, në marrëveshje me Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe administrohen, sipas një plani, nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit.

Neni 19

Punimet për restaurimin, mirëmbajtjen dhe meremetimin e monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të, edhe kur këto janë prona private, bëhen me shpenzime të shtetit në bazë të dekretit Nr. 609 datë 24.V.1948 "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe të sendeve natyrale të rralla"; ndërsa punimet për mirëmbajtjen e meremetimin e atyre monumenteve që përdoren për banim bëhen me shpenzimet e pronarit. Për mosmeremetimin e këtyre monumenteve nga pronarët e tyre zbatohen dispozitat e veçanta mbi meremetimin dhe ndreqjen e banesave.

Neni 20

Për dëmtimet e ndërtesave dhe sendeve të tjera të kompleksit muzeal të qytetit dhe për çdo shkelje tjetër të dispozitave të kësaj rregulloreje zbatohen dënimet e parashikuar nga Kodi Penal.

Neni 21

Të gjitha çështjet që nuk parashikohen nga kjo rregullore zgjidhjen në marrëveshje me Universitetin Shtetëror të Tiranës (Instituti i Historisë e Gjuhësisë) duke marrë aprovimin e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës.

Neni 22

Kësaj rregulloreje i bashkohet plani i ndarjes në zona të qytetit-muze dhe një listë e monumenteve të kategorisë së I-rë. Në planin e ndarjes në zona janë përcaktuar grafikisht zona-muze, zona e mbrojtur, zona e lirë si dhe monumentet e kategorisë së I-rë, kategorisë së II-të dhe ato ndërtime që lejohen të prishen në ansamblet që formojnë zonën-muze.

Neni 23

Kjo rregullore hyn menjëherë në fuqi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
KËSHILLIT TË MINISTRAVE
(SPIRO RUSHA) d.v.

KRYETARI I KËSHILLIT
TË MINISTRAVE
(MEHMET SHEHU) d.v.

Gani STRAZIMIRI

QYTETET MUZE NË R. P. TË SHQIPËRISË
QYTETI MUZE I BERATIT[1]

Një ndër problemet që preokupojnë arkitektët, teknikët dhe restauratorët e monumenteve të kulturës në vendin tonë është dhe ai i mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të qyteteve që ruajnë vlerë të madhe historike, kulturore artistike dhe ambientale. Ky problem mori rëndësi të madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit kur qytetet tona filluan të zhvilloheshin, të shndërroheshin me ritme të shpejta në kuadrin e rindërtimit dhe rimodernizimit të madh të tyre.

Në të kaluarën, për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e monumenteve në përgjithësi dhe të qendrave (qyteteve) historike dhe kulturore-artistike në veçanti nuk treguan asnjë kujdes. Ky problem ishte lënë pas dore megjithëse opinioni publik kishte ngritur zërin vazhdimisht për t'i dhënë fund këtij moskujdesi të palejueshëm në lidhje me këto pasuri të lëna trashëgimi nga e kaluara. Ky problem u vu në rrugën e zgjidhjes vetëm pas luftës së dytë botërore.

Eksperienca jonë fillestare dhe ajo e shumë vendeve të tjera, na mësoi, që qytetet që ruajnë vlera të mëdha historiko artistike dhe ambientale, nuk mund të mbrohen vetëm me masa pasive. Me ndalimin e modifikimeve, të higjienizimit dhe të konfortit, nuk mund të zgjidhej mbrojtja dhe ruajtja e tyre.

Në këto rrethana u kalua nga masat pasive për mbrojtjen dhe konservimin e qendrave historike, në masa dhe ndërhyrje aktive. Kështu, më 1959, me vendim të veçantë u deklaruan "qytete muze" Durrësi, Berati, Gjirokastra dhe Kruja dhe filluan studime dhe masa mbrojtjeje, mirëmbajtjeje e restaurimi me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të organeve shtetërore.

Qendra e parë historiko-artistike që u bë objekt studimi për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e tyre qe qyteti i Beratit, të cilin po e trajtojmë në këtë kumtesë.

* * *

Berati, Antipatrea e ilirëve, është vendosur në luginën e Osumit, aty ku lumi përpara se të dalë në fushë ngushtohet në mes dy vargjeve kodrinash gëlqerore. Qytetin e mbizotëron një kështjellë e madhe, që ngrihet në majën e kodrës në të djathtë të lumit.

Për të pasur një ide mbi këtë qytet shumë të vjetër, duhet rikujtuar se duke filluar nga kohët më të lashta e deri në shekullin XIII-XIV, ky u zhvillua brenda mureve rrethuese. Në vitin 200 p. e. sonë u dogj e u rrënua plotësisht nga romakët. Dhe nuk u rindërtua veçse në shekullin VI të erës tonë nga Perandori

[1] Kumtesë e mbajtur para Kongresit të II-të Ndërkombëtar të Arkitektëve dhe teknikëve të Monumenteve (25-31 maj 1964), në Venedik Itali.

bizantin Justiniani, së bashku me shumë qendra të tjera, për t'u bërë ballë sulmeve barbare.
Në shekullin XIII – XIV qyteti pati një zhvillim të madh, u zgjerua jashtë mureve rrethuese, duke u shtrirë në fillim rrëzë kodrës dhe u fortifikua me mure të dyta rrethuese.
Në shekujt XIII – XIV u zhvillua më tej dhe u bë një nga qytetet më të mëdha të vendit dhe i përmendur në gjithë gadishullin ballkanik.
Deri në fund të luftës së dytë botërore qyteti u zhvillua, mund të themi, në bazë të strukturës së mesjetës së vonshme dhe nuk u realizuan as elementët më minimale urbane të ditëve tona, të cilat do ta kishin bërë problemin urbanistik dhe atë të konservimit dhe restaurimit të vlerave historike – artistike të qytetit më pak të vështira, më pak të ndërlikuara e më pak të kushtueshme.
Studimet për të përcaktuar vlerat historike, artistike dhe ambientale, zonifikimi, ndarja e monumenteve në dy kategori dhe parimet e mbrojtjes, higjienizimit konservativ dhe restaurimit të qytetit muze të Beratit, janë bërë në bashkëpunim me urbanistë, arkitektë, arkeologë, dhe historianë arti. Në mbështetje të këtyre studimeve, qyteti i Beratit është ndarë në tri zona: zona muze, zona e mbrojtur dhe zona e lirë.
Zona muze, më e pasura me vlera historike, kulturore-artistike, dhe ambientale, përmbledh kodrën ku ngrihet kështjella me lagjen brenda mureve të saj, pjesën jugore dhe lagjen në lindje rrëzë kodrës së kështjellës si dhe lagjen në jug të qytetit në anën tjetër të lumit Osum.
Zona e mbrojtur, që ruan vlera historike artistike të izoluara, përmbledh pjesën lindore të qytetit pas zonës muze, sipas kufijve grafikë të planit rregullues të qytetit.

Zona e lirë përfshin pjesën tjetër të qytetit.
Në sipërfaqen e përcaktuar me përkufizimin "Zona muze", të gjitha ndërtimet që e përbëjnë dhe ruhen janë ndarë në dy kategori: të "kategorisë së parë" janë ato me vlerë të madhe historike dhe artistike dhe të "kategorisë së dytë" ato me vlerë vetëm ambientale.
Studimet, në vija të trasha, lidhur me higjienizimin konservativ të zonës muze, përmbledhin sipërfaqet me ndërtimet përkatëse si dhe sipërfaqet e lira dhe me karakter ambiental, që përfshihen në perimetrin e kësaj zone sipas kufizimit grafik të parashikuar nga plani rregullues i përgjithshem i qytetit, të cilat përbëjnë së bashku kompleksin urbanistik, arkitektonik, dhe ambiental që i shtrohet një disipline të veçantë.
Higjienizimi konservativ, duke iu përshtatur sistemit që kërkon jeta e sotme, parashikohet dhe realizohet duke pasur parasysh të konservojë njësinë e kompleksit urbanistik arkitektonik dhe ambiental, integritetin e monumenteve dhe të ndërtimeve me vlerë si dhe të atyre me vlerë thjesht ambientale, ruajtjen e vëllimeve të raportit të pjesëve bosh e plot si dhe çdo element tradicional dhe karakteristik të monumenteve në veçanti dhe të ambientit në përgjithësi.
Restaurimi konservativ i monumenteve dhe i ndërtimeve të kategorisë së parë kryhet duke pasur si objektiv të ruajë të paprekura dhe të pandryeshueshme pamjet e jashtme (prospektet) si dhe brenditë. Parashikohen edhe punime e ndërhyrje në thellësi, kur monumentet dhe ndërtimet kanë pësuar deformime, ndryshime gjatë kohës, si shtesa, ngjitje, ngritje, si dhe modifikime e ndarje të brendshme që kanë ndryshur kompozimin, arkitekturën dhe ambientin origjinal.
Ndërtimet e kësaj kategorie monumentesh pjesërisht do të shfrytëzohen si muze në natyrë dhe pjesës tjetër do t'u jepen funksione që nuk kërkojnë shndërrime, të cilat do të ndryshonin fizionominë dhe pamjen arkitektonike dhe ambientale.
Shtëpitë e banimit të kësaj kategorie, që do të shfrytëzohen si muze në natyrë, do të pajisen sipas kohës që i krijoi, për të paraqitur jetën familjare

sipas dokeve dhe mënyrës së jetesës, për të dhënë kështu një kuadër më të gjallë të kohëve të kaluara.

Restaurimi konservativ i ndërtimeve të kategorisë së dytë, atyre me vlerë vetëm ambientale, të cilat në pjesën më të madhe janë shtëpi banimi, do të bëhet si i atyre të kategorisë së parë, për sa i takon pamjes së jashtme, ndërsa brenda do të bëhen të gjitha shndërrimet dhe modifikimet e mundshme, që kërkon higjiena dhe komoditeti i një banese të sotme, me kusht që këto të mos ndikojnë në pamjen e jashtme të tyre dhe të ambientit, të lagjeve të zonës muze.

Në zonën muze janë kryer dhe kryhen punime mirëmbajtjeje dhe restaurimi preventiv, në ndërtesat në bazë të studimeve dhe kërkimeve me karakter historik, social – ekonomik dhe inxhinierik, me qëllim që të përcaktohet për çdo monument dhe ndërtesë (sipas kategorive).

Karakteri dhe shkalla e ndërhyrjes si dhe prishja (zhdukja) e ndërtimeve, shtesave dhe modifikimeve të mëposhtme, të cilat nuk kanë asnjë vlerë historike, arkitektonike dhe ambientale.

Kështjella dhe lagjja brenda mureve të saj përfaqësojnë pjesën kryesore të zonës muze, e cila në të ardhmen do të kthehet në një muze në natyrë, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik dhe etnografik. Sipas studimeve në vija të përgjithshme, sipërfaqet e caktuara për gërmime arkeologjike përfshijnë afërsitë e mureve rrethuese (brenda dhe jashtë), kështjellën dhe sipërfaqet e tjera të lira brenda mureve rrethuese si dhe pjesën jugore të kodrës së saj. Pjesa tjetër brenda mureve, lagjja e sotme, do të konservohet dhe do të restaurohet duke i përgatitur rrethanat dhe ambientin e kohës që i krijoi. Ndërkohë po kryhen punime mirëmbajtjeje dhe restaurimi preventiv në muret rrethuese, në ato të kështjellës si dhe në disa monumente dhe shtëpi banimi. Punime restaurimi paraprak janë kryer në kishën e shën Mërisë së Vllahernës dhe në Shën Triadhë të shekullit (të XIII dhe XIV) në katedralen (1797) si dhe në kishën e Shën Todrit e fundit (të shekullit të XVI-të).

Punime restaurimi preventiv janë kryer edhe në disa shtëpi banimi të kësaj lagjeje.

Edhe në dy lagje të tjera të zonës muze (Mangalem dhe Goricë) gjatë viteve të fundit kanë filluar punime mirëmbajtjeje dhe restaurimi preventiv si dhe në ndërtimin e kultit ashtu edhe në ato të banimit.

Një ndër problemet që kërcënojnë lagjen "Goricë" është dalja nga shtrati dhe përmbytje e saj nga lumi Osum.

Për të mënjanuar përmbytjen e kësaj lagjeje mendohet dhe po studiohet ngritja e nivelit të rrugës që kalon përbri lumit, në mënyrë që të krijohet si barrazh mbrojtjeje për lagjen. Në anën tjetër të rrugës mendohen të ndërtohen disa banesa të shkëputura, larg njëra tjetrës, për të lënë të lirë pamjen e lagjes që ngrihet rrëzë kodrës në këtë anë.

Me këto studime, në vija të trasha, nuk pretendojmë të kemi zgjidhur problemin e vështirë të mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të qytetit muze të Beratit. Zgjidhja e tij kërkon një studim të thellë të pasurive historike, kulturore-artistike dhe ambientale, të grumbullohet një material i bollshëm në të gjitha drejtimet në mbështetje të të cilit të fillohet një studim i thellë me bazë shkencore. Vetëm në këtë mënyrë do të zgjidhet drejt, brenda mundësive, problemi i mbrojtjes, konservimit, dhe restaurimit të qyteteve muze në përgjithësi dhe në veçanti i qytetit muze të Beratit.

Në këtë drejtim ka filluar puna këto kohët e fundit[1].

[1] Artikull i botuar në revistën Studime Historike, 3, 1964, fq.97-125





Tab. I 1. Plani rregullues i qytetit të Beratit.
2. Planimetria e Beratit në fund të shek. XIX (rindërtim).



Tab. II – Projekti në vija të përgjithshme i zonës Muze të Beratit.





Tab. III – Pamje e Beratit nga lindja. 2. Ura mbi lumin Osum.



Tab. IV – Pamje nga jugu e lagjes Mangalem.







Tab. V – 1. Kalaja e parë nga veriu; 2. Trakte të akropolit dhe të minares së një xhamije të shek. XVI; 3. Hyrja kryesore në kala (në plan të parë kullë bizantine e shek. VI-të e. sonë).









Tab. VI– Porta kryesore e Kalasë; 2.Pamje nga brenda e portës kryesore; 3.Porta e Mihail Engjëll Komnenit; 4.Trakte të mureve të dyta rrethuese të Beratit.









Tab. VII – Kisha e Shën Triadhës; 2. Kisha e Shën Marisë së Vllahernës; 3. Kisha e Shën Mëhillit (të shek. XII-XIV); 4. Kisha e Shën Todrit (shek. XVI).







Tab. VIII 1. Xhamia e Plumbit (shek. XVI); 2. Xhamia e Beqarit (shek. XVIII); 3. Teqeja e Helvetive (shek. XVIII).









Tab. IX 1. Pamje e Lagjes Kala (marrë nga kulla bizantine veriore); 2-3 Banesë beratase e shek. XVIII (shkalla kryesore dhe pamje nga prapa e banesës).











Tab. X – 1,2,3,4,5. Banesa beratase shek. XIX.



Lagjja Goricë



Lagjja Mangalem



Tab. XI – 1,2. Banesa beratase shek. XIX.







Tab. XII – 1. Lagjja Goricë. 2-3. Imtësi banese beratase (skaj fasade dhe tavan dhome).



Tab. XIII – 1. Brendi e një banese në Lagjen Mangalem (kati i tretë); 2. Shkallë e një banese beratase (Lagjja Goricë).

Gani STRAZIMIRI

MUSEUM CITIES IN P. R. OF ALBANIA
MUSEUM CITY OF BERAT[1]

One of the problems that concern the architects, technicians and restorers of cultural monuments in Albania is that of the protection, conservation and restoration of cities that preserve great historical, cultural, artistic and environmental values. This problem took on great importance during the last decade when our cities began to develop, to be transformed at a rapid pace in the context of their great reconstruction and modernization. In these circumstances, for the protection and conservation of historic centers, it was passed from passive measures, to active measures and interventions. Thus, in 1959, with a special decision, Durrës, Berat, Gjirokastra and Kruja were declared "museum cities" and studies on measures of protection, maintenance and restoration with the direct intervention of state bodies began.

The first historical-artistic center that became the object of study for its protection, conservation and restoration was the city of Berat, which we are addressing in this paper.

The city of Berat, with a centuries-old history, dating back to the Illyrian Period, preserves a very rich cultural heritage, with monuments of every gender and period, castles, Christian and Islamic cult buildings, as well as an impressive vernacular architecture.

Studies, so as to determine the historical, artistic and environmental values of the city, have been done in collaboration with urban planners, architects, archaeologists, and art historians. In support of these studies, the Historic Center was defined, the division of monuments into two categories were made and the principles of protection, conservative sanitation and restoration of the museum city of Berat were applied.

The city of Berat is divided into three zones: the museum area, the protected area and the free zone.

The museum area, the richest in historical, cultural-artistic, and environmental values, summarizes the hill where the castle rises with the neighborhood within its walls, the southern part and the neighborhood to the east at the foot of the castle hill and the neighborhood to the south of the city on the other side of the river Osum.

The protected area, which preserves isolated historical artistic values, summarizes the eastern part of the city behind the museum area, according to the graphic boundaries of the city regulatory plan.

The free zone includes the rest of the city.

In the area defined by the definition "Museum area", all constructions that constitute it and are preserved are divided into two categories: of the "first category" are those of great historical and artistic value and of the "second category" those of only environmental value.

---

1 Paper held during the Second International Congress of Architects and Technicians of Monuments (25-31 May 1964), in Venice, Italy.

The conservative restoration of monuments and constructions of the first category is carried out with the objective of preserving intact and unchanged the exterior views (prospectuses) as well as the interiors.
The conservative restoration of the constructions of the second category, those having only environmental value, which for the most part are residential houses, will be done as of those of the first category, in terms of external appearance, while inside, all possible transformations and modifications required by the hygiene and comfort of a modern dwellings will be done, provided that these do not affect their appearance and that of the environment, and the neighborhoods of the museum area.
Maintenance and preventive restoration works have been carried out during the last years in some residential houses of the neighborhoods-museums of Kala, Mangalem and Gorica.
With the studies so far we do not claim to have solved the difficult problem of protection, conservation and restoration of the museum city of Berat. Further more detailed studies will be able to meet the problems of protection of museum cities in general and, in particular, the museum city of Berat[1].

[1] Article Published in the journal Studime Historike, 3, 1964, pp.97-125

MAKS VELO



Maks Velo, një nga figurat shumëdimensionale shqiptare, arkitekt, piktor, studiues dhe shkrimtar, që shpirtin e lirë nuk e humbi as në burgjet e regjimit komunist, por përkundrazi, një pjesë të krijimtarisë së tij ia dedikoi dimensionit të lirisë.

U lind në Paris, më 31 gusht të vitit 1935 dhe u diplomua pranë Institutit Politeknik, Tiranë, ku përfundoi studimet në degën e Inxhinierisë së Ndërtimit. I specializuar në arkitekturë, në vitin 1960 u bë pjesë e grupit të punës në projektimet e para të qytetit të Tiranës. Më vonë dha kontributin e tij pranë byrosë së projektimit të Tiranës, pedagog i jashtëm në Institutin e Arteve, dërgohet si inxhinier në Ndroq. Në vitin 1969 pranohet si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve, prej nga përjashtohet mbas një viti, si artist me ndikime moderniste dhe dërgohet në kooperativën bujqësore të fshatit Gurrë. Më 1978 burgoset me akuzën "agjitacion propagandë". Më 1986 lirohet nga burgu i Spaçit.

Mbas vitit 1991 zhvillon një jetë shumë aktive. Hap ekspozita arti në Shqipëri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Francë, Greqi, Tunizi dhe Itali. Ka mbajtur leksione ne Kolegjin e Mineapolis, në Universitetin e Arteve të Bukura të Poznanit, Poloni, në Universitetit la Sapienza të Romës etj.

Si shkrimtar njihet me nga botimet e shumta si: "Kokëqethja", "Palltoja e burgut", "Thesi i burgut", "Paralele për arkitekturën", "Kohë antishenjë", "Betonizimi i demokracisë", "Hetimi", "Spaçi", "Jeta ime në figura", "Klubi Karavasta" "Përkthyesi", "Jetë paralele", etj.

Maks Velo konsiderohet dhe si personalitet në lëmin e Trashëgimisë Kulturore. Veprimtaria e tij në këtë fushë fillon që vitet universitare, kur ndiqte bizantologen e mirënjohur Vitori Puzanova në ekspeditat studimore të saj. Përkushtimi në punë i Puzanovës, zbulimet e saj për piktorët mesjetar, e në mënyrë të veçantë studimet për kryemjeshtrin e shek. 16, Onufrit, kulturën dhe mirësinë që rrezatonte, mësimet që Maksi përfitonte nga Ajo, nuk kishin si të mos linin gjurmë te studenti i ri. Respekti i thellë që gëzonte për Zonjën Puzanova u shfaq dhe në

botimin mbi jetën e saj dhe tani së fundi përkthimin dhe botimin e veprës Vitori Puzanova, Mbi artin bizantin dhe post-bizantin në Shqipëri.

Përvoja e fituar dhe frytet e saj në studimin dhe botimin e shumë artikujve mbi artin popullor si:

1. "Tymari në banesën qytetare shqiptare", *Monumentet*, 1991, 2
2. "Studim mbi elemente të arkitekturës funerare myslymane në Shqipërinë e Mesme", *Monumentet*, 1992 - 1999
3. "Dekori i thjeshte linear në gur ", *Monumentet*, 2002
4. "Punimet në gur në Dardhë të Korçës", *Monumentet*, 2003
5. "Detajet metalike të portave në qytetet shqiptare», *Monumentet*, 1973, 5 - 6
6. "Banesa popullore në zonën e Ndroqit ", *Monumentet*, 1974, 7 – 8.

Krahas studimeve Maksi ishte dhe një mbrojtës i paepur i Trashëgimisë.

Më 7 maj 2020 pushoi së rrahuri zemra e tij. Humbje e madhe dhe e parakohshme.

Do të na mungojë të gjithëve Maksi arkitekt, piktor, studiues, shkrimtar, Maksi i shpirtit dhe i fjalës së lirë.

MAKS VELO

Maks Velo is one of the multidimensional Albanian figures, architect, painter, researcher and writer, who did not lose his free spirit even in the prisons of the communist regime, but on the contrary, dedicated a part of his creativity to the dimension of freedom.

He was born in Paris, on August 31, 1935 and graduated from the Polytechnic Institute of Tirana, where he completed his studies in the field of Civil Engineering. Specialized in architecture, in 1960 he became part of the working group engaged in the first designs of the city of Tirana. Later he gave his contribution to the design bureau of Tirana, worked as external lecturer at the Institute of Arts and as an engineer in Ndroq.

Maks spent several years working on a number of projects including hotels, schools, villas and parks.

In 1969 he was accepted as a member of the League of Writers and Artists, from where he was expelled after a year, as an artist with modernist influences and was sent to the agricultural cooperative of the village of Gurrë. In 1978 he was imprisoned on the charge of "agitation and propaganda". In 1986 he was released from Spaç prison camp.

After 1991 Maks had a very active life. He opened several art exhibitions in Albania, the United States, France, Greece, Tunisia and Italy. He has lectured at the College of Minneapolis, at the University of Fine Arts in Poznan, Poland, at la Sapienza University of Rome, etc.

As a writer he is known for numerous publications. He published several books and photographic albums on topics including poetry, folkloric art, social realism, and his memoirs.

He has done research work and has published many articles on folk art, especially in the magazine "Monuments".

Maks Velo is also considered a personality in the field of Cultural Heritage. His activity in this field starts from the university years, when he followed the well-known Byzantine scholar Vitori Puzanova in her study expeditions. Puzanova's dedication to work, her discoveries for medieval painters, and in particular her studies for the great painter of the 16th century Onufri, the immense culture and kindness she radiated and the great experience that Max benefited from her, left their mark on the young student. The deep respect he enjoyed for Mrs. Puzanova was refleced in the publication on her life and most recently he realized the translation and publication of the work of Vitori Puzanova, "On Byzantine and Post-Byzantine Art in Albania".

On May 7, 2020, his heart stopped beating. It was such a large and premature loss, as we all miss Max, the architect, painter, scholar, writer, the champion of human rights and democratic freedoms.




Viktori Puzanova
MBI ARTIN BIZANTIN
DHE POST-BIZANTIN
SHQIPTAR





Çifti Vitori dhe Vasil Puzanov







Maks VELO

DEKORI I THJESHTË LINEAR NË GUR[1]

Mendoj se ka nevojë për një paraqitje dhe klasifikim të dekorit të punuar në gur nga mjeshtrat popullorë. Këtukam p arashtruar vetëm dekorin linear, gjeometrik, jo atë florear e arabesk, që do të kërkonte një studim tjetër. Ky lloj dekoracioni, që është më i thjeshti nga të gjithë, për mua paraqet interes parësor, sepse mbi të e pas tij mund të realizohen të gjitha llojet e tjera të dekoreve, si kompozitat, shtesat, riformulimet grafike, pasurimet, përsëritjet. Është si puna e shkronjave, që janë baza e gjuhës. Dhe ky lloj dekori është shprehja e parë e mjeshtrit, e atij më të hershmit, mjeshtrit të shoqërisë primitive. Ky lloj dekori është më i vjetri. Dhe kësisoj, ngarkesa e tij deshifruese është shumëplanëshe.

Sigurisht, pjesa më e madhe e këtyre elementeve janë përdorur edhe në materiale të tjera, si në dru, kockë, hekur, baltë (terakotë).

Por, unë dua të zbërthej vetëm atë mbi gur. Duhet thënë që në fillim se këto dekore janë të thjeshta. Guri i punuar me thellim ose në reliev, vihet në dukje në qoshen e shtëpisë ose në harkun, a në traun e portës. Këto janë dy pjesët më të dukshme të banesës popullore.

Qoshja e shtëpisë punohet me kujdes dhe një apo disa gurë dekorohen.

Këta gurë që edhe thirrën "Gurë të qoshes" janë të zgjedhur nga materiali më i mirë, janë më të plotë, më masivë e vendosen njëri mbi tjetrin në mënyrë zig-zag.

Dhe nga pikëpamja e shikimit këta janë më të dalluarit, sepse urbanistika popullore e vendoste banesën në mënyrë të tillë që të ishte sa më mirë e rrahur nga shikimi i vizitorëve dhe udhëtarëve.

Kështu, mjeshtri caktonte gjatë punës, cili gur do të dekorohej. Shpesh këtë ia kërkonte i zoti i shtëpisë i cili mburrej për "qoshet e shkruara".

Një shtëpi e dekoruar ishte gjithmonë më e pasur, më e rëndësishme, më e dalluar sesa një tjetër e padekoruar.

Ana tjetër e rëndësishme e këtij studimi, është se ky lloj dekori është shumë i lashtë, është dekori i parë.

Kështu ne gjejmë, në artin shqiptar, një vijueshmëri, ruajtje, konservim të motiveve bazë, primare. Kjo tregon një traditë pagane të pandryshuar nga pushtimet dhe invazionet kulturore të mëvonshme, një rezistencë të qetë kulturore.

Në Krujë, gurët e dekoruar i quajnë "gurë të kalitur". Zakonisht, guri i punuar është i të njëjtit lloj me të cilën është punuar banesa, por ka edhe raste kur zgjidhet gur i një përbërjeje tjetër ose raste kur merrej guri i dekoruar i rrënojave të një muri të prishur, dhe vendosej ne banesën e re.

---

[1] Artikull i botuar në revistën Monumentet, 2002, fq.67-63





Ka raste kur dekoracioni lyhej; vendi i thelluar nga dalta lyhej me gëlqere, bojë blu ose jeshile.

Takohen dy lloje punimi, kjo më tepër varet nga lloji i dekorit: dekori thellohet me gdhendje, ose dekori del në reliev dhe gdhendet fusha.

Në fillim mjeshtri zgjedh vendin e gurit, mendon për dekorin, punon dhe krijon faqet (kur është gur cepi), pastaj, me daltë të kalitur e me majë, vizon në gur dekoracionin. Së fundi, gdhend dekorin dhe e vendos gurin në mur.

Dëshira e parë e imagjinatës figurative është shprehur me lënien e shenjës, një pikë apo një vijë, vijë e shkurtër. Kështu i gjejmë dhe sot. Pasi lëmohet e axhustohet sipërfaqja e gurit, mbi të me daltë gdhenden copa të shkëputura vijash të pjerrëta si pikat e shiut me re (Fig.1).

Më e avancuar është ideja e vijave paralele diagonale që dekorojnë faqen e gurit. Zakonisht takohen me pjerrësi nga e majta (Fig. 2). Në Fig. 3 kemi kryqëzimin e tyre dhe krijimin e rombeve. Më vonë është kaluar (Fig. 4) në pikëzimin e qendrës së rombit. Këtë gur e gjeta në një shtëpi në Pezë të vogël (Tiranë), punuar nga mjeshtra korçarë. Zig-zagu dhe rombet, të futura në një shirit në një pjesë të gurit i gjeta në Mavrovë (Vlorë) në një gur harku-portë (Fig. 5). I njëjti motiv është përdorur i dyfishtë, vendosur mbi një bazament trapeze (Fig. 6).

Po nga ata mjeshtër korçarë në Pezë të vogël (Tiranë) gjeta një dekor kompozite (Fig. 7), ku vijat e shkurtra të thelluara anës perimetrit të gurit janë futur brenda katërkëndëshave të vegjël.



Në Fig. 8 jepet një gur i mesit të harkut të portës, ku vijat brenda një kornize të gjerë vendosen në drejtime të pjerrta, të parregullta (poshtë), më shumë afrohet me një lloj linjash të pastra, me një sistem të brendshëm, të mbyllur. Një stad më i avancuar duhet të ketë qenë futja e gjysmë rrethit, harkimi i linjës (Fig. 9). Këtë gur në cep të shtëpisë e kam gjetur në Ndroq, punuar nga mjeshtër korçarë. Faqja tjetër e këndit ka të gdhendur një gjarpër, një avion, një ballonë. (Fig. 8) Pra, këtu kemi një inventar të pakët të figurave primitive dhe motiveve pagane dhe atyre moderne, të hedhura krejt në mënyrë të lirshme.
Thellimet dhe pikëzimet jane lyer me bojë të gjelbër.
Varianti tjetër (Fig. 10) ndodhet po në këtë banesë. Këtu mjeshtri korçar përdor tre elemente të përdorura deri tani: vijat diagonale, rombin e brendashkruar dhe vijat e harkuara gjysmërrethore ose eliptike.
Në një banesë në Kala-Ndroq gjeta një tjetër gur (Fig. 11) ku janë përdorur vetëm vija eliptike dhe me to është bërë një kompozim. Edhe në këtë rast ka qenë po i njëjti grup mjeshtrish korçarë.
Ata variojnë (Fig. 12) duke mos dashur të përsërisin vetveten, me një trajtim në kreshendo të vijës eliptike si një përsëritje dallgë (banesë në Ndroq). Po këta mjeshtra, që kanë punuar në disa fshatra të zonës në Pezë të vogël, kanë përdorur harkun dhe vijën e drejtë (Fig. 13) për të dekoruar një gur tjetër. Fig. 14 është nga gdhendja e një guri në Kuç të Zi (Korçë). Këtu kemi katër cepa të harkuar, një bisk hëne dhe një rozetë në pjesën e poshtme të gurit.
Elementët që do të paraqesim tani (Fig. 15-22) kanë në bazë rrethin.













Fig.15 është skema e një rrote me një aks, gjashtë rreze radiale dalin nga qendra drejt perimetrit. Në një banesë mirditore (Fig. 16) shohim këto rreze të bëhen një figurë radiale pesëfletëshe.

Në Fig. 17, përveç gjashtë fletëve që takohen me perimetrin, kulmet e tyre lidhen me nga një segment të harkuar.

Në Fig. 18, pesëfletëshit të brendashkruar në rreth i mungon rrethi i vogël aksial.

Në Fig. 19, sipërfaqja e rrethit ndahet në pesë trekëndësha që janë njëkohësisht dhe kulmet e një ylli.

Fig. 20 na jep ndarjen e sipërfaqes në shtatë fletë radiale.

Me gjashtë fletë e gjejmë në një variant në Kuç të Zi (Korçë).



Fig. 21 është skema e yllit me gjashtë cepa (Krujë), kurse Fig. 22 ka tre rrathë koncentrikë, dy në qendër dhe një periferik, mbi të cilin zhvillohen nëntë fletë eliptike. Të gjitha këto forma që bazohen në rrethin e gjysmërrethin janë vazhdim i një tradite që ka fillesën në një epokë të largët të parahistorisë njerëzore. Format që do të klasifikojmë më poshtë (Fig. 23-27) janë të çliruara nga brendashkruarja në një rreth dhe dalin si figura më vete. Mendoj që kjo duhet të ketë qenë një fazë e mëvonshme.

Fig. 23 është një yll me një qendër dhe brinjët ndërpriten e duken të vizuara.

Në Fig. 24, ylli pesëcepësh është afër yllit zyrtar, kurse në Fig. 25 kemi një rrezatim tetëcepësh, trekëndëshat e të cilit dalin nga një rreth i madh qendror. Kjo duket mirë që është simbol astral (dielli), këto simbole morën zhvillim të veçantë në shek. 14-16.

Në Fig. 26 kemi një figurë shtatëkëndëshe me brinjë të kurbëzuara konvekse.

Në Fig. 27 (banesë në Mirditë) kemi katër rombe që i lidh vizualisht një pikë qendër.

Këto ishin skemat e dekoreve që donim të parashtronim, të zhvilluar në gdhendjen lineare në gur. Forma e skema më të pasura, më të komplikuara, i takojmë sidomos pas pushtimit osman, i cili nuk lejoi përfaqësimin antropomorf, dhe mjeshtrit, sidomos ata myslimanë, zhvilluan arabeskun, por unë doja të ndaja, të veçoja e të sistemoja dhe të klasifikoja ato skema gdhendjeje që mendoj se janë arkaike dhe kanë qenë e janë tregues të një tradite të ruajtur gjatë.

Më së fundi dua të paraqes disa foto:1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, të gurëve prej ku janë nxjerrë skemat e vizatuara. Foto 1 është marrë nga albumi ARTI POPULLOR SHQIPTAR dhe është porta e një kulle mirditore.

Fotot 2 dhe 3 janë marrë në Ndroq. Fotot 4 dhe 5 paraqesin gurët e një porte në Dardhë të Korçës.

Fotoja 6 është po nga Dardha dhe së fundi foto 7 paraqet disa gurë të murit të apsidës së Kishës së Shën Kollit në Voskopojë.

SHËNIM: Vizatimet dhe fotot janë të autorit.

Maks VELO

SIMPLE LINEAR DECOR IN STONE[1]

The article elaborates the stone carving. All the sites and places mentioned in the article are Illustrated with schemes and pictures. The author traces the stone carving history. He has managed to distinct, to arrange and classify those carving schemes that are thought to be archaic and have been and still are indicators of a tradicion preserved for quite a long time in the Southern and Northern part of Albania. Another fact is underlined, that the great masters of stone carving are the masters from Korça.

[1] Article Published in the journal Monumentet, 2002 pp.67-73

KLITI KALLAMATA



Dr. Kliti Kallamata arkitekt restaurator. Lindi në Tiranë më 26 gusht 1955. U diplomua "Arkitekt" në Fakultetin e Inxhinierisë, Dega Arkitekturë, në Universitetin e Tiranës, në vitin 1979.

Pas marrjes së diplomës, gjatë viteve 1979-1981 punoi si inxhinier në zbatim, në Ndërmarrjen e Ndërtimit të Korçës. Më 1981 fillon punën në Drejtorinë Rajonale të Monumenteve të Kulturës në Korçë, në fillim si arkitekt-restaurator dhe që nga viti 1989-2006 si Drejtor i saj. Nga viti 2006 del në profesion të lirë, si drejtues i fondacionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore "E Shkuara për të Ardhmen" me qendër në Korçë.

Mbron titullin Master për **Mbrojtjen, Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve të Arkitekturës,** pranë Fakultetin të Arkitekturës të Universitetit Aristotel të Selanikut, Greqi.

Ndjek Programin e kualifikimit pasuniversitar **Konservimi dhe Manaxhimi i Ndërtesave Historike,** organizuar nga Zhvillimi i Banesave & Manaxhimi dhe Konservimi Arkitektural dhe Restaurimi, Universiteti i Lund nën sponsorizimin e Agjencisë Ndërkombëtare të Kooperimit dhe Zhvillimit, Lund, Suedi 2007 dhe Valparaiso, Kili 2008.

Vazhdon më tej kualifikimin e tij shkencor duke mbrojtur gradën Doktor i Shkencave Historike pranë Fakultetit të Historisë të Universitetit të Tiranës, me temë **Arti dhe Arkitektura Pasbizantine në Shqipëri.**

Në përpjekjet për rritjen e kualifikimit shkencor ka fituar bursa studimore nga DAAD, 1990-1991, pranë Christlische Arkeologie Fakultat në Universitetin Philipps të Marburgut, Gjermani, e shfrytëzuar për të studiuar Ikonografinë Bizantine, si dhe nga Getty Grant Program (Getty Foundation) dhënë nga Universiteti i Santa Monica-s në Kaliforni dhe e shfrytëzuar gjatë periudhës 1993-1994 përsëri pranë Christlische Arkeologie Fakultat në Universitetin Philipps të Marburgut, Gjermani, për të studiuar Ikonografinë Bizantine.

Veprimtaria studiuese dhe botuese është e konsiderueshme dhe me tematikë të gjerë, duke rrokur si trashëgiminë arkitektonike, ashtu dhe atë të artit:

- IKONA - Kuptimi dhe Simbolizmi, monografi, 1998

- "Mbi Restaurimin e Pazarit të Korçës". *Monumentet,* 1988, 2.

- "Arkitektura dhe Urbanizmi në Korçë", në *ARCHIN*, Nr.3, 1996, Shkup – revistë për arkitekturën, urbanizmin dhe projektimin

- "Kisha e Shën Gjergjit në Shipckë, Shqipëri", në *LOGGIA, Arquitetctura & Restauracion*, Nr. 24, Valencia, Spanjë,– revistë periodike e specializuar mbi konservimin dhe restaurimin e arkitekturës.

E pashkëputur nga veprimtaria studimore dhe botuese ka qenë dhe pjesëmarrja në Simpoziume dhe Konferenca Kombëtare e Ndërkombëtare:

- Konferencë Ndërkombëtare "Mbrojtja, studimi dhe restaurimi i monumenteve të kulturës në Shqipëri", Berat, shtator 1988, me kumtesën **"Mbi restaurimin e Pazarit të Korçës"**
- Seminari i I-rë Ndërkombëtar mbi "Principet moderne në konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore urbane dhe rurale në rajonet sizmike", tetor 17-22, 1988, Shkup
- Simposium Ndërkombëtar: "Një territor i panjohur: Arti dhe arkitektura e Shqipërisë në kontekstin ballkanik", Prill 14-17, 1994, Minneapolis, Minnessota Sh.B.A., me kumtesën **"Arti dhe Arkitektura e Voskopojës".**
- Konferencë Ndërkombëtare mbi Gjeografinë Historike: "Rrugët dhe Kryqëzimet në Ballkan: Prej Antikitetit deri në Bashkimin Evropian", shtator 25-27, 1995 Selanik, Greqi, me kumtesën: **"Voskopoja dhe Korça - dy qytete me të njëjtin gravitet".**
- Kolokium Ndërkombëtar "Voskopoja", Tetor 31-Nëntor 1, 1996, Selanik, Greqi, me kumtesën: **"Konstantin Ieromonaku - një piktor ikonograf në Voskopojë**".
- Konferencë ndërkombëtare "Restaurimi dhe rehabilitimi i ndërtesave dhe qyteteve historike" Selanik, Greqi, bashkautor me Prof. Dr. Pirro Thomo me kumtesën: **"Probleme dhe kritere në restaurimin e ndërtesave historike në Korçë".**
- Konferencat Ndërkombëtare Trilaterale (Shqipëria, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut): **"Mbrojtja e mjedisit dhe vlerave historike në rajonin e Korridorit 8**", qershor 4-6, 1999, Strugë, tetor 15-18, 1999, Divjakë.
- Simpozium Ndërkombëtar: "Ikonat e Periudhës Bizantine dhe Postbizantine", qershor 2000, Marburg, (Gjermani), me kumtesën: **"Një grup ikonash nga Korça".**
- Simpozium Ndërkombëtar "2000 vjet Art dhe Kulturë Kishtare në Shqipëri" 16-18 Nëntor 2000, Tiranë, me kumtesën: "**Rreth tipareve të reja në Programin Ikonografik të shek. 18".**

Nga pjesëmarrja me kumtesa **në** simpoziume kombëtare mund të përmendim si më të rëndësishme:

- Simpoziumet e Muzeut të Muzeu të Artit Mesjetar, Korçë, Maj 1986, tetor 1989, me kumtesat: "**Urbanistika dhe Arkitektura e qytetit të Korçës. -Probleme të konservimit", "Restaurimi i zonës muze të Pazarit të Korçës dhe problemet e integrimit të tij në jetën e sotme ekonomiko-shoqërore".**
- Simpoziumet "Arti ikonografik në Shqipëri". shtator 1995 dhe shtator 1996 në Korçë, me kumtesat: **"Programi ikonografik në kishat postbizantine të Shqipërisë" dhe "Evolucioni i programit ikonografik në bazilikat postbizantine të Voskopojës".**
- Simpoziumin "Voskopoja - Një fenomen shqiptar dhe Ballkanik", Korçë, tetor 1998, me kumtesën: **"Ikonat e kishave të Voskopojës".**

Kualifikimi shkencor i Kliti Kallamatës ishte i pandarë nga veprimtarinë e tij restauruese, në hartim projektesh, drejtim dhe zbatim të punimeve restauruese e konservuese, e cila ka ardhur gjithnjë në rritje. Këtu mund të përmendim:

- Projekt Konservimi për Varrezën Tumulare në Kamenicë, shek.12-6 p.e.r., 2004
- Punime Restaurimi, Konservimi e Vlerësimi në bazilikën paleokristiane në Lin të Pogradecit (shek 5-6) 2008
- Kisha e Shën Joanit në Boboshticë, shek.15, 1983-88.
- Kisha e Shën Dhimitrit në Boboshticë, shek.16, 1984 -88.
- Kisha e Kryeengjëjve Mihal e Gabriel në Vithkuq, shek. 17-18, 1984-85.
- Manastiri i Shën Marenës në Pogradec, shek.18, 1983-84.

- Kisha e Shën Marisë në Lashovë 1982-83.
- Projekte dhe punime restauruese në kishat postbizantine të Voskopojës, 1986-2005.
- Xhamia e Ilias Mirahorit, Korçë, shek. 15, 1996, 2000.
- Kisha e Shënjtorëve Kozma e Damiano në manastirin e Shënjtorëve Pjetër e Pavël në Vithkuq, shek.18, 2003
- Kulla e Turanit, shek.16, 2004
- Kisha e Shën Gjergjit e Shën Dhimitrit në Shipckë, shek 18, 2004-08.
- Teqeja në Qesarakë, 2009-2010

-Projekte dhe restaurime të shumë banesave "monument kulture" në qytetet dhe rrethet e Korçës, Pogradecit, Devollit e Kolonjës, 1981 – 2004.

-Hani i Manastirit në zonën muze të Pazarit të vjetër në Korçë, 1986.
-Hani i Oparakëve, 1986
-Hani i Baba Aliut, 1985, 2005
-Hani i Pëllumbit, 1985
-Ndërtesa e Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë, 1987
-Ndërtesa e ish-Liceut Francez në Korçë 2009
-Restorant "Valbona" në Korçë, fillim i shek.20, 1983
-Ndërtesa e Vjetër e Konsullatës Greke në Korçë 1920, 2003, 2021

- Rehabilitimi i Pazarit të Vjetër në Korçë, 1982 – 1999.

Studime për Qendra Historike dhe vënien në mbrojtje të tyre:

- Qendra Historike e qytetit të Korçës, 2002, 2005
- Qendra Historike e Voskopojës, 2003, 2005
- Qendra historike e qytetit të Pogradecit, 2003

Jo më pak e rëndësishme ka qenë dhe pjesëmarrje në Projekte Ndërkombëtare, si:

- "Towards Integrated Conservation and Sustainable development of Transboundary Macro and Micro Prespa Lakes", 1998-1999, koordinuar dhe mbështetur nga Qeveria Gjermane, 1998-99.
- "Studimi i Industrisë së Hershme në Shqipëri" mbështetur nga Fondacioni Kulturor i Grupit të Bankës së Pireut, 2008-2009.
- "Praktikat Inovative në Bioturizëm" mbështetur nga Programi i Bashkëpunimit CrossBorder Greqi-Shqipëri (IPA Programe) 2007-2013.

Rezultatet e larta studimore e restauruese të arritura nga Kliti Kallamata kanë tërhequr dhe vëmendjen e opinionit shkencor të huaj, duke u vlerësuar me çmime ndërkombëtare siç janë: -Çmimi **"Award 2011,** Amsterdam, Qershor 2011, i akorduar nga Organizata **European Union /Europa Nostra**, për projektin: "Restaurimi i Kishës së Shën Gjergjit në Shipckë".

-**The Best in Heritage**" dhe Anëtar i "Klubit të Ekselencës" në Dubrovnik Shtator 2012, për projektin: "Restaurimi i Kishës së Shën Gjergjit në Shipckë".

Arkitekti Dr. Kliti Kallamata u largua prej nesh më 29 dhjetor 2020, duke humbur betejën me virusin e pamëshirshëm Covid 19. Humbja e tij e parakohëshme ka lënë një boshllëk të pazëvendësueshëm në kolektivin e mbrojtjes dhe restaurimit të Trashëgimisë Kulturore.

KLITI KALLAMATA

Dr. Kliti Kallamata - architect restorer. He was born in Tirana on August 26, 1955. He graduated as “Architect” at the Faculty of Engineering, Department of Architecture, at the University of Tirana, in 1979.

After graduating, during the years 1979-1981 he worked in the Construction Company of Korça, as a civil engineer. In 1981 he started working in the Regional Directorate of Cultural Monuments in Korça, initially as an architect-restorer and from 1989-2006 as its Director. From 2006 he worked as the Director of the Foundation for the Protection of Cultural Heritage “The Past for the Future” in Korça.

Kliti Kallamata held a Master’s degree in Conservation, Conservation and Restoration of Architectural Monuments from the Faculty of Architecture of Aristotle University of Thessaloniki, Greece.

He continued his scientific qualification, defending the degree of Doctor of Historical Sciences at the Faculty of History of the University of Tirana, with the topic: Post-Byzantine Art and Architecture in Albania.

In an effort to increase his scientific qualification he won a scholarship from the DAAD, 1990-1991, at the Christlische Arkeologie Faculty - Philipps University in Marburg, Germany, where he studied Byzantine Iconography. He also won a scholarship from the Getty Grant Program (Getty Foundation) provided by University of Santa Monica in California during the period 1993-1994, again at the Christlische Arkeologie Faculty at Philipps University in Marburg, Germany, where he studied Byzantine Iconography.

The research and publishing activity is considerable and with a wide range of topics, covering both the architectural and the art heritage: The participation in National and International Symposiums and Conferences has been inseparable from the research and publishing activity. The scientific qualification of Kliti Kallamata was inseparable from his restoration activity, in project design, direction and implementation of restoration and conservation works, which has always been increasing.

The high research and restoration results achieved by Kliti Kallamata have attracted the attention of foreign scientific opinion, being appreciated with international awards such as: Award 2011, Amsterdam, June 2011, given by the Organization European Union / Europa Nostra, for the project: “Restoration of the Church of St. George in Shipcka”. - The Best in Heritage” and Member of the “Club of Excellence” in Dubrovnik, September 2012, for the project: “Restoration of the Church of St. George in Shipckë”.

Architect Dr. Kliti Kallamata left us on December 29, 2020, losing the battle with virus Covid 19. His loss has left an irreplaceable gap in the protection and restoration of Cultural Heritage community.





1.a Kisha e Shën Gjergjit, Shipckë, para restaurimit

1.b Kisha e Shën Gjergjit, Shipckë, gjatë restaurimit



2.*Kisha e Shën Gjergjit, Shipckë, pamja e jashtme mbas restaurimit*



3. Kisha e Shën Gjergjit, Shipckë, pamja e brendshme mbas restaurimit



4.*Presidenti i nderit i Europa Nostra, Plaçido Domingo duke i dhënë çmimin Kliti Kallamatës. Përbri Znj. Androulla Vassiliou, Komisioniere e Parlamentit Evropian për Edukimin, Kulturën, Multilinguismin dhe Rininë*



5.*Denis de Kergolay, Presidenti Ekzekutiv i Europa Nostra duke i dhënë Çmimin special për restaurimin e kishës së Shën Gjergjit, Shipckë, Kliti Kallamatës*



6. *Ish Konsullata greke, Korçë para restaurimit*



7. *Ish Konsullata greke, Korçë mbas restaurimit*

Kliti KALLAMATA

MBI RESTAURIMIN E PAZARIT TË KORÇËS[1]

Ndonëse pazari i Korçës ka filluar të ekzistojë qysh në fund të shek. XV, apo në fillim të shek. XVI, pamjen e tij, siç e shohim sot, nisi ta marrë mbas gjysmës së parë të shek. XIX. Futja e koncepteve të reja në urbanistikën dhe arkitekturën e pazarit u krye në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të qytetit të Korçës, të ndihmuar dhe nga pozicioni i ndërtimit të tij jashtë lagjeve të banuara të qytetit. Ky Pazar dallohet për një përputhje të zonimit funksional me një strukturë të përparuar urbanistike për kohën. Njësitë prodhuese e tregtare që janë kompozuar sipas skemës së rrjetit drejtkëndor, qarkohen nga një gjysmëunazë e formuar nga ndërtimet për pushim e çlodhje. Këto arritje në urbanistikë janë shoqëruar me trajtime të pasura në arkitekturë e dekoracion, që e bëjnë pazarin e Korçës të dallohet në mënyrë të ndjeshme nga pazaret e Krujës, Gjakovës, Shkodrës, Kavajës, Gjirokastrës, etj. Për këto veçori historike, urbanistike e arkitektonike, në vitin 1971, ky ansambël u vu në mbrojtje shtetërore. Që nga kjo kohë janë ndërmarrë studime të shumta, të cilat ndihmuan në orientimin, përcaktimin e vlerave dhe ndërhyrjeve restauruese për çdo njësi. Këto çuan në ndarjen e kësaj qendre në dy zona (Fig. 1). Ajo që ruante ndërtimet më me vlerë u cilësuan "zonë-muze", ndërsa rreth saj u konturua një "zonë e mbrojtur". Zona-muze e pazarit formohet nga 19 blloqe dyqanesh në pjesën qendrore të tij, të cilat rrethohen nga 30 dyqane dhe 8 hane të vendosura në formë gjysmërrethi. Blloqet e dyqaneve përgjithësisht janë të plotë, me përjashtim të disave prej tyre ku mungon ndonjë njësi që prish formën e rregullt të planimetrisë. Gjendja konstruktive paraqitet e mirë, por keqpërdorimi për një kohë të gjatë ka dëmtuar elemente të ndryshme, si në pamjet e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshme.

Ndryshe ishte gjendja e haneve, 4 prej të cilave paraqisnin rrezikshmëri për shkak të degradimit të tepërt të konstruksioneve prej druri. Me sa duket me konstruksion druri duhet të kenë qenë ndërtuar edhe disa njësi në këtë varg gjysmërrethor, të cilat janë shkatërruar krejtësisht duke lënë vende bosh midis 30 dyqaneve, të cilët paraqiten mjaft mirë nga ana konstruktive.

Zona e mbrojtur ka ndërtime të ndryshme, shumë prej të cilave janë përdhese, të rëndomta dhe pa vlera të rëndësishme. Megjithatë nga pikëpamja historike ato dokumentojnë lidhjen që ka pasur pazari me qytetin, duke mos qenë këto njësi krejtësisht të shkëputura nga njëra-tjetra. Këtu ngrihen edhe disa

[1] Artikull I botuar në revistën Monumentet, 2, 1988, fq.159-162

PAZARI I KORÇËS - Zonifikimi



banesa të tipit të njohur korçar, të ndërtuara në fillim të shekullit tonë. Kjo zonë nuk është e lidhur mirë me arteriet kryesore të qytetit dhe lejon kalim të automjeteve nëpër Pazar, gjë që shkakton disa herë dridhje të konsiderueshme në ndërtesat me ndotje të mjedisit. Gjithashtu, instalimet elektrike e telefonike janë ajrore duke dëmtuar pamjen e ndërtimeve të pazarit dhe krijimin e vështirësive gjatë restaurimit të tyre (Fig. 2). Duke konsideruar zonën e pazarit si pjesë përbërëse të qytetit të Korçës dhe duke marrë parasysh vlerat historike – arkitektonike të tij, u synua që ky ansambël të rigjallërohej dhe të mos mbetej një relikt pasiv. Kjo kërkonte integrimin e tij në jetën e sotme ekonomike, shoqërore dhe shpirtërore, dhe natyrisht, integrimin në planin e përgjithshëm urbanistik të qytetit. Në zonën e mbrojtur shumë ndërtime ishin dëmtuar, madje rëndë, në vlerat e tyre. Kjo krijonte mundësinë për sistemimin e sipërfaqes përreth "zonës-muze", duke lënë këto banesa dhe ndërtime që mund të rifitonin vlerat e tyre të dikurshme dhe duke krijuar sipërfaqe të gjelbra. Kështu lidhja e zonës – muze



me qytetin e sotëm arrihej mirë. Ndalimi i trafikut të rëndë brenda zonës – muze lindi nëvojën për e zgjerimit të rrugëve përreth zonës së mbrojtur dhe lidhjen e tyre me arteriet kryesore të qytetit. Në këtë mënyrë i gjithë ansambli do të qarkohet nga rrugë, të cilat do të krijojnë lehtësi qarkullimi për kalimin e automjeteve, pa qenë e nevojshme të futen në zonën – muze. Gjithashtu, për një integrim më të kujdesshëm nga ana urbanistike, është e nevojshme që ndërtimet, të cilat do të bëhen rreth tij, të harmonizohen me të, për të ruajtur atmosferën dhe për të krijuar një mjedis unik. Duke u bazuar në motivet e këtij veprimi planizues, qëllimi i të cilit është jo vetëm zbukurimi i këtij rajoni të qytetit, por edhe krijimi i një ansambli që të jetë i qendrueshëm, me perspektivë, u hartua një plan shfrytëzimi të ardhshëm të pazarit, për ta rigjallëruar atë, duke i dhënë një bazë të re jetësore. Rigjallërimi i pazarit duhej bërë duke ruajtur karakterin e ansamblit dhe funksionet e vjetra, por duke shtuar edhe funksione të reja, të cilat nuk ia tjetërsojnë këtë karakter. Gjatë hartimit të këtij plani duhej përcaktuar se si dhe në çfarë mase këto dyqane janë të përshtatshme për këtë apo atë nevojë të jetës së përditshme, duke pasur parasysh edhe kërkesat e ardhshme praktike e estetike. U mendua që pjesa qëndrore e pazarit të shërbejë për tregtinë dhe shërbimet në popull, duke futur mjeshtritë tradicionale që vazhdojnë të ruhen ende, si p.sh.: këpucar, rrobaqepës, teneqexhinj, argjendarë, araçë, etj. Edhe njësitë për tregtinë do të jenë të llojeve të ndryshme, si ato për stofra, veshje, prodhime artistike, orendi shtëpiake, kinkaleri etj. Nuk do të mungojnë edhe lokalet e ushqimit social si restorante, rostiçeri, mëngjesore, pastiçeri etj. Njësitë në pjesën veriore të kësaj zone shërbimi u caktuan të përdoren për kompleksin e kulturës popullore të rrethit, ku do të prezantohen edhe vlerat e veprimtarive prodhuese të këtij ansambli. Këtu bëjnë pjesë: Hani i Elbasanit, si Hotel-restorant karakteristik, Hani i Manastirit si ekspozitë e kulturës popullore (Fig. 3) dhe vargu i dyqaneve në shërbim të këtij kompleksi.

Ndër funksionet e reja që mendohen të futen në Pazar, janë edhe adaptimet për studio artistësh (piktorë, skulptorë, arkitektë, muzikantë, etj) të disa blloqeve në krahun jugor të ansamblit. Në këtë mënyrë do të krijohet një "mikrolagje" krijuesish, në qendër të së cilës do të jetë një sallë për ekspozita të ndryshme sezonale, apo koncerte dhome. Pjesa tjetër e dyqaneve, për njëfarë kohe, u la të përdoren si zyra të ndërmarrjeve e institucioneve të ndryshme. Të gjitha këto studime u kryen me qëllim që ndërhyrjet restauruese të ishin të orientuara dhe të gjykuara mirë. Ishte e natyrshme që në një ansambël



të tillë kërkesat për restaurim të ishin shumë të ndryshme. Ato renditen nga qëndrimi shumë rigoroz për të ruajtur tiparet dhe elementët e ndryshme të arkitekturës e deri te çlirimi nga ndërtimet e vona, që nuk kanë respektuar vlerat e ansamblit. Për sa u përket punimeve restauruese, dallohen dy lloje apo grupe ndërhyrjesh:

I pari ka të bëjë me ripërtëritjen e godinave duke zbatuar kriteret rigoroze të restaurimit për çdo njësi. Punimet kanë kryesisht karakterin e ripërtëritjes së pamjeve të jashtme e të brendshme, duke ruajtur dhe restauruar çdo element arkitektonik. Për të realizuar kërkesat funksionale, në çdo rast, janë bërë ndryshime të brendshme për bashkimin e disa njësive në katet e poshtme, apo të sipërme. Kështu p.sh. dyqanet 1, 2, 3 janë të veçanta, por në kuadrin e kompleksit të kulturës popullore këto lidhen me njëra-tjetrën për të lehtësuar lëvizjen e vizitorëve. Ose, në njësitë e tjera, ku nuk ka podrume, mund të ndërtohen shtresa të forta betoni për makineritë e ndryshme, apo të bëhen punime të tjera, por gjithnjë duke mos cenuar vlerat e strukturave të brendshme dhe duke paracaktuar dyqanet e përshtatshme për funksionet që nevojiten. Vështirësitë në këtë drejtim nuk janë të mëdha dhe problemet që dalin janë më tepër çështje kompetence, kujdesi dhe cilësie teknike në punë. Në restaurimin e zonës – muze, një vëmendje të veçantë kërkon zgjidhja e problemeve teknike, siç janë ato të kanalizimeve, linjave elektrike e telefonike, ngrohja etj, të cilat detyrimisht duhet të jenë të gjitha nëntokësore.

Në ndërhyrjet e llojit të dytë, problemet që shtrohen për t'u zgjidhur kanë të bëjnë me punime çliruese, për të vlerësuar të gjithë ansamblin. Këto veprime do të kryhen kryesisht në "zonën e mbrojtur" dhe rrallë në "zonën – muze", siç qe prishja e ndërtesës së vonë në mes të sheshit "Liria". Kjo u bë me qëllim që të rikrijohet përsëri tregu i hapur i dikurshëm dhe të dalin në pah vlerat e dyqaneve përreth tij.

Së fundi, një çështje me rëndësi është mënyra se si do të trajtohen njësitë që mungojnë. Disa mënyra janë në diskutim e sipër. Ekziston mendimi për të mos kryer asnjë ndërtim në këto vende bosh, veç sistemimit të tyre ashtu siç janë. Kjo mund të gjejë zbatim në disa blloqe, por mund të dëmtojë disa të tjera. Prandaj ekziston edhe mendimi tjetër, I cili është për plotësimin e vendeve bosh me njësi të reja, që të harmonizohen me arkitekturën e bllokut dhe të ansamblit. Çështja e ndërtimeve të reja brenda zonës – muze është një problem delikat që qëndron ende i hapur dhe kërkon vlerësime kolektive të peshuara.

Studimet e përgjithshme për restaurimin e pazarit të Korçës janë hartuar dhe miratuar në instancat përkatëse prej disa vitesh. Ky ansambël i restauruar do të përbëjë një dëshmi me vlera të rëndësishme në trashëgiminë tonë urbanistike – arkitektonike.

Kliti KALLAMATA

SUR LA RESTORATION DU BAZAR DE KORÇA[1]

Mis sous protection de l'État pour ses valeurs, le bazar de Korça, se distingue par la structure urbaine avancée par rapport à l'époque et l'évaluer particulière de son organisation fonctionnelle. Les unités de production et commerciales qui ont été composes suivant le schéma du réseau quadrangulaire, sont entourés d'un demi – anneau formé par les constructions conçues pour repos. Le traitement architectonique de l'ensemble se distingue par la solution fonctionnelle et par la riche décoration, en lui réservant une place particulière dans l'héritage de ce genre.

Selon les valeurs que représente, le bazar de Korça se divise en "zone musée" et "zone protégée". Prégnant en considération les valeurs historiques et architectonique de cet ensemble on a visé à ce qu'il se réanime. Ceci impose son intégration dans la vie quotidienne économique et sociale, naturellement dans le plain urbain. Dans la zone protégée, vu sa valeurs double en tant que partie de l'ensemble et point de liaison avec la nouvelle ville, dans un grand nombre d'unités aux constructions de valeurs, et créer des surfaces vertes. Le réseau routier tout autour de cette zone sera élargi parce que dans la zone musée il sera interdit la circulation des poids lourds. Les nouvelles constructions tout autour de l'ensemble au point de vue de dimensions et traitement doivent s'harmoniser avec les anciennes.

La perspective des interventions a été rendu plus facile un plan détaillé concernant les futures fonctions de cet ensemble après la restauration. On a jugé convenables de telles fonctions comme artisanes traditionnel, locaux de service, musée de la culture populaire, adaptations pour studios de créateurs, etc.

De pair aux interventions originales, on a prévu également quelques interventions de débarrassèrent de constructions sans valeur et plus tardives qui lui nuisent. Quant à l'attitude envers les constructions ruinées, dans de différentes parties de l'ensemble, il a été pré consenti la protection de la situation existante sans exclure quelques interventions complémentaires, toujours après de motivations convaincantes.

Les études générales pour la restauration du bazar de Korça, ont été rédigées et approuvées par les instances respectives et depuis des années, sur une base d'études partielle, continue le travail por la restauration et la réanimation de cet ensemble de valeurs importantes.

---

1 Article publié dans la revue Monumentet, 2, 1988 pp.159-162

MUSTAFA ARAPI



Piktor restaurator, lindi në Tiranë më 23 korrik 1950. Më 1972 kryen studimet në Liceun Artistik "Jordan Misja", Tiranë, ndërsa më 1979 diplomohet Piktor – Grafist në Institutin e Lartë të Arteve. Në vitin 1979 emërohet Restaurator – Studiues në Sektorin e Artit Bizantin pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë, duke vazhduar si shef i këtij Sektori më 1993, deri sa doli në pension më 2006. Gjatë kësaj periudhe ka qenë Anëtar i Këshillit Shkencor të Restaurimit pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës (1998 – 2005) dhe Anëtar i Këshillit Kombëtar të Restaurimit (2002 – 2006), Sekretar i Shoqatës së Restauratorëve Shqiptarë, 2004, si dhe Anëtar i Komisionit të Lartë Shtetëror të Pullës Postare Shqiptare (1995-2006).

Mustafa Arapi është dalluar dhe për veprimtarinë e tij të mësimdhënies, si Pedagog i Restaurimit të veprave të Artit në Institutin e Restaurimit, Tiranë (2000–2003), Pedagog i Vizatimit dhe Pikturës pranë Akademisë së Arteve, Tiranë (1985 -1991) dhe Pedagog ne Fakultetin e Arteve të Bukura ne UAT (2010- 2012).

Si studiues M. Arapi ka lënë një bibliografi shumë të pasur artikujsh e monografish:

1. "Konservimi dhe restaurimi i pjesës qendrore të ikonobartësit të kishës së Evangjelizmosë të kalasë së Beratit", Monumentet, 1984, 1 (27)
2. "Problemet e restaurimit të disa ikonave", Monumentet, 1988, 2 (36) (me bashkautor)
3. "Disa vlera të përftuara nga restaurimi i një vepre të Onufrit", Monumentet, 1990, 2 (40)
4. "Analiza e dy ikonave të piktorit David Selenica", Monumentet, 1992-1998
5. "Dormicion", "Onufër Qiprioti", Drita, 1996
6. "Onufër Qiprioti, ikonograf në Artin shqiptare mesjetar", Drita, 1996
7. "Rubin të rrallë ", Drita, 1997
8. "Onufër Qiprioti, ikonograf i shk. XVI-XVII", Monumentet, 2004
9. "Nikolla - bir i Onufrit, dhe jo i Onufër Qipriotit", Monumentet, 2005
10. "Të dhënat paraprake mbi përbërjen e pigmenteve të përdorura në disa ikona të piktorëve mesjetarë shqiptarë të mesjetës" (Bashkautor), 2000 Vjet Art dhe Kulturë Kishtare në Shqipëri, Tirane, 2003
11. "Restaurimi i pikturës murale të Onufër Qiprioti dhe Alivizi Foka në kishën Shën Maria në

fshatin Vrahogoranxi", Monumentet, 2006
12. "Rilindja e një pikture të vjetër", Ringjallja, shkurt, 2006
13. "Zbulime të reja në autorësinë e disa ikonave", Monumentet, 2007
14. "Studimi i pikturave murale në kështjellën e Beratit (Shqipëri): ekzaminimi krahasues i materialeve dhe teknikave në shek. XIV-XVI", (bashkautor), Gazeta e Trashëgimisë Kulturore, 2008, Francë
15. "Le scuole e i secoli (Onufri)", Venezia, le Marche la civiltà adriatika, Edizione della laguna, 2003
16. Bashkautor në vëllimin Historia e Popullit Shqiptar, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, 2002
17. Monografi Onufër Qiprioti, ikonograf i shekullit XVI –XVII
18. Autor i teksteve në katalogët e ekspozitave jashtë shtetit:

- 1993 Tresors d'Art d'Albanie, Paris
- 2002 Ikonen aus Albanien, Mynih, Gjermani
- 2002 Ikone di Albania, Ankona, Itali
- 2002 Percorsi del Sacro, Vicenza, Itali.

Po kaq e gjerë është dhe veprimtaria e M. Arapit në fushën e konservimit dhe restaurimit të veprave të Artit:

1980 – 1983 Në afreskat e kishës së Shën Mëhillit, Vithkuq (shek. XVIII)
1981 – 1983 Në afreskat e kishës së Shën Pjetrit dhe Pavlit, Vithkuq (shek. XVIII)
1985 – 1988 Në afreskat e trapezarisë të manastirit të Apolonisë (shek. XIV)
1980 – 1993 Në afreskat të kishës së Ristozit në Mborje të Korçës (shek. XIV)
1988 – 1991 Në afreskat e kishës së Shën Kollit në Perondi të Kuçovës (shek. XIV)
1999 – 2000 Në afreskat e kishës së Shën Marisë në Leusë të Përmetit (shek. XIX)
2001 Në pikturën e tavanit të kishës së Shën Kollit në fshatin Grabovë (shek. XVIII)
2001 Në ikonostasin dhe tavanin e kishës së Gjithë Shenjtorëve" në Himarë (shek. XVIII)
2003 Në ikonostasin e kishës së Shën Marisë, Vrahogoranxi-Gjirokastër (shek. XVI - XVII)
2006 Në ikonostasin e kishës së manastirit të Shën Marisë në Zvërnec, Vlorë (shek. XVIII)
2007 Në tavanet e shtëpisë së Zekateve, Gjirokastër
2008 Në pikturën murale të kishës së manastirit të Shën Gjergjit të Demës, Sarandë (shek. XVII –XVIII)
2008 Në ikonostasin dhe pikturën murale të kishës së Shën Marisë në fshatin Zervat, Gjirokastër (shek. XVII)
2008 Në pikturën murale të kishës të manastirit të Shën Marisë të Kakomesë, Sarandë (shek. XVII)
2009 Në pikturën murale të kishës të Shën Nikollës në fshatin Shelcan, Elbasan (pikturë e Onufrit)
2016 Në pikturën murale të Katedrales Katolike e Zojës Ndihmëtare në Prizren, Kosovë
2016 Në pikturën murale dhe tavanin e kishës së Shën Thanasit, Karavasta, Lushnjë (shek. XIX)

Konservim i shumë ikonave të autorëve Onufri, Nikolla i Onufrit, Onufër Qiprioti, Kostandin Shpataraku, Joan Athanas, Kostandin dhe Athanasi nga Korça, të Çetirëve etj.

Gjatë punës restauruese zbuloi emra të panjohur piktorësh, si emrat e dy ikonografëve të panjohur Jorgo dhe Panajoti (viti 1717) në apsidën e kishës së Shën Mëhillit në Vithkuq të Korçës më 1983, si dhe një seri të veprave të panjohura të ikonografit Onufër Qiprioti më 1989.

E pa shkëputur nga veprimtaria studiuese dhe restauruese ka qenë dhe krijimtaria artistike e Muastafa Arapit, ku u shfaq fuqishëm talenti dhe pjekuria e tij, duke e renditur Mustafain ndër piktorët jo vetëm më me produktivitet, por dhe me nivel të lartë artistik të vendit dhe me jehonë në artin botëror të periudhës së tij.

Mustafai ka çelur ekspozita të shumta brenda dhe jashtë vendit, si në Francë, Itali, Holandë, Turqi, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë e Hercegovine,

Kosovë, si dhe ka përfaqësuar pikturën shqiptare në bienalet e Turqisë, Egjiptit, Polonisë.

Për nivelin e lartë artistik të veprave të tij Muastafai është nderuar me çmime të larta nga vendi dhe bota e jashtme, ndër të cilat mund të vëmë ne dukje:

1995 Çmim i parë në ekspozitën ndërkombëtare të artit bashkëkohor "World Concept", dhe vepra e tij bëhet fond i "Muzeut Nacional të Arteve të Bukura" të Budapestit, Hungari

1998 Çmim i parë nderi, Biennalja Ndërkombëtare e Grafikës, me pjesëmarrjen e 1800 grafisteve nga vendet e botës, Raciborz, Poloni

2020 ''Piktori i vitit 2019". Titulli i lartë dhënë nga Akademia Alternative, Pegasiane

2020 "Ambasador i Paqes" dhënë nga Federata Universale e Paqes

2021 "Golden Osten Award" (Çmimi i Artë Osten), Osten Biennal of Drawing of Skopje, Shkup, Maqedonia e Veriut.

Më 1989 dekorohet nga Parlamenti Shqiptar me "Urdhrin Naim Frashëri".

Më 2021 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë i jepet titullin "Mjeshtër i Madh'' (pas vdekjes).

Mustafai, Faja siç i thërrisnim, nuk mundi të fitonte betejën me COVID 19 dhe u nda prej nesh më 21 janar 2021, duke i lënë një boshllëk të madh krijimtarisë artistike mesjetare, që ende kaq shumë prisnin të zbuloheshin nga dora e tij e talentuar dhe po kështu botës artistike moderne do t'i mungojnë ekspozitat mbresëlënëse të Fajës.

MUSTAFA ARAPI

Mustafa Arapi, restoration painter, born in Tirana on July 23, 1950. He studied at the Artistic High School "Jordan Misja", Tirana, in 1972, while in 1979 graduated as a graphic painter at the High Institute of Arts. In 1979 he was appointed Research Restorer in the Sector of Byzantine Art at the Institute of Cultural Monuments, Tirana, continuing as head of this Sector in 1993, until he retired in 2006.

During this period he was a Member of the Scientific Council of Restoration at the Institute of Cultural Monuments (1998 - 2005) and Member of the National Council of Restoration (2002 - 2006), Secretary of the Association of Albanian Restorers, 2004, and Member of the State High Commission of the Albanian Postage Stamp (1995-2006).

Mustafa Arapi has also been distinguished for his teaching activity, as a Lecturer of Restoration of Art Works at the Institute of Restoration, Tirana (2000–2003), Lecturer of Drawing and Painting at the Academy of Arts, Tirana (1985 -1991) and as Lecturer at the Faculty of Fine Arts at UAT (2010-2012).

As a researcher, M. Arapi has left a very rich bibliography of articles and monographs. He was the author of texts in the catalogs of exhibitions abroad:

- 1993 Tresors d'Art d'Albanie, Paris
- 2002 Ikonen aus Albanien, Munich, Germany
- 2002 Ikone di Albania, Ancona, Italy
- 2002 Percorsi del Sacro, Vicenza, Italy.

Equally extensive is the activity of M. Arapi in the field of conservation and restoration of art works, frescoes, icons, iconostasis and decorative ceilings.

During the restoration work he discovered unknown names of painters, such as the names of two unknown iconographers Jorgo and Panajoti (year 1717) in the apse of the church of St. Michael in Vithkuq of Korça in 1983, as well as a series of unknown works of the iconographer Onufër Qiprioti in 1989.

Inseparable from the research and restoration activity was the artistic creativity of Mustafa Arapi. His talent and maturity were strongly displayed, ranking Mustafa among the painters with the most productive activity, with a very high artistic level in Albania who also echoed in the world art of his period.

Mustafa has opened numerous exhibitions inside and outside the country, such as in France, Italy, the Netherlands, Turkey, Northern Macedonia, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, and has represented Albanian painting in biennials in Turkey, Egypt, Poland. For the high artistic level of his works Mustafa has been honored with high awards from the country and the outside world.

The Albanian Parliament honored him with the "Naim Frashëri Order" in 1989.

The President of the Republic of Albania, In 2021, honored him with the title "Grand Master" (after his death).

Mustafa or Faja, as we called him, could not win the battle with COVID 19 and was sepparated from us on January 21, 2021. He left a huge void in medieval artistic creativity, which was still so much waiting to be discovered by his talented hand, and likewise, the modern artistic world will miss Faja's impressive exhibitions.

















Kisha e Shën Marisë Leusë, Përmet









Kisha e Shën Kollit, Grabovë













Kisha e Shën Marisë, Vrahogoranxi, Gjirokastër









Kisha e Shën Marisë Zervat, Gjirokastër









Kisha e Shën Thanasit Karavasta, Fier



Katedralja Prizren, Kosovë

Mustafa ARAPI

KONSERVIMI DHE RESTAURIMI I PJESËS QENDRORE TË IKONABARTËSIT TË KISHËS SË EVANGJELIZMOS TË KALASË SË BERATIT[1]

Shumica e ikonave të këtij ikonabartësi që ndodhen në fondin e Muzeut Mesjetar të Korçës[2] konsiderohen vepra të piktorit tonë të shquar mesjetar Onufri.

Brezi i sipërm i ikonabartësit përbëhet prej tri panove: pjesës qendrore me skenën e Deisis (Lutja) (98 x 77 cm), (Fig. 1 a, b), krahu i djathtë me katër apostuj (144.5 x 53 cm) (Fig. 3). Panotë janë prej druri arre. Gjendja e tyre në përgjithësi nuk është e mirë, me dëmtime nga brejtësit që krijojnë vende/vende një pamje sfungjerore (Fig. 4) dhe me një të çarë vertikale që përshkon të gjithë panonë nga lart poshtë (Fig. 5). Panotë janë të qarkuara me një kornizëm emotiv të gdhendur në formë gërsheti.

Grunti i lidhur mirë me suportin shtrihet mbi të gjithë sipërfaqen e panosë në mënyrë të njëtrajtshme kurse në vendet ku janë pikturuar apostujt shtrihen mbi kanavacë. Ari i shtrirë në mënyrë të njëtrajtshme në formë pllakash në të gjithë sipërfaqen me një trashësi 0.5 mm vende-



Fig. 1a

[1] Në këtë punë ndihmuan: Marita Beci, kimiste, Eduart Sopi, ndihmës restaurator, Vangjush Golloshi radiollog, Kosta Koçi kimist në laboratorin e fizikës bërthamore, Zamir Marika fotograf.

[2] Një pjesë e tyre si Dyert e bukura, ikonat, hyrja e Krishtit në tempull, krishtlindja, pagëzimi i Krishtit, Shpërfytyrimi, ngjallja e Shën Llazarit, zbritja në ferr dhe Joan Pagëzori u ekspozuan në Paris në vitin 1974.



Fig. 1b



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4

vende është i dëmtuar si rezultat i goditjeve mekanike, konstruksioneve natyrale si dhe nga veprimi i insekteve mbi drurin (Fig. 6, 7, 8 ,9). Aureolat e çdo apostulli janë realizuar në teknikën e incizimit me stampë mbi ar, duke krijuar motive të stilizuara (Fig. 10). Të tria panotë janë të pikturuara me tempera. Gjendja dhe lidhja e ngjyrës me gruntin është e mirë. Ngjyrat e përdorura janë kafeja dhe derivate e sajë (kryesisht në pjesët e mishta), e kuqja, jeshilja, vishnja, gritë e ngrohta etj. Verniku i shtrirë në të gjithë sipërfaqen e në mënyrë të njëtrajtshme paraqitet i nxirë dhe i dekompozuar. Mbi ngjyrë ka marra formë bulëzash ndërsa mbi arin paraqitet e plasaritur. (TAB. I, Fig. 11, 12, 13, 14). Në rastin e parë, verniku, duke gjetur një sipërfaqe



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9





Fig. 13

më të ashpër ka krijuar një lidhje më të mire se sa në rastin e dytë, ku gjen shtresën e lëmuar të arit. Kontraksionet e vernikut kanë bërë që në shumë raste ai të shkëpusë shtratin e ngjyrës. Kjo gjendje e ikonabartësit kërkonte një ndërhyrje të shpejtë restauruese.

Për të kryer ndërhyrjen restauruese fillimisht u bënë vrojtime dhe shqyrtime, të cilat treguan për ndërprerje vertikale në ikonën e parë e cila ishte shkëputur 1/3 e saja si dhe shkëputjen ose djegien e panosë me dy apostujt e fundit (Fig. 3). Vrojtimi me llambë ultraviolet tregoi për dy njolla të zeza prapa figurës së Krishtit dhe ritokime me ngjyrë të zezë



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 14



Fig. 15



Fig. 16

në këmbën e djathtë të Krishtit dhe tek kryqi i apostullit të parë.

Piktura në dy apostujt e fundit u vrojtua me rreze X (röntgen). Vrojtimi përcaktoi plotësisht kufirin e ripikturimit që ishte bërë me beze të ngjyrosur të ngjitur mbi pikturën origjinale (Fig. 15, 16). Para ndërhyrjeve restauruese veprës u krye ekzaminimi fiziko-kimik. Së fundi, të tria pjesët u fotografuan me dritë përballë, mbrapa si dhe anash.

Nga analiza rezultoi se grunti ishte prej sulfati kalciumi (Fig. 17), verniku me bazë rrëshire, ndërsa kanavaca prej fijesh lini të ashpër me thurje garniture (Fig. 18). Në mikroskopin binokular me zmadhime të mëdha u bë analiza e shtresëzimit



Fig. 17



Fig. 18

nga ku u pa renditja e shtresave (Fig. 19). Analiza spektrale e pigmenteve me fluoreshencë të rrezeve <<X>> (Fig. 20) të kryer në laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore dha këto rezultate:

	Elementët përbërës						
Pigmenti	Hg	Cu	Ca	Cr	Fe	Pb	Sr
E kuqja	+	-	-	-	-	+	-
Vishnja	+	+	-	-	+	-	-
Kafeja	-	-	+	-	-	+	-
Bluja	-	-	-	+	+	+	-
Jeshilja	-	+	-	-	-	+	-
Ari	-	-	+	-	+	+	+

Nga verifikimi i gjurmëve të insekteve: birimet, galeritë, kanalet dhe gërryerjet u konstatuan 3 lloj vrimash, të cilat duken qartë në sipërfaqen e arit dhe të pikturës. Vrima me diametër 1,3mm dhe 2mm janë të shkaktuara nga insektet xestobium rufovillosum, ndoshta dhe hilotropus bajalum dhe daktus (TAB. I, 6). Veç përcaktimit të përbërjes së lëndëve që formojnë objektin, në tërësi analiza ndihmoi për të përcaktuar radhën e ndërhyrjeve konservuese restauruese.

Fillimisht u hoqën aureolat metalike mbi kokat e Shën Mërisë dhe Joan Pagëzorit. Këto aureola nuk paraqisnin interes, pasi vendosja e tyre ishte bërë më



Fig. 19



Fig. 20

vonë, pa kriter, duke zënë dhe një pjesë të kokave, çka tregon qartë se piktura është konceptuar fillimisht pa aureola metalike. Më tej, konsolidimi i gruntit si dhe ai i shtresave mbi pano u bë me një pjesë xhelatinë dhe 5 pjesë ujë të shkrirë në një temperaturë 50°C, kryesisht me letra poroze të njomura me xhelatinë. Në vendet ku konstatoheshin fryrje ose xhepa u bënë injektime me anën e shiringave (Fig. 21). Pas kësaj u kryen plotësime me 1 pjesë krete dhe 2 xhelatinë duke krijuar një sipërfaqe të rrafshët e të lëmuar.

Për pastrimin e pikturës nga verniku i dekompozuar u bënë disa prova për të konkluduar në solucionin që përdorej. Solucioni më i përshtatshëm ishte ai i përbërë prej një pjese dimethyl formamid dhe 1 pjese amil açetat. Pastrimi u bë me tampon pambuku me kuadrate. Gjatë heqjes së vernikut u hoqën dhe ritokimet.

Në vendet ku paraqitej rënie e shtratit piktural (si p.sh. në siluetat e apostujve) u la një shtresë verniku origjinal më tepër se në vendet e tjera. Veç kësaj u lanë kuadrate të vogla të paprekura për të treguar gjendjen para pastrimit. Dezinfektimi kurativ i panove u krye duke injektuar ksilamon, i cili është i depërtueshëm në shtresën e drurit.

Së fundi, u bë plotësimi i pjesëve të drurit që mungonin. Duke u bazuar në ekzaminimin radiografik u hoqën copat e bezes (30 x 3cm dhe



Fig. 21



Fig. 22



Fig. 23

35x6cm) të vendosura për arsye se ikonat e fundit do të jenë të djegura, më vonë ato janë plotësuar me pjesë druri dhe për të plotësuar kuadratin janë ngjitur beze të pikturuara, të cilat plotësonin pjesën tjetër të pikturës së përzhitur nga djegia.

Këto ndërhyrje i dhanë ikonabartësit një pamje tjetër, duke i rikthyer pikturës mjaft nga vlerat historike e artistike origjinale (Fig. 22, 23 para dhe pas restaurimit, Fig. 24, 25 para dhe pas restaurimit). Pjesa qendrore "Lutja" është nga më të arriturat. Vendin kryesor në të e zë Krishti Pantokrator. Në



Fig. 24



Fig. 25



Fig. 26

krah të tij janë të pikturuara Shën Mëria dhe Joan Pagëzori. Të tri portretet janë realizuar me shije të thellë artistike. Format e qarta, vizatimi shumë elegant, ngjyrat e ngrohta si dhe psikologjia e tyre krijojnë portrete me vlerë (Fig. 26).

Tek figura e Shën Mërisë shohim mantelin vishnje të thellë ku palat janë të ndërtuara dhe zhvillohen në mënyrë organike, të cilat kalojnë nga supi dhe mbështjellin mëngën e dorës. Ato janë dhënë nëpërmjet linjave të mprehta ndërsa tek fustani i pikturuar me blu në jeshil, palat varen herë me linja të drejta e herë me linja të valëzuara, duke dhënë kështu një lëvizje të lehtë të trupit. Të njëjtat vlera i vërejmë dhe tek figura e Joan Pagëzorit me portret të shqetësuar me flokë të ngritura dhe shikim të gozhduar.

Të gjitha figurat në dy panotë anësore japin lëvizje plot hijeshi. Portretet në përgjithësi paraqesin tipa, të cilat piktori i ka realizuar me mjeshtëri, si nga vizatimi i saktë ashtu edhe nga

TAB I



1



4



2



5



3



6

ngjyrat. Psikologjia dhe gjendja e tyre shpirtërore transmetohen nëpërmjet shikimit të tyre të qartë dhe të përqendruar. Veshjet e apostujve pikturohen me ngjyra të bukura të fuqishme. Dy engjëjt që qëndrojnë mbrapa Krishtit janë portrete në miniaturë, të cilët ruajnë karakterin stilistik në vizatim e në formë, por nga trajtimi koloristik blu në smerald i shohim të shkëputura nga gama e përgjithshme e krejt tablosë që përmban kryesisht gamën e ngrohtë[3].

[3] Artikull i botuar në revistën Monumentet, 1, 1984, fq.69-79

Mustafa ARAPI

LA CONSERVATION ET LA RESTAURATION DE LA PARTIE CENTRALE DE L'ICONOSTASE DE L'EGLISE EVANGELIQUE DANS LA CITADELLE DE BERAT

La[1] plupart des icônes de cette iconostase dépassée aux fonds du Musée Médiéval de Korça sont considérées comme des œuvres d'Onuphre, notre illustre peintre du Moyen Age.

La partie supérieure de l'iconostase est constituée de trois panneaux: le centre avec la scène de la Supplication (98x77cm), l'aile droit avec quatre apôtres (144,5x53cm) et l'aile gauche avec cinq apôtres (182x54cm). Les panneaux sont en bois de noyer. Ils ne sont pas en bon état étant endommages en bonne partie par les rongeurs qui ont créé par ci par là des surfaces spongieuses et une fente verticale qui traverse tout le panneau de haut en bas. Les panneaux sont entourés d'un encadrement à motifs gravés en forme de nattes.

Le vernis étalé sur toute la surface et de façon uniforme est noirci et décomposé: il est en gemmes sur la couleur et lézardé sur l'or. Au premier cas le vernis trouvant une surface plus rêche a créé une liaison meilleure que celle du second cas ou il a trouvé la couche lisse de l'or. Les contractions du vernis sont suivies dans quelque cas par l'enlèvement de la couche couleurs. Cet état de l'iconostase exigeait une intervention immédiate de restauration.

Pour mener à bien l'intervention de restauration on a fait d'abord des observations et examens qui ont mis en vue une coupe verticale dans la première icône dont un tiers est détaché et la disparition du panneau des deux derniers apôtres. L'observation à la lampe ultraviolette a mis en vue deux taches noires derrières la figure du Christ et des retouches en noir au pied droit du Christ et à la croix du premier apôtre.

La peinture des deux derniers apôtres a été examinée rayons X (röntgen). L'examen a bien précisé la limite de la retouche effectuée à base colorée collée sur la peinture originale. Avant l'intervention de restauration d'œuvre a subi un examen physico-chimique. Enfin les trois parties ont été photographiées à lumière par devant, derrière et de côté.

Par l'analyse il a résulté que le grunt était du sulfate de calcium, le vermis à bas résineuse et la toile en fils de lin dur tressés en garniture (fig. 18, 19). L'analyse de la stratification des couches a été faite au microscope binoculaire de haute puissance. L'analyse spectrale des pigments à la fluorescence des rayons X effectuée dans le Laboratoire de l'Institute de Physique Nucléaire à donné ces résultats:

[1] Article publié dans la revue Monumentet, 1, 1984, pp.69-79

Les éléments constituants							
Les pigments	Hg	Cu	Ca	Cr	Fe	Pb	Sr
Rouge	+	-	-	-	-	+	-
Couleur grisâtre	+	+	-	-	+	-	-
Brun	-	-	+	-	-	+	-
Bleu	-	-	-	+	+	+	-
Vert	-	+	-	-	-	+	-
Or	-	-	+	-	+	+	+

En examinant les perforations les galeries, les canaux et les raclages causés par les insectes on a constate trois sortes de trous bien apparentes sur la surface de l'or et de la peinture. Les trous d'un diamètre de 1,3 mm et de 2 mm sont causés par les insectes Xestobium rufovillosum ou Hylotropus bajalus et dactus. A part des matières formant l'objet en entier, l'analyse a aidé à préciser l'ordre des interventions de conservation et de restauration.

Ne présentant pas d'intérêt on a enlevé d'abord les diadèmes métalliques de la tête de la Sainte Marie et celle de Saint Jean-Baptiste. Le placement de ces diadèmes était beaucoup plus tardif et sans critères. Elles couvraient partiellement les têtes ce qui prouve que les peintures étaient d'abord conçues sans diadèmes métalliques. Ensuite la consolidation du grunt et des autres couches sur le panneau a été faite au moyen du papier poreux mouillé dans de la gélatine mêlée avec de l'eau dans un rapport de 1 à 5, a la température 50° Celsius. Aux endroits où l'on constatait des enflures ou des poches on a fait des injections au moyen des syringes. Après cela on a complète la surface par une solution gélatine et de Crète dans un rapport de 2 à 1 pour la rendre lisse et plane.

On a fait quelques épreuves pour choisir la solution qui serait employée pour nettoyer la peinture du vernis décomposé. La solution plus convenable a été une solution équilibrée de diméthylène de formamide et d'acétate d'amyle. La nettoyage s'est poursuivi par carrés au moyen de chiffon de coton. Pendant le nettoyage du vernis on a enlevé aussi les retouches.

Aux endroits où la couche de peinture était déchue (comme par exemple chez les silhouettes des apôtres) on a laissé une couche de vernis original plus épaisse que pour les autres endroits. A part cela on a laisse intacts quelques petits carrés pour témoigner de l'état avant nettoyage. La désinfection curative des panneaux a été effectuée en injectant de la xilidine pénétrante dans la couche de bois.

Enfin on a complété les parties de bois qui manquaient. Les pans de toile (30x3 cm et 35x6 cm) sont enlevés. L'examen radiographique a résulté que ces pans de toiles sont placés parce que les dernières icones ont dû être brûlées et pour compléter l'autre partie de la peinture flambée les icones sont remplacées par des parties de bois et tour le panneau est complété par ces pans de toiles peints.

Ces interventions ont donné un autre aspect à l'iconostase tout en restituant à la peinture beaucoup de ses valeurs historiques et artistiques originales.

SULEJMAN DASHI



Inxhinieri restaurator Sulejman Dashi, ose Sula siç e thërrisnin kolegët e Institutit të Monumenteve të Kulturës, ka lindur në Tiranë, më 20 Shkurt 1944. Në vitin 1975 u diplomua Inxhinier Ndërtimi, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Në vitin 1999 kreu kualifikimin pas-universitar në Restaurimin dhe Konservimin e Antikiteteve pranë Institutit Tabbin për Studimet Metalurgjike në Kajro. Më 1970 filloi punën si skicograf-disenjator pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës, për të vazhduar si Inxhinier restaurator më 1975, deri në daljen e tij në pension më 2009. Gjatë kësaj periudhe ka mbajtur funksionet e Përgjegjësit të Sektorit të Monumenteve Historike më 1981, në vitin 2000 Përgjegjës i Sektorit të Monumenteve Bashkëkohore, Anëtar i Bordit të Kulturës Materiale në revistën "Perla", botim i Fondacionit Kulturor dhe Shkencor Saadi Shirazi (1996 - 2008), si dhe Anëtar i Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës (1999). Gjatë viteve 2000 – 2008, ai është angazhuar edhe në mësimdhënie pranë Liceut Artistik dhe Akademisë së Arteve në Tiranë.

Veprimtaria profesionale e S. Dashit dyzet vjeçare është e shumanshme, studimore e botuese dhe restauruese. Ai na ka lenë një bibliografi të pasur mbi arkitekturën e kultit islam dhe të kullave të sahatit në Shqipëri, të cilën e gjejmë të botuar si më poshtë:

1. Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë; *"Monumentet"* 1976/12
2. Një vështrim mbi kullat e sahatit; *"Mjeshtrit dhe Arkitektura Popullore"*, 1976
3. Rreth kumtesës: Kontributi i traditës vendase në arkitekturën e xhamisë tipike tiranase; *"Monumentet"* 1976/12 (bashkautor me Gjergj Frashërin)
4. Një xhami e vjetër në Berat; *"Monumentet"* 1978/15-16
5. Karakteristika arkitektonike të disa xhamive në vendin tonë; *"Monumente historike të vendit tonë"*, Tiranë, 1978 (bashkautor me Gjergj Frashërin)
6. Një xhami monumentale në qytetin e Beratit; *"Tradita në Arkitekturë dhe Art"*; Tiranë 1978
7. Ou est née le grand Sinan (Ku lindi Sinani i madh), *"Les lettres albanaises"*, Tirana, 1981
8. Arkitekt Kasëmi në dritën e një zbulimi, *"Drita"*, Tiranë, 1983
9. Zhvillimi i arkitekturës islamike të xhamive në Shqipëri; *"Monumentet"*; Tiranë; 1986

(bashkautor me Gjergj Frashërin)
10. Arkitekt Sinani, *"Drita"*, Tiranë; 1989
11. Xhamitë më të vjetra në Shqipëri; "*Perla" Nr. 2*, 1996, f. 69-77
12. Restaurimi arkitektonik në Shqipëri; "*Perla" Nr. 4*, 1998, f.79 - 95.
13. Teqetë e Shqipërisë, Aspekte të historisë dhe të arkitekturës; "*Perla" Nr. 1*, 1999, f.96-108
14. Elemente ndërfetare në arkitekturën e faltoreve shqiptare; "*Perla" Nr. 1*, 2000, f.97 - 101
15. Arti i ndërtimit të faltoreve islame në Shqipëri; "*Perla" Nr. 4*, 2002, f.105 - 117
16. Kalaja, bërthama historike e kryeqytetit; *Almanaku i Tiranës: e përmuajshme e Bashkisë së Tiranës* Nr. 1, 2003, f.26 - 27
17. Vështrim mbi faltoret islame të Gjirokastrës; "*Perla" Nr. 4*, 2005, f.143 - 157.
18. Mbishkrime persisht në disa faltore shqiptare; "*Perla"* Nr. 1, 2006, f.85 - 92.
19. Dukuri arkitekturore dhe artistike të teqeve bektashiane në Shqipëri; *"Perla"* Nr. 2, 2006, f.118 - 129.
20. Disa ndërtime monumentale në Shkodër; "*Perla" Nr. 2*, 2008, f.145 - 153.
21. Machiel Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 1385-1912, Përkth. Klodiana Smajlaj, Red. Shkenc Sulejman Dashi, Tiranë, AIITC, 2012

Në vëllime të ndryshme të *The Dictionary of Art*, ed. Jane Turner, (Macmillan Publishers, 1996) ka shkruar për artistët e shquar shqiptarë Zef Kolombi, Ndoc Montini, Pandi Mele, Llazar Nikolla, Murad Toptani, Spiro Xega, Kristina Koljaka (Hoshi), Shaban Hadëri.

Po kaq e rëndësishme është dhe veprimtaria e tij në fushën e restaurimit, duke qenë autor ose bashkëautor i shumë projekteve apo ndërhyrjeve restauruese në monumentet, si:

- Kisha e Shën Todrit, Berat, 1976;
- Restaurimi i Teqesë së Dollmës, 1977, e cila ishte edhe një nga propozimet e vitit 1994, për çmimin prestigjioz të arkitekturës Aga Khan në Gjenevë;
- Kisha e Shën Mëri Vllahernës, Berat (bashkautor me Ing. Genci Samimi**),** 1977;
- Xhamia e Plumbit, Berat (1978 - bashkautor me Ing. Genci Samimi dhe në 2006 me Ajet Nallbanin), 1978, 2003, 2006;
- Rrënojat e Xhamisë së Kuqe, Berat, 1982, 2004;
- Kisha e Shna Ndoit, Kepi i Rodonit, Durrës (bashkautor me Ing. Genci Samimi dhe Ark. Artan Shkrelin**),** 1999-2000;
- Punime konservimi në rrënojat e Manastirit të 40 Shenjtorëve, Sarandë, 2005 – 2006;
- Punime mirëmbajtje në Xhaminë Mbret, Xhaminë e Beqarëve, Berat, 2006;
- Punime mirëmbajtje në Kishën e Shën Kollit, Perhondi, Berat, 2006;
- Punime mirëmbajtje në Xhaminë e Pazarit, Krujë, 2006;
- Punime mirëmbajtje në Xhaminë e Nazireshës, Elbasan, 2006;
- Punime mirëmbajtje i Xhamisë së Et'hem Beut, 2006;
- Punime mirëmbajtje në Teqen Kadri të Sheh Dyrrit, Tiranë, 2006;
- Punime mirëmbajtje në Kullën e Sahatit, Tiranë, 2009.

Për punën e tij kërkimore dhe projektuese, Sulejman Dashi është vlerësuar me disa çmime në nivel kombëtar si:

- Në vitin 1981, është vlerësuar me Medaljen "Naim Frashëri" për punë cilësore në studimin dhe projektimin e monumenteve të kulturës;
- Në vitin 1982 është vlerësuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve me çmimin e 3-të për studimin "Ku lindi Sinani i madh";
- Në vitin 1989, është vlerësuar me Urdhrin "Naim Frashëri", për organizimin e aktiviteteve krijuese në fushën e mbrojtjes dhe të restaurimit të monumenteve historike dhe muzeumeve.

I apasionuar pas gjinisë arkitektonike të kullave të sahatit, edhe pas daljes në pension, Sulejman Dashin mund ta takoje në dhomën e vogël pas Sahatit të Tiranës, aty ku dikur ka qenë dyqani i sahatçiut, duke u përkujdesur në përgatitjen e një muzeu të sahat-kullave dhe duke rindërtuar me durim maketet e kullave të sahatit të të gjithë Shqipërisë.

Në 25 maj të vitit 2021, Sulejman Dashi, u nda nga jeta duke lënë boshllëk të thellë në familjen e tij, shokët e kolegët, si dhe në fushën e trashëgimisë kulturore për të cilën punoi me kaq pasion. Por, Sula do të mbetet në kujtesën e kolegëve të IMK-së të brezit të vjetër dhe atij të ri, ashtu i thjeshtë, i dashur, me humorin e tij të hollë dhe gjithmonë i rrethuar nga brezi i ri, që e thërrisnin me dashamirësi "Xhaxhi Sula", të cilin ai aq shumë e afronte, u fliste me pasion dhe e mbështeste.

SULEJMAN DASHI

Sulejman Dashi, civil engineer and restoration expert, was born in Tirana, on February 20, 1944. Graduated from the University of Tirana, Faculty of Civil Engineering.as Civil Engineer in 1975, he also pursued in 1999 a post-university qualification in Restoration and Conservation of Antiquities at the Tabbin Institute for Metallurgical Studies in Cairo, Egypt.

In 1970, he started to work in the Institute of Cultural Monuments initially as sketch-designer, to continue as civil engineer in 1975, until his retirement in 2009. During this period, he held also the position of Head of Department of Historic Monuments in 1981, and Head of the Department of Contemporary Monuments in 2000. He has been Member of the Board of Material Culture in the periodical "Perla", published by the Cultural and Scientific Foundation Saadi Shirazi (1996 - 2008), and Member of the Scientific Council of the Institute of Cultural Monuments (1999).

The 40-year professional activity of Sulejman Dashi is multifaceted, including research, restoration and publications. He is one of the reference authors in the bibliography on the architecture of the Islamic religious buildings and clock towers in Albania. He has undertaken an important activity in the field of restoration, being the author or co-author of many restoration works in several significant cultural monuments such as:

Church of Saint Theodore, Berat, 1976;
Tekke of Dollma, 1977;
Church of Saint Mary Vllaherna, Berat (co-author) 1977;
Lead Mosque, Berat (co-author) 1978, 2003,2006;
Remains of the Red Mosque, Berat 1982, 2004;
Church of Saint Anthony, Rodoni Cape, Durrës (co-author) 1999-2000, etc.

Being passionate also about beautiful arts, he has been engaged, during 2000-2008, in teaching in the Artistic High school and Academy of Arts in Tirana. In various volumes of *The Dictionary of A*rt, ed. Jane Turner, (Macmillan Publishers, 1996), he has contributed with descriptions of several renaissance Albanian artists.

On May 25, 2021, Sulejman Dashi passed away, leaving a deep void in his family, friends and colleagues, as well as in the field of cultural heritage for which he worked so passionately. He remains in the memory of his colleagues as passionate about cultural heritage, modest, and always embodied with a characteristic exquisite humor.







1. *Sulejman Dashi duke përgatitur maketet e kullave të sahatit*

2. *Kisha e Kepit të Rodonit para restaurimit*

3. *Kisha e Kepit të Rodonit mbas restaurimit*

Sulejman DASHI

KULLAT MESJETARE NË VENDIN TONË[1]

Organizimi esnafor si institucion i rendit feudal, që arriti formë të plotë në qytetet shqiptare gjatë shek.XVII-XVIII, krijoi kushte të favorshme për zhvillimin me ritme më të shpejta të jetës qytetare. Veprimtaria e organizatave esnafore ishte komplekse dhe e shumanshme. Esnafët kanë kryer edhe detyrat me karakter publik të bashkësisë qytetare, siç qenë ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, pazareve, faltoreve, urave, objekteve të tjera socialkulturore e inxhinierike, ndër to dhe kullat e sahatit.

Siç dihet, kjo gjini arkitektonike e lidhur ngushtë me shpikjen e mekanizmit të orës është shfaqur në Evropë në shek.XIV. Tregtarët shqiptarë, të cilët kishin kontakte të shpeshta me qytetet Evropiane, sollën që andej mekanizmat e orës dhe ndërtuesit vendës materializuan këtë sukses të mendimit njerëzor në vendin e tyre, duke krijuar kullat e sahatit si objekte të përdorimit kolektiv për kohëmatje. Ndërkohë historianët tanë kanë vërejtur se prania e kullave të sahatit në qytetet e banuara nga shqiptarët, në krahasim me qendrat e tjera të Perandorisë Osmane, është tipar dallues që nga shek. XVI.

E para kullë sahati mendohet të jetë ndërtuar në qytetin e Shkupit rreth viteve 1560-70. Në shek. XVII kulla sahati kishin edhe qytetet e tjera të dëgjuara Elbasani, Prizreni, Berati, Kruja, Shkodra, kurse në qytetet e Korçës, Prishtinës e Pejës esnafët



Fig 1

[1] Artikull i botuar në revistën Monumentet, 12, 1976, fq101-108





Fig 2, 2a

i ndërtuan kullat gjatë shek. XVIII. Kulla sahati ndërtojnë gjatë shek. XIX edhe qytetet më të reja zejtare si Kavaja, Tirana, Peqini dhe ndonjë qendër e vogël me karakter fshatar si Preza, Libohova (Fig. 1). Kanë pasur kulla sahati gjithashtu Durrësi, Gjirokastra, Kanina dhe Delvina.

Në ditët tona kanë arritur në gjendje të mirë disa prej tyre. Nevojat konservuese restauruese, që paraqesin këto përmendore kulture, bëjnë paraprakisht të nevojshme njohjen e arkitekturës dhe evolucionin e saj në gjithë aspektet përbërës, veprim i domosdoshëm për ndërhyrje shkencore të argumentuar restauruese.

Kullat i shohim të jenë dy tipesh: me dy dhe me tri kate. Për të dy tipat kati i parë është i lartë, i mbyllur me mure masiv guri dhe me një portë të vetme për hyrje. Zhvillohet në lartësi me planimetri katrore dhe ndriçohet nga të katër anët me dritare si frëngji. Duket që teknikisht është ndjekur përvoja e njohur e ndërtimit të kullave më të hershme, nga e cila është trashëguar edhe emri “kullë”.

Lloji i mekanizmit të përdorur në secilën kullë sahati diktoi dhe sasinë e kateve të mësipërme, kurse më vonë modifikimi i mekanizmit nga orë matës me tingull në mekanizëm me fushë ore ka sjellë ndryshime në pamjen origjinare të disa prej tyre. Si shembull kullat e sahatit në Tiranë (Fig. 2,2 a) dhe Kavajë (Fig. 3,4) janë konstruktuar duke u ruajtur nga projekti origjinar vetëm kati i parë. Ndryshimet që pësuan këto kulla sahati kanë sjellë për mendimin tonë humbje të vlerave arkitektonike tradicionale për këtë gjini ndërtimore, prandaj dhe punimet konservuese apo të mirëmbajtjes që janë kryer në to sipas fazës së fundit ndërtimore mendojmë se janë të diskutueshme në aspektin teorik të vlerësimit e restaurimit të monumenteve.

Zgjidhje interesante paraqiste kulla e sahatit në Prezë pas rikonstruksionit (Fig. 5). Ambienti i mekanizmit dhe kambanës (kati i dytë i kullës) qe mbyllur me mure; në to qenë çelur vendet për fushat e orës dhe nga tri dritare hark në çdo anë. Kjo pamje mendojmë se duhej vlerësuar për restaurim, ngaqë përfaqësonte evolucionin e plotë të kësaj kulle. Rikompozimi i saj (Fig. 6), duke mos e konsideruar fazën e fundit, ka sjellë që ky monument të humbasë cilësitë e një historiku të plotë si kullë fortifikuese kalaje, Kullë vrojtuese, Kullë sahati.

Përvoja e pasur ndërtimore vendëse e konceptoi kullën e sahatit si element të rëndësishëm urbanistik si për zgjedhjen e vendit të vendosjes, edhe në përkujdesjen e veçantë dekorative estetike.

Kullat u ndërtuan në sheshet e pazarit ose pranë tyre. Janë shfrytëzuar ose kuotat më të larta, që kulla të dominojë jo vetëm pazarin por krejt qytetin. Na tërheq vëmendjen ngritja e sahateve qytetare mbi rrënojat e kullave të vjetra të kalave, pranë ose në afërsi të pazarit, që siguronte bazamente të sigurta dhe ndihmonte në lartësimin e kullës, duke i shtuar asaj vlera monumentaliteti. Me interes është dhe fenomeni i adaptimit të kullave ekzistuese, kambanoreve, apo i ndërtimeve të llojeve të tjera, me funksionin e sahatit qytetar.

Për ilustrim kemi zgjedhur tre ekzemplarë:

Kulla e sahatit të Peqinit (Fig.7) shquhet për origjinalitet në formimin kompozicional, proporcione harmonike në tërësi, mjeshtëri të hollë e një teknikë të pjekur. Ajo u ndërtua rreth viteve



Fig 3



Fig 4



Fig 5



Fig 6

1840 së bashku me xhaminë, si pjesë përbërëse e të njëjtit projekt. Nga tradita gojore mësohet se për ndërtimin e saj qenë shfrytëzuar gurët nga një faltore më e vjetër dhe realizimi qe kryer nga po ata mjeshtër, që kishin ndërtuar më parë kullën e sahatit të Tiranës. Kjo kullë është e tipit trekatësh dhe arrin një lartësi prej 21 metrash. Kati i parë, si ambjent ku varen peshat, ka brenda akoma sot shkallët origjinale prej druri, të konstruktuara thjesht e me kritere racionale (çdo pesë këmbë shkallë një sheshpushim). Kati i dytë fillon me një dysheme, ku ndodhet i montuar mekanizmi i orës. Ky kat, ashtu si i pari, është i mbyllur. Formohet simetrikisht prej harqeve të verbra dyshe dhe mbulohet nga një kube mbi tromba anësore. Në këtë kube ka sot dy dalje, njera është e vonë, kurse tjetra, ajo origjinalja, të drejton për në ambjentin e tretë, në atë të kambanës. Ky ambjent i fundit, i formuar nga katër kolona të gurta njëcopëshe, me kapitele të gdhendura, harqe e kube, ka qenë i hapur. I vetmi ndryshim, që i është bërë katit, është mbyllja e hapësirës ndërmjet kolonave me mure, çelja e vendeve për fushat e orës dhe hapja e një kalimi të domosdoshëm për nevojat e rregullimit të akrepave orëshënues.

Vlerat unikale të këtij monumenti si dhe nevojat, që ai ka si rezultat i humbjes së qëndrueshmërisë që nga koha, kur u rrënua faltorja, e bën të domosdoshme ndërhyrjen tonë restauruese e vlerësuese.



Fig 7

Kulla e Elbasanit (Fig.8) daton në viitn 1899, por nga të dhënat dokumentare rezulton që Elbasani ka pasur një kullë sahati që në fillim të shek.XVII. Hani (1854) dhe Hekardi (1865), ndonëse japin një përshkrim të hollësishëm të sheshit pranë kalasë, nuk përmendin praninë e ndonjë kulle. Në vitin 1869 Tozeri ka vërejtur një kullë sahati, pa përmendur ndonjë veçori. Në studimin mbi Kalanë e Elbasanit të Gj. Karaiskajit, është shfaqur mendimi se në vendin, ku ndodhet kulla e sotme, ndodhej një e vjetër prej druri, ndërsa mendimi ynë është se në të njëjtin vend janë ndërtuar rradhazi tri kulla. E para në shek. XVII, e përmendur nga Çelebiu, u rrënua para vitit 1854. Kulla e dytë prej druri, e ngritur gjatë viteve 1865-1869, pas rrënimit u zëvendësua me kullën më të re, në pranverë të vitit 1899. Atë e ndërtoi vetë populli elbasanas) siç shkruhet në mbishkrimin mbi portën e hyrjes së kullës) dhe vlerësimi që i jep më 1931 Valishi, duke e cilësuar të vjetër turke, është i gabuar. Në mbishkrim thuhet gjithashtu se ky sahat tregon saktë nga të katër anët orët e minutat e kjo na bind se mjeshtrit ndërtues e konceptuan që në fillim me fusha. Kjo kërkesë funksionale nuk kërkon shtimin e ndonjë kati të veçantë, të posaçëm, por fushat u vendosën në murin e katit të dytë. Kulla është e tipit trekatësh. Zhvillohet me planimetri katrore (4,3 x 4,3 m). Deri në lartësinë 3 m është ndërtim prej guri, më sipër vazhdon prej tulle, duke ruajtur të gurta qoshet. Dy katet e tjera janë vazhdim i të parit dhe ndahen nga njeri-tjetri nga një soletë (sot e rindërtuar me beton-arme). Edhe kjo kullë



Fig 8



Fig 9

kurorëzohet nga një kube. Teknika e ndërtimit dhe e materialeve të përdorura (hekuri në brezat e murit dhe për tirande, druri për shkallë dhe dysheme, tulla e pjekur mirë në kupolë dhe mure, suvatimi dhe trajtimi koloristik) tregojnë për vazhdimësi të traditave vendasa dhe përvetësim të teknologjive më të reja. Në gjendjen e sotme nuk shohim nevojën për ndërhyrjen restauruese.

Për kullën e sahatit të Krujës (Fig. 9) studimi dhe restaurimi i së cilës është kryer nga punonjësit e Institutit të Monumenteve të Kulturës po kufizohemi vetëm me disa vlerësime.

Kjo kullë është më e vjetra nga ato që ruhen sot, e ndërtuar në shek XI-XII. Në gjendjen, që paraqitej si dhe në vendin ku ngrihej plotësonte më së miri kushtet e funksionit të ri si sahat qytetar për t'i shërbyer tregut dhe qytetit. Ka një lartësi nga tabani rreth 16 m, fillon piramidale dhe vazhdon prizmatike me bazë katrore. Kolona guri që mbajnë sipër çatinë e drujtë e mbyllin këtë kompozim. Sipas këtij ajo dhe është restauruar. Kulla e sahatit si një kategori arkitektonike, që reflekton kushtet ekonomiko-shoqërore të epokës, duke i materializuar këto si në konceptim, ashtu edhe në teknikën e materialit të përdorur, përbën për historinë e arkitekturës sonë mesjetare një kapitull të veçantë. Në këto përmendore kulture mbulojmë aftësitë krijuese të mjeshtërve tanë popullorë, të cilët kanë ditur të bashkojnë elemente të stileve të ndryshme, duke futur shumë gjëra vetiake të reja dhe në këtë drejtim ato janë të pasura me vlera të shumta njohëse.

Duke pranuar që secila prej tyre paraqet rast unik si vepër arti, si dëshmi kulture dhe si përmendore historike, do t'i pranojnë këto kritere bazë edhe për trajtimin e përkujdesjes konservuese restauruese, që zhvillohet nga Instituti ynë në praktikën e restaurimit.

Sulejman DASHI

LES TOURS DE L'HORLOGE MOYENAGEUSES DE NOTRE PAYS[1]

L'organisation corporative en tant qu'institution du système féodal, dont la formation s'est achevée dans les villes albanaises pendant les XVIIe-XVIIIe siècles, a créé des conditions favorables au développement rapide de la vie urbaine. Les corporations exerçaient aussi des fonctions municipales, entre autres celle de la construction de tours de l'horloge.

Les commerçants albanais, qui avaient des contacts fréquents avec les villes européennes, apportèrent à leur retour les mécanismes nécessaires dont les constructeurs du pays s'en servirent pour construire sur les places publiques des tours munies d'une horloge. Les historiens relèvent que la présence des tours de l'horloge dans les agglomérations urbaines habitées par des Albanais, par rapport aux autres provinces de l'empire ottoman, est un trait qui les caractérise dès le XVIIe siècle.

La première tour de l'horloge fut construite à Shkup pendant les années 1560-1570. D'autres villes renommées de l'époque disposaient aussi de tours semblâmes, comme Elbasan, Prizren, Berat, Krujë et Shkodër. En ce qui concerne les villes de Korçë, Prishtinë et Pejë, les corporations y construisirent des tours de l'horloge pendant le XVIIIe siècle. Plus tard, pendant le XIXe siècle, d'autres villes à économie artisanale comme Kavajë, Tirana et Peqin, voir même quelque village comme Prezë et Libohovë, sont pourvus de tours semblables. De même les villes de Durrës, de Gjirokastër, de Delvinë, ainsi que la Forteresse de Kaninë, disposaient d'une tour de l'horloge.

Ces tours sont de deux types: à deux et à trois étages. Pour les deux types, le premier étage est élevé et fermé par un mur de pierre massif, ne disposant, que d'une seule entrée. Il se développe en hauteur selon une planimétrie carrée et est illuminé par quatre fenêtres munies de meurtrières. Il aparaît clairement que la technique suivie pour leur construction est celle employée dans les tour plus anciennes du pays, d'où aussi leur nom de "kulla".

Le type d'horloge employé dans chacune de ces tours est en fonction du nombre des étages supérieurs de la tours même; plus tard l'emploi de cadrans, servant à indique l'heure par des aiquilles et munis d'une sonnerie, a entraîne des modifications quant à l'aspect original de certaines de ces tours. Exemple les tours de l'horloge de Tirana e de Kavajë qui ont été reconstruites, en ne conservant du projet initial que le premier étage. Evidemment ces modifications ne pouvaient ne pas toucher les valeurs archiectoniques traditionnelles de ces ouvrages.

Grâce à la grande expérience accumulée dans le secteur du bâtiment, les tours de l'horloge furent considérées à l'époque comme un important élément urbaniste, d'où le soin consacré au choix de la place où elles seront construites et en particulier à leur décoration esthétique.

---

[1] Article publié dans la revue Monumentet, 12, 1976, pp.101-108

Ces tours furent érigées sur la place du marché où à sa proximité, la préférence allant toutefois aux terrains élevés. A cette fin on s'est servi aussi souvent des anciennes tours de forteresse ou de quelque campanile.

La tour de l'horloge de Peqin se distingue par l'originalité de sa composition, par des proportions harmoniques dans l'ensemble, par une technique ayant atteint son développement et par l'habileté de ses constructeurs. Elle fut construite vers 1840 avec la mosquée adjacente, faisant partie intégrante du même projet de construction. Les gens du pays racontent que la réalisation de cet ouvrage est l'œuvre des mêmes maîtres bâtisseurs qui avaient mis auparavant en place la tour de l'horloge de Tirana. Elle est à trois étages et atteint une hauteur de 21 m. Le premier étage, où sont placés les poids, comporte encore son escalier de bois original. Le deuxième étage débute par une plancher, où sont placés les poids, comporte encore son escalier de bois original. Le deuxième étage débute par un plancher, où ont été assemblés les mécanismes de l'horloge. Cet étage se compose symétriquement par les arcs doubleaux, il est couvert par une petite coupole s'appuyant sur des colonnes latérales. En ce qui concerne la troisième pièce, celle du campanile, elle comporte quatre colonnes monolithes, à chapiteaux travaillés, des arcs et une petite coupole; elle est fermée. La seule modification apportée au deuxième étage consiste dans le murage de l'espace séparant les colonnes et dans l'ouverture pratiquée pour les cadrans et pour le passage conduisant à l'horloge en cas de nécessité de réparations. La tour d'Elbasan. Elle porte la date de l'année 1899, mais les sources documentaires indiquent qu'il y avait à Elbasan une tour de l'horloge dès le commencement du XVIIe siècle. A notre avis sur la même place ont été construites successivement trois tours: la première pendant le XVIIe siècle, comme l'indique Çelebi, et détruite avant 1854. Une deuxième tour de bois fut construite pendant les années 1865-1869; puis, après sa destruction, elle fut remplacée par une nouvelle tour au printemps de l'année 1899. Celle-ci a été mise en place par les habitants mêmes de la porte d'entrées à la tour. L'inscription indique, par ailleurs, que cette horloge désigne les heures et les minutes que l'ont peut voir les quatre côtés, ce qui nous induit à penser qu'elle fut conçue dès le commencement comme une horloge à cadrans. Cette exigence fonctionnelle n'a pas nécessité l'adjonction d'un nouvel étage, du fait que le cadran sont placés dans le mur du deuxième étage. Cette tour appartient au type à trois étages. Elle se développe selon une planimétrie carrée (4,3 x 4,3 m) jusqu'à une hauteur ed 3 m; ses murs sont en pierre, plus haut viennent des briques, mais les angles sont toujours de pierre. Cette tour aussi est couverte par une petite coupole. La technique de construction et les matériaux employés, ainsi que le traitement sur le plan du coloris, témoignent de la continuité de la tradition locale et de l'assimilation de technologies nouvelles.

La tour de l'horloge de Krujë est la plus ancienne parmi ce type de tour conservée de nos jours. Sa construction remonte aux XIe-XIIe siècle, peut-être même avant. A son commencement c'était un clocher et ce n'est d'une horloge. Grâce à son état et à la position qu'elle occupait, cette tour était en mesure de remplir au mieux sa nouvelle fonction. D'une hauteur de près de 16 m à partir du niveau du sol et de forme carrée à sa base, elle se dresse au commencement comme une pyramide pour prendre ensuite la forme d'un prisme. Cette composition se termine par des colonnes de pierre soutenant le toit de bois. Sa restauration a été achevée selon le même modèle.

La tour de l'horloge, en tant que catégorie architectonique reflétant au mieux les conditions économiques et sociales de l'époque, qui sont matérialisées soit dans la conception que dans la technique et les matérialisées soit dans la conception que dans la technique et les matériaux employés, représente dans l'histoire de notre architecture moyenâgeuse un chapitre à part.

ARTIKUJ, RECENSA

Elio HOBDARI
Jamarbër BUZO
Rudina PAPAVASILI

NDËRHYRJE TË PROPOZUARA RESTAURIMI NË NEKROPOLIN VERILINDOR TË AMANTIAS

Gërmimet arkeologjike të ndërmarra vitet e fundit në Amantia nga Instituti Arkeologjik janë përqendruar kryesisht në Nekropolin Verilindor[1]. Gërmimet u paraprinë nga një ekspeditë përnjohëse, e zhvilluar gjatë viti 2011, me fokus strukturat funerare dhe shtrirjen në përgjithësi të nekropolit antik. Gjurmimi i tyre ndihmoi për të reflektuar shtirjen e kufijve të nekropoleve në planin e përgjithshëm të Amantias. Gjithashtu, mundësoi identifikimin dhe dokumentimin e strukturave funerare sipas zonave të caktuara të shpërndarjes së tyre[2].

Nga viti 2013 dhe në vazhdim në zonën e Nekropolit Verilindor janë studiuar dhjetëra struktura funerare, ndër të cilat ato monumentale paraqesin interes të veçantë. Materialet më të hershme që vijnë nga ky nekropol, datojnë në çerekun të dytë të shek. III p.Kr. Gjatë shekujve III - II p.Kr., ndërtimet monumentale të varrimit bashkekzistojnë me cistet e thjeshta dhe ato të ndërtuara me tulla, të ndeshura në nivele të ndryshme. Shpesh shumë pranë tyre janë zbuluar edhe struktura varresh të përbëra nga tjegulla, sikurse ndeshen dhe urna të vendosura në gropa të cekëta, të cilat kryesisht datohen pas mesit të shek. II p.Kr. - shek. I m.Kr.

Shtrirja e Nekropolit Verilindor

Pjesa kodrinore në verilindje të qytetit antik të Amantias (Tab. I) është një zonë e futur vonë brenda perimetrit të zonës së mbrojtur, megjithëse në të ndodhen disa nga monumentet më të rëndësishëm funerarë[3]. Kjo zonë përbëhet nga një varg kodrash të ulëta me orientim pothuajse veri-jug, i cili fillon nga Qafa e Luadhit, që e ndan me kodrën e fortifikuar të Amantias, dhe shkon drejt majës së Dorbrit. Shpatet lindore të kodrave janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të përroit të Sevasterit dhe karakterizohen nga

[1] Ndërkohë gërmimi dhe dokumentimi arkeologjik ka vijuar dhe në disa pika të tjera të qytetit, sikurse janë gërmimi i varrit monumental nr.12, identifikimi në pjesën veriore të qytetit të një ambienti të gdhendur pjesërisht në shkëmb. Punë dokumentuese gjithashtu është bërë në tempullin dhe bazilikën paleokristiane, sikurse është realizuar edhe një rilevim topografim i pjesshëm që përveç nekropolit verilindor ka përfshirë zonën e stadiumit dhe ndërtesave përreth tij, etj. Hobdari, Buzo 2015 f. 293-319; Hobdari, Buzo 2016, f. 131-142; Hobdari, Buzo 2018, f. 305-316; Buzo in print.

[2] Buzo, Hobdari 2014, f. 19-74. Për shpërndarjen e varreve në zona të caktuara dhe në përgjithësi për shtrirjen e nekropolit të Amantias, shih gjithashtu: Anamali 1972, f. 96; Ceka 1975a, f. 35-36; Bereti 1988, f. 255-256; Bereti 1989, f. 271-272; Hobdari, Buzo 2015, f. 294.

[3] Më parë strukturat e ruajtura dhe të dukshme funerare të nekropolit verilindor nuk ishin përmendur në mënyrë të qartë.

prani e madhe e çakëllit të ardhur nga shpërbërja e konglomeratit të malit të Kudhësit[4]. Shpati tjetër, ai perëndimor, i kodrave është me depozitime argjilore – ranore, të cilat janë krijuar nga shpërbërja e shkëmbit me strukturë ranore-argjilore në bërthamë të kodrave[5]. Kodrat sot janë krejtësisht të zhveshura nga vegjetacioni i lartë, përveç ndonjë peme gorrice. Pjesa ekstreme veriore e kësaj zone të nekropolit paraqitet si pyll (Pylli i Qafës së Luadhit) në hartën topografike ushtarake, shkallë 1:25000, të përditësuar në vitin 1979 dhe të botuar në vitin 1982[6], ndërsa sot konstatohet vegjetacion i ulët.

Shpërndarja e strukturave funerare në nekropol

Varret monumentalë shpesh ndodhen të përqendruar në grupe, ashtu sikurse dhe në nekropolet e tjera të Amantias. Përqendrimi i varreve monumentalë nr. 2-7 është një nga më të spikaturit në të gjithë nekropolin veriperëndimor (Tab. III, 1). Një përqendrim tjetër varresh vërehet në periferinë jugore të nekropolit, pranë Qafës së Luadhit[7]. Ndërsa në ekstremin më verior të nekropolit (më saktë të zonës së mbrojtur) ndodhen varret monumentalë nr. 9 dhe 107. Pranë tyre (Tab. I dhe tab. II), në kreshtën e kodrës mbi varrin 107 ka një përqendrim varresh cist (përcaktuar me nr. 8 në hartën e nekropolit). Me siguri përgjatë kodrinave gjenden struktura të tjera monumentale ende të paidentifikuara.

Deri më tani në zonën e nekropolit ndeshen pothuajse të gjithë tipat e varreve me konstruksion të identifikuara në përgjithësi në nekropolin e Amantias. Varret monumentalë nr. 2 dhe 3 i përkasin tipit me dhomë varrimi të mbuluar me qemer cilindrik, i pari me paradhomë varrimi dhe i dyti me korridor. Varri 107 përbën shembullin më të madh dhe cilësor të tipit "Tumë e ndërtuar"[8], ndërsa varri nr. 5 është i një tipi tjetër.

Gjendja e ruajtjes dhe arkitektura e strukturave funerare

Përveç faktorëve natyrorë, një rol kryesor për gjendjen e ruajtjes së strukturave funerare ka luajtur edhe faktori njerëzor.

Sipas dëshmive të banorëve, një lagje e populluar e Sevasterit ndodhej ende në këto kodra në dhjetëvjeçarët e parë pas Luftës II Botërore. Më pas zona është shpopulluar dhe kthyer në tokë bujqësore. Sot nuk ka asnjë gjurmë nga veprimtaria ndërtimore e banorëve, por kjo duhet të jetë një nga arsyet e shkallës së dëmtimit të strukturave funerare dhe më pas kthimi në tokë bujqësore ka zhdukur edhe gjurmët e vetë ndërtimeve moderne[9]. Si edhe në pjesë të tjera të Amantias, edhe Nekropoli Verilindor ka pësuar transformime nga ushtria italiane gjatë dy luftërave botërore. Se sa e madhe ka qenë prania ushtarake në atë vend dhe sa ka influencuar në gjendjen e ruajtjes së monumenteve funerare në këtë zonë, sot është e pamundur të thuhet. Fakti që ushtria italiane, sipas dëshmive të banorëve, ka realizuar rindërtime të pjesshme të disa ambienteve pranë stadiumit duke ripërdorur blloqe antikë, tregon që mundësitë teknike kanë ekzistuar edhe

[4] Çakëlli i përzier me argjilën krijon një shtresë shumë të përshtatshme si taban për ndërtimin e varreve monumentalë.

[5] Materiali i cili është krijuar nga shpërbërja e shkëmbit ka krijuar një depozitim që, në pjesën e poshtme të shpateve, duhet të ketë arritur shtresa të konsiderueshme. Një ide për këto depozita krijohet nga ajo që vërehet në skarpatën e djathtë të rrugës automobilistike Ploçë – Amonicë, ku të paktën një strukturë funerare ka dalë në dritë pjesërisht.

[6] Kuadrati K-34-124-C-d (Sevasteri), Shtabi i Përgjithshëm, 1982.

[7] Vitet e fundit nga punime ndërtimore dhe ndërhyrje klandestine janë dëmtuar një numër ende i papërcaktuar strukturash funerare, ndër të cilat dhe varre cist me muraturë tullash, të ndërtuara brenda platformave prej blloqesh guri apo dhe jashtë tyre. Pak më në perëndim, në hyrjen e parkut, ndërhyrjet kanë dëmtuar varrime te kryera në urna prej guri dhe qeramike, disa prej të cilave datojnë ne shek. I m.Kr (Buzo, Hobdari 2018, f. 499 dhe shënimi 15).

[8] Hobdari, Buzo 2015, f. 301, tab. XIV-XV; Buzo, Hobdari 2018, f. 505-506.

[9] Tregimet e banorëve për përdorimin e varrit monumental nr. 2 si vaskë silazhi u dëshmuan edhe nga gërmimi i bërë aty në 2019.

për boshatisjen e dhomave të varrimit, ndoshta për t'i kthyer në qendra zjarri. Gjurmë të këtij aktiviteti dëshmoi materiali arkeologjik i dalë nga gërmimi i varrit nr. 3 (US. 003-02)[10] dhe sidomos një modifikim i vogël në një mur të varrit nr. 2 (USM 002-03).

Pjesa më e madhe e blloqeve të qemerit në varrin nr. 2 u gjetën të përgjysmuara me siguri për të bërë të mundur nxjerrjen e tyre nga dhoma e varrimit. Shumë prej tyre ruajnë gjurmë të qarta të goditjeve me baraminë për thyerjen e tyre, por kur është kryer kjo punë nuk mund ta themi.

Një pjesë e varreve cist janë hapur dhe boshatisur. Ndoshta një pjesë mund të jenë hapur gjatë gërmimeve arkeologjike të ndërmarra në sit[11], por disa mund të jenë hapur edhe më vonë nga gërmues klandestinë[12].

Aktualisht nga këto struktura monumentale varri nr. 2 është gërmuar plotësisht (Tab. IV, 2, 4)[13]. Varri nr. 3 është gërmuar pothuajse i gjithi (Tab. III, 2-3), përveç parahyrjes së tij, në të cilën muraturat anësore dhe pllaka mbyllëse paraqesin probleme stabiliteti[14]. Në të mundësia për ndërhyrje të tipit anastilozë ekziston, por mendojmë se impaktin përnjohës dhe monumental varri e jep më qartë në gjendjen aktuale. Pranë tij do duhet të bëhet vetëm sistemim i zonës dhe plotësim i gërmimit arkeologjik. Ndërsa varri nr. 107 (Tab. VIII, 1) është gërmuar plotësisht, deri në masën që nuk influencon stabilitetin e tij[15]. Praktikisht nuk është prekur shtresa e krijuar nga gërmuesit klandestinë në pjesën e poshtme të shpatit ku ndodhet varri dhe nuk janë evidentuar të gjithë blloqet e muraturës rrethore të zhvendosur nga struktura.

Struktura funerare nr. 5 është pastruar vetëm pjesërisht në vitin 2016 (Tab. III, 1), kryesisht me qëllim përfshirjen sa më të saktë në rilevimin topografik të realizuar në atë vit[16].

Strukturat e tjera funerare me numrat 4, 6 dhe 7 janë të dukshme, kush më pak e kush më shumë. Për ato vlejnë skedat përshkrimore të realizuara në vëzhgimin sipërfaqësor të vitit 2011[17]. Ndërsa varret nr. 2 dhe 107, në të cilët propozohet ndërhyrje anastiloze, po i përshkruajmë plotësisht, të dytin deri në shkallën aktuale të njohjes.

Arkitektura e Varrit monumental nr. 2

Varri monumental nr. 2 është i tipit me dhomë dhe paradhomë varrimi në një aks të mbuluara me qemer cilindrik gjatësor të përbashkët. Gërmimi i plotë i tij në vitin 2019 na shtyn të mendojmë se është shumë e mundur që ky monument funerar të jetë varri i përmendur dhe i dokumentuar nga K. Patsch gjatë vizitës së tij në Amantia[18].

Ndryshimi më i rëndësishëm që duhet të ketë pësuar struktura që nga fillimi i shek. XX është zhdukja e plotë e murit që ndodhej në rolin e një "xhakete" në pjesën e prapme të strukturës në tre krahë. Në lartësi duket se monumenti ka humbur pak: një radhë blloqesh në paradhomë dhe një nga blloqet e radhës së parë të qemerit në krahun jugor të paradhomës. Të

[10] Buzo, Hobdari 2017, f. 111-112.

[11] Anamali 1972, f. 95-98. Vendet ku janë kryer këto gërmime nuk janë përcaktuar qartë në një hartë: Buzo, Hobdari 2014, f. 20.

[12] Gërmimet klandestine janë një fenomen që vazhdon në zonë. Edhe vitet e fundit ato kanë "shoqëruar" gërmimet e rregullta arkeologjike të ekipit të Institutit të Arkeologjisë.

[13] Gërmim i kryer në vitin 2019: E. Hobdari, J. Buzo, Raport i punës arkeologjike në Amantia në vitin 2019, Arkivi i IA dhe Arkivi i Sekretarisë Teknike të KKTKM.

[14] Buzo, Hobdari 2017, f. 112; Hobdari, Buzo 2018, f. 307.

[15] Hobdari, Buzo 2018, f. 310-313.

[16] Hobdari, Buzo 2018, f. 307, 310, fig. 5.

[17] Hobdari, Buzo 2014, f. 25-26, tab. VI, 2-3, tab. VII, 2-3.

[18] Patsch 1904, f. 33, fig. 11, 12. Përmasat e dhëna nga ai përputheshin me ato të marra nga ne, por pasiguria lidhej me mospërputhjen e mikrotoponimisë së përdorur. Ndoshta mikrotoponimia mund të jetë transformuar që atëherë.

plotë ose të dëmtuar këto blloqe u gjetën në gërmim. Varri është i orientuar me boshtin juglindje – veriperëndim, me hyrje nga juglindja (Tab. 1). Ai ka formë drejtkëndore me një deformim të vogël të papërfillshëm. Përmasat e jashtme janë gjatësia: 510 cm në faqen jugperëndimore dhe 514 në atë verilindore, ndërsa gjerësia është rreth 375 cm. Ndryshimet e lehta në përmasa janë pasojë e çrregullsisë së faqeve të blloqeve. Ata janë punuar ashpër pasi varri është suvatuar si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda, ndërsa shtratet mbështetës dhe mbajtës janë rrafshuar mirë. Trashësia e mureve perimetrale anësore dhe atij ballor është 48 cm (me ndonjë bllok pak më të ngushtë), ndërsa ajo e murit fundor është 48-50 cm. Paradhoma e varrimit ka gjatësi (sipas aksit) 102-103 cm dhe gjerësi rreth 276 cm. Në të hyhet nga një portë aksiale me hapje 86 cm. Faqet anësore të saj kanë nga një kanal vertikal rrëshqitje të derës, të gjerë 13,5-14 cm dhe të thellë 9,3 cm. Kanali ekziston edhe në prag me të njëjtën gjerësi, por me thellësi 3,5 cm. Paradhoma dhe dhoma e varrimit ndahen nga një mur i trashë 40 cm (me ndonjë bllok që shkon edhe 38 cm) që lidhet me muret perimetrale. Hyrja aksiale ka hapje 88-90 cm dhe ka paturë të dalë 7-8 cm nga dhoma e varrimit. Dera prej guri ka pasur dy kanata, e dëshmuar qartë nga vrimat e boshteve të ruajtura në prag. Asnjë nga dy ambientet nuk ruan gjurmë të dyshemesë.

Si taban për mbështetjen e strukturës ka shërbyer një shtresë nivelimi çakëlli me përmbajtje edhe copash guri të thyer me përmasë deri rreth 10 cm. Themeli përbëhet nga blloqe me lartësi 30-35 cm të mbështetura mbi shtresën e nivelimit. Këto blloqe, aty ku janë të matshme, janë të gjera rreth 65 cm dhe dalin nga faqja e brendshme e murit në masë të ndryshme dhe shpesh me faqe të çrregullt. Në perimetrin e jashtëm ato janë evidentuar vetëm në faqen ballore dhe në këndet e saj. Këtu ato formojnë një xokol të punuar mirë që del 7-12 cm nga faqja e murit. Edhe blloqet e themelit të murit ndarës, që është më i ngushtë se muret e tjerë, kanë po të njëjtën gjerësi. Mbi themel (xokol) muratura ngrihet me tri radhë blloqesh me lartësi, duke filluar nga poshtë, 47-48 cm, 47 cm dhe 48 cm. Blloqet kanë gjatësi të ndryshme që shkojnë nga 62 cm deri në 164 cm. Muratura vertikale ruhet e plotë *in situ* përveç faqes ballore dhe asaj të majtë të paradhomës që ruhet në dy radhë. Mbi këto tri radhë fillon qemeri cilindrik që ka qenë i përbërë nga 9 radhë blloqesh. Vetëm blloqet e radhës së parë ruhen *in situ* në pjesën më të madhe të gjatësisë. Ato mungojnë aty ku mungon edhe radha e sipërme e blloqeve të muraturës. Faqja e brendshme e qemerit është vazhdim i faqes vertikale të murit ndërsa në faqet e jashtme anësore këto blloqe dalin jashtë faqes së murit rreth 7 cm, duke krijuar një kornizë të drejtë me lartësi 23-24 cm (Tab. VI, 2-3). Kështu shtrati mbështetës i tyre është i 55 cm. Mbi këtë kornizë të drejtë ekstradosi tërhiqet 8 cm dhe pastaj vazhdon me profil gjysmërrethor. Faqja e kontaktit të blloqeve të qemerit është 38 cm. Në këto faqe kontakti ruhen kllapat e krijuara për mbështetjen e baraminës për spostimin e tyre sipas aksit gjatësor.

Korniza e drejtë vazhdon edhe në pjesën e prapme të monumentit. Kjo është krijuar me anë të radhe të katërt blloqesh në murin fundor me lartësinë e kornizës. Mbi këtë radhë në murin fundor ruhet e plotë një radhë tjetër blloqesh me lartësi 53 cm. Blloqet ekstreme të radhës së parë të qemerit në murin fundor kanë pjesën e poshtme të kornizës që zgjatet deri në fasadën e prapme, ndërsa pjesa me ekstrados të harkuar mbaron në faqen e brendshme të murit fundor. Blloqet ekstreme të radhës së sipërme të ruajtur të murit fundor kanë një thellim (10 cm në krahun jugor dhe 4 cm në krahun verior), në të cilin mbështeteshin blloqet e radhës së dytë të qemerit. Pra muri fundor ishte i pavarur nga qemeri por, mesa duket, kishte një pjesë të vogël të trashësisë së tij të futur nën qemer.

Muri ndarës i dy ambienteve ruhet i plotë (në lartësinë e tre blloqeve) në krahun e djathtë të hyrjes

dhe në dy blloqe në të majtin. I fragmentuar dhe i dobët në strukturën e gurit u gjet blloku i radhës së tretë të krahut të majtë (002.B.34[19]) (Tab. VI, 2), që mund të integrohet, por për siguri më të madhe të strukturës preferohet të riprodhohet.

Edhe muri ndarës, njëlloj si muri fundor, mbi tre radhët e poshtme kishte një radhë të lartë rreth 24 cm, nga e cila nuk ruhet asnjë bllok. Mbi to ndodheshin dy blloqe të gjetur në gërmim (002.B.01 dhe 002.B.12), të cilët nga njëri krah kanë paturën e portës dhe në tjetrin faqen e harkuar me të cilën puthiteshin me intradosin e qemerit. Mbi këto dy blloqe mbështetej arkitrau, i ruajtur në tre fragmente (002.B.09 a dhe b + 002.B.15), që në pjesën e sipërme të tij ka gjithashtu formë të harkuar, pasi përputhet me qemerin. Të paktën disa nga blloqet e pjesës së poshtme të këtij muri kanë ardhur në kantier me gjerësi më të madhe se trashësia e murit (rreth 44 cm) dhe janë ngushtuar në vend (Tab. V, 3.1-3.2). Faqet e krijuara nga ky punim janë më të parregullta se faqet e tjera.

Pjesa e vetme e paqartë e monumentit është fasada ballore, nga e cila nuk ruhet as arkitrau dhe ndoshta as blloqe të tjerë. Kjo duhet të jetë pjesa që është shkatërruar e para, ndoshta që në antikitet.

Varri i përket një faze të vetme ndërtimi. Një "riparim" i rrënojës konsistonte në vendosjen e një gjysmë blloku qemeri (002.B.06) dhe fiksimin e tij me llaç të varfër (USM 002-03[20]) në muraturën ndarëse të dy ambienteve (Tab. VI, 2), ndoshta nga ushtarët italianë në LIB.

Nga gërmimi dolën 35 blloqe të muraturës dhe qemerit të monumentit (Tab. IV, 1, 3-4), pjesa më e madhe të nxjerrë jashtë monumentit, me qëllim boshatisjen sa më shumë të tij. Paradhoma kishte më shumë blloqe në shtresat e saj arkeologjike. Nga tërësia e blloqeve të gjetur 23 janë blloqe të qemerit, nga të cilët 9 të plotë (njëri me shumë dëmtime) dhe të tjerët të përgjysmuar qëllimisht. Këtyre u shtohen edhe dy të tjerë të radhës së parë: 002.B.10 që i përket krahut jugor të qemerit dhe 002.B.19, blloku më ekstrem i radhës së parë të krahut verior. Ky u vendos në vendin e tij gjatë sezonit të gërmimit (Tab. V, 2) dhe mund të vazhdojë të qëndrojë aty, megjithëse i mungon pjesa e kornizës së drejtë që del në fasadë. Provizorisht u vendos edhe blloku 002.B.01 me qëllim që të verifikohej në vend se si qëndronte ky në raport me intradosin e qemerit (Tab. IV, 2). Dy blloqe të tjerë në krahun jugor nuk u vendosën në 2019.

Arkitektura e Varrit monumental 107

Varri 107 është evidentuar në vitin 2013 nga një gërmim klandestin që shkatërroi edhe një pjesë të strukturave. Gërmimet arkeologjike u kryen në vitet 2014-2015 duke bërë të mundur zbulimin e plotë të strukturave *in situ* dhe të një pjesë të terrenit përreth tij (Tab. VIII, 1-2). U evidentuan edhe një pjesë e blloqeve të muraturës së tij. Ai është i ndërtuar në shpatin lindor të kodrës, e cila duhet të jetë rrafshuar nga ndërtuesit në atë pjesë për krijimin e tabanit të monumentit. Dëmtimet e hershme, natyrore ose njerëzore, dhe shkatërrimi i vitit 2013 kanë dëmtuar pjesën lindore, pra atë në pjesën më të ulët të terrenit. Struktura rrethore ka një diametër të matur prej 912 cm dhe ruhet në rreth ¾ e saj. Ajo ka pësuar edhe një deformim të lehtë sipas drejtimit lindje-perëndim. Varri i tipit "Tumë e ndërtuar" përmban në brendësi 5 varre cist të ndërtuara me tulla e që i përkasin tri fazave të ndryshme. Nuk ndalemi në detaje në përshkrimin e tyre, i cili është publikuar[21], pasi projekti ynë propozon mbushjen e tyre (*backfill*)

[19] Blloqet e lëvizur në monumentet e Amantias i kemi numëruar me sistemin "Numri i monumentit (me tri shifra).B.numri i bllokut (me dy shifra)". Në këtë rast 002.B.xx janë blloqet e varrit nr. 2.

[20] Njësitë stratigrafike (përfshirë edhe ato të muraturës) në Amantia janë të organizuara me numrin e monumentit ose sektorit (në këtë rast varri monumental nr. 2 = 002) – numri i njësisë (me dy shifra)

[21] Përshkrimi i tyre është bërë në: Hobdari, Buzo 2015, f. 307.

dhe mbulimin për të rikrijuar tumën origjinale, nëpërmjet anastilozës së muraturës rrethore.

Muratura rrethore është e ndërtuar me katër radhë blloqesh prej guri konglomerat lokal. Nga këto ajo më e poshtmja, me lartësi 56 cm, shërbente edhe si themel dhe duhet të dukej pak centimetra. Radha e dytë nga poshtë krijon një shkallëzim duke u futur rreth 15 cm më brenda. Blloqet e kësaj radhe kanë faqen pak konvekse (*bossage*) me buzë të rrafshëta (gjerësi 8-10 cm) lart dhe në anët. Mbi to ka një radhë ortostatesh me lartësi 89 cm, që në buzët vertikale kanë rrafshim prej rreth 5 cm për t'u bashkuar saktë me njëri-tjetrin, dhe e gjithë muratura kornizohet lart me radhën e fundit me lartësi 27-28 cm, të dalë 6-7 cm jashtë faqes së ortostateve. Këto blloqe kanë në shumicën e rasteve një fryrje të çrregullt në pjesën e sipërme rreth 10 cm brenda faqes. Mbi këtë radhë, në krahun verior ruhet blloku që shërbente si bazë për vendosjen ndoshta të një stele. Ky ka në qendër të shtratit mbajtës një thellim në formë paralelepipedi dhe dy thellime rrethore në anët, me siguri për inkastrimin e një guri mbivarror. Kuota më e sipërme e muraturës së cisteve përputhet me kuotën e shtratit mbajtës të radhës së blloqeve të themelit.

Një sasi prej 12 blloqesh, të shkëputur nga struktura, janë zbuluar nga gërmimi. Ndër ta ka blloqe nga secila radhë e strukturës. Gërmimi në pjesën lindore nuk ka mbaruar ende pasi procesi duhet të kryhet në mënyrë të integruar me ndërhyrjen restauruese dhe nuk përjashtohet që në shtresë të ketë edhe blloqe të tjerë ende të pazbuluar. Me një vlerësim të përafërt blloqet që mungojnë në strukturën *in situ* janë rreth 35, pra të paktën 1/3 e tyre ruhen dhe janë në gjendje për t'u rivendosur.

Sistemimi i terrenit dhe gërmimi arkeologjik i integruar

Të dy sektorët e marrë në shqyrtim në Nekropolin Verilindor, ai i varreve nr. 2-7 dhe ai i varrit 107 paraqesin nevojën e vazhdimit të punës arkeologjike. Puna arkeologjike ka vazhduar (gërmimi i varrit nr. 2) dhe shpresohet të përparojë gradualisht, por në stadin e tanishëm ndjehet nevoja që kjo të fillojë të bëhet në kombinim me ndërhyrje konservuese dhe sidomos sistemimi të terrenit. Prioriteti i punës arkeologjike është gërmimi i shtresave arkeologjike dhe zbulimi i plotë i strukturave që ato fshehin. Por ky proces në vetvete nuk është i mjaftueshëm për sistemimin e terrenit, sidomos kur bëhet fjalë për një hapësirë relativisht të gjerë ku synimet e punës arkeologjike bashkërendohen me mundësitë financiare dhe konservuese. Sistemimi i terrenit përfshin gërmime depozitash me potencial të ndryshëm arkeologjik dhe krijim skarpatash me garanci të plotë stabiliteti [p.sh. ndërmjet varrit nr 3 dhe nr. 4 (Tab. VII)][22]. Këto janë procese që jo gjithmonë mund të bëhen në kuadër të një ndërhyrjeje thjesht arkeologjike. Prandaj dhe verifikimet e mëtejshme arkeologjike përreth varrit monumental nr.2 janë menduar të zhvillohen në kuadër të punimeve konservuese në sit[23].

Ndërsa në varrin 107 ndërhyrja e kombinuar arkeologjike dhe restauruese do të jetë edhe më komplekse pasi monumenti në gjendjen e tanishme është në rrezik, si për shkak të formës së pjesës së ruajtur të monumentit, ashtu dhe gjendjes së tabanit në të cilin ndodhet (Tab. X, 1-2).

Ndërhyrja klandestine e vitit 2013, nga njëra anë ka dëmtuar strukturën dhe tabanin e saj dhe nga ana tjetër ka krijuar një depozitë artificiale në pjesën e poshtme të skarpatës. Kjo depozitë ende sot nuk është gërmuar plotësisht dhe qëllimi ka qenë për të mos avancuar shkallën e rrezikut të stabilitetit të strukturave. Gërmimi i saj do të duhet të bëhet absolutisht e kombinuar me rimbushjen e menjëhershme të skarpatës dhe krijimin e sheshit të parashikuar në projekt përpara monumentit.

[22] Në çdo rast edhe kur depozitimet vlerësohen me potencial jo të madh arkeologjik, dokumentimi i tyre është i domosdohëm.

[23] Me qëllimin për mos shkaktuar probleme stabiliteti.

Sistemimi i zonës së varrit 107 do të bëjë të mundur ndërhyrjen edhe në shpatin e kodrës mbi varr, deri në kreshtën e kodrës aty ku një numër varresh të thjeshtë cist janë të gërmuar. Kjo ndërhyrje do të ketë qëllim të dyfishtë. Nga njëra anë do të zbulojë varrimet duke dhënë një panoramë të plotë të kësaj pjese të nekropolit dhe nga ana tjetër do të kthejë gradualisht relievin në konfiguracionin origjinal të terrenit antik (Tab. X). Varret që do të zbulohen do të bëjnë të mundur të kuptohet forma e relievit dhe do të shërbejnë si referenca për kuotat në të cilat duhet të ndalet gërmimi.

Ndërhyrjet e planifikuara për anastilozën

Ndërhyrjet e planifikuara në Varrin nr. 2

Për të bërë të mundur anastilozën do të duhet të spostohet blloku 002.B.06 (USM 002-03) i ripërdorur në strukturë në shek. XX (Tab. VI, 2).

Përveç arkitraut që gjykojmë që do të mund të riparohet (ngjitet dhe qepet me elementë metalikë *inox*) blloqet e tjerë që mund të përfshihen në anastilozë ruhen të plotë dhe kanë vetëm dëmtime të vogla sipërfaqësore, ashtu sikurse edhe blloqe të muraturës së ruajtur in *situ*.

Muri vertikal jugor i paradhomës do të plotësohet me bllokun 002.B.14 (104 cm x 47,5 cm x 47 cm). Faqja e rrafshët është nga brenda. Vrima e fiksimit të baraminës tregon faqen e sipërme. Mbi të do të vendoset blloku i qemerit 002.B.10 (Tab. VI, 1)

Në murin ndarës të dy ambienteve do të prodhohen dy blloqet me lartësi 24 cm (002.B.36 dhe 002.B.37) që pozicionohen nën blloqet 002.B.01 dhe 002.B.12 (Tab. VI, 2). Blloku 002.B.34 nuk do të mund të përdoret dhe duhet prodhuar i ri. Mbi blloqet 002.B.01 dhe 002.B.12 do të vendoset arkitrau 002.B.09 + 15. Blloku i qemerit 002.B.19 është vendosur në pozicion.

Një bllok paralelepiped i ruajtur, 002.B.11 (102 cm x 54 cm x 49 cm) mund të vendoset në murin fundor, mbi bllokun paralelepiped më djathtas, që paraqet degradim për arsye të vegjetacionit që mbin në kavitetet e tij. Kjo mund ta mbrojë në të ardhmen nga avancimi i dëmtimit.

Duke arritur deri në radhën e parë të qemerit në pothuajse të gjithë gjatësinë dhe duke plotësuar murin ndarës të dy ambienteve, struktura do të jetë më e lexueshme, sikurse dhe më e mbrojtjur nga dëmtimet që pëson guri nga fenomenet natyrore. Edhe blloqet e lëvizur që do të përfshihen në anastilozë do të ishin më të mbrojtur duke u rivendosur në monument.

Një ngritje e plotë e qemerit për momentin është e diskutueshme.

Ndërhyrjet e planifikuara në Varri 107

Këtu ndërhyrja do të jetë e integruar me gërmimin arkeologjik dhe sistemimin dhe e varur nga këto procese. Projekti parashikon rimodelimin e relievit duke ardhur sa më pranë atij që ka ekzistuar në antikitet. Në perspektivë synohet anastiloza e plotë e muraturës rrethore me blloqe guri (Tab. IX, 2), por kjo varet nga krijimi i kushteve për këtë qëllim, duke filluar që nga rikrijimi i tabanit solid për të mbështetur muraturën.

Blloqet e dalë nga gërmimi do të sistemohen në sheshin e krijuar në jug të monumentit (Tab. IX, 1) dhe më pas dokumentohen. Do të gërmohet depozita në pjesën e poshtme të shpatit të kodrës. Në kohën më të shkurtër të mundshme do të bëhet rimbushja e kësaj pjesë deri në tabanin e strukturës në pjesën ku kjo mungon, duke krijuar një shesh manovrimi me mjet që në të ardhmen do të vlejë për sistemimin e vizitueshmërisë. Aktualisht ekstremet e pjesës së ruajtur të radhës së themelit janë zbuluar plotësisht dhe dy blloqet ekstremë janë pjesërisht pa mbështetje. Mbushja do të ngjeshet aq sa të jetë e mundur. Do të krijohet një taban me kuotë 10 cm më të lartë se ajo e pjesës *in situ* të monumentit. Pas uljes definitive do të mund të ulet ose ngrihet pak centimetra për të ardhur në kuotën e duhur për anastilozën finale. Blloqet e identifikuar të radhës së themelit do të rivendosen sipas perimetrit të strukturës. Edhe në pjesën që do të mbetet e lirë duhet të vendoset

blloqe të tjerë provizorisht për të garantuar uljen dhe kompaktësimin e plotë të tabanit. Blloqet duhet të ngarkohen me blloqet e tjerë të ruajtur, në mënyrë që pesha të jetë sa më afër asaj që do të ketë në përfundim të anastilozës.

Kjo është një ndërhyrje që duhet konsideruar emergjente në monument, pasi konfigurimi i tanishëm i terrenit është i dëmshëm për stabilitetin e strukturës. Stabilizimi i tarracës së re që do të krijohet (Tab. X, 2) do të bëjë të mundur realizimin e anastilozës definitive.

Strukturat e brendshme (varre ciste me muraturë tulle) janë gjithashtu të rrezikuara, por kjo ndodh prej dobësisë së materialit të ndërtimit (dobësi e tullave) dhe materialit lidhës (llaçit të varfër). Për mbrojtjen e muraturave me tulla të varreve cist së fundmi është shtuar një shtresë argjile[24]. Kjo ndërhyrje mund të jetë konsideruar si një zgjidhje e problemit, por gjithsesi ajo nuk mund të jetë afatgjate[25]. Për më tepër kjo ndërhyrje nuk shkon në linjë me projektin e aprovuar për ndërhyrjen në varrin 107. Degradimi aty vjen më tepër nga lagështia e tabanit, në të cilin ato muratura tullash mbështeten, siç ka ndodhur që në momentin e ndërtimit të monumentit. Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë dobësia e mureve në të cilët ende mbështeten pllakat mbuluese, nga të cilat dy janë në rrezik kolapsi[26]. E vetmja mënyrë për të mbrojtur përfundimisht këto muratura, tashmë shumë të dëmtuara, konsiderohet mbulimi i tyre i plotë[27]. Si fillim do të hiqen pllakat mbuluese të cisteve që ruhen *in situ* dhe më pas brendësia e tyre do të mbushet me materialin e kodrës. Në përfundim pllakat mbuluese do të rivendosen në pozicionet e tyre. Nuk konsiderojmë të dobishme ruajtjen jashtë strukturës rrethore të pllakave që kanë mbuluar cistet e shkatërruara plotësisht nga ndërhyrjet klandestine. Kështu që pas mbushjes së gjithë kompleksit të cisteve deri në pjesën e sipërme të mureve të tyre, do të rivendosen edhe ato brenda strukturës. Mendojmë se në këtë mënyrë muraturat prej tulle nuk do të rrezikojnë degradimin e mëtejshëm dhe nuk do përbëjnë më problem për rrënimin nga brenda të strukturës rrethore prej blloqesh.

Materiali i ndërtimit i propozuar për integrimin e muraturave

Në rastin konkret të ndërhyrjeve në varret monumentalë në Nekropolin Verilindor sasia e blloqeve të rinj që do të duhet të prodhohen për të bërë të mundur ringritjen (anastilozën) do të jetë shumë e kufizuar, por strukturat e tjera ku duhet të ndërhyhet në të ardhmen, duke filluar nga porcionet e mureve fortifikues dhe tarracues, do të kërkojnë sasi më të madhe blloqesh guri të rinj. Diskutimi duhet ngritur në parim duke pasur parasysh perspektivën e ndërhyrjeve restauruese në Amantia.

Në përgjithësi tre janë llojet e gurëve të përdorur për ndërtim në Amantia. Dy prej tyre, respektivisht ranori dhe konglomerati i çimentuar, përbëjnë llojet kryesore të shkëmbinjve në territorin e Amantias. Ndërsa një lloj tjetër është i ardhur (jo lokal) dhe përfaqësohet nga një gur i bardhë gëlqeror kompakt me pore shumë të vogla.

Deri më tani ranori është evidentuar në instalimin e varreve ciste të thjeshta[28], të përbëra kryesisht prej pllakash të nxjerra pothuajse të gatshme nga formacione shtresore. Të tilla formacione shfrytëzohen ende sot shumë pranë Amantias, por

[24] Në vitin 2019 një ndërhyrje me qëllim mbrojtjen e strukturave të brendshme të varrit 107 u realizua nga DRKK e Vlorës.

[25] Një problem tjetër dytësor i kësaj ndërhyrjeje është depozitimi i një sasie argjile në afërsi të monumentit, në pjesën ku do të vazhdojë gërmimi arkeologjik. Kjo ka shtuar një depozitim tjetër i cili është i një natyre të ndryshme nga materiali që përmbajnë shtresat e zonës, si ato natyrale, ashtu edhe ato antropike.

[26] Në mungesë të një raporti të botuar rreth punimeve të vitin 2019 nuk dimë detaje të tjera të ndërhyrjes.

[27] Arsyeja pse kjo duhet bërë është se strukturat e varreve janë dobësuar shumë, si për pasojë të ndërhyrjes klandestine, ashtu edhe nga degradimi i tullave.

[28] Buzo 2018, f. 196-197, tab. III, 1-4.

ky lloj guri është jashtë fokusit të propozimeve tona prandaj dhe nuk do ndalemi më gjatë rreth tij në ketë punim.

Ndërsa për ndërtimin e muraturave masive në muret fortifikuese, banesa, ndërtesa publike dhe varreve me konstruksion në Amantia është përdorur guri konglomerat. Pjesa më e madhe e gurit duhet të jetë nxjerrë gjatë punimeve për sistemimin e kodrës duke krijuar tarraca të sheshta. Me siguri ka pasur edhe gurore të tjera nga është nxjerrë ky lloj materiali, ende sot të paidentifikuara. Në ditët e sotme konglomerati lokal nuk nxirret më në asnjë gurore dhe nuk mund të shpresohet të sigurohet në ndonjë mënyrë apo në tjetrën. Gjithashtu, prirja e tij për t'u shpërbërë e bën të papërshtatshëm për përdorim. Kjo cilësi e tij sot vihet re në pothuajse çdo monument të ekspozuar ndaj faktorëve atmosferikë. Në ndonjë rast shkalla e degradimit të tij është aq e lartë sa vështirë të kuptohet nëse bëhet fjalë për bllok çmërsi apo konglomerati[29].

Guri tjetër, ai gëlqeror kompakt, ka gjetur përdorim kryesisht në arkitekturën e ordrit[30] (kolona, frize, etj) të përdorur në ndërtesa me karakter publik dhe religjioz[31] dhe në ndonjë rast në relieve me karakter funerar[32]. Në Amantia ky material ndërtimor me shumë mundësi ka ardhur nga lugina e mesme e Shushicës (Lumit të Vlorës). Vitet e fundit në bregun e djathtë të lumit Shushicë, në territorin e vendbanimit Brataj është identifikuar një karrierë antike, në të cilën janë prodhuar elementë arkitektonikë[33]. Sot guri i bardhë kompakt del si material sekondar nga gurorja aktive që ndodhet në Lepenicë[34]. Ende nuk kemi informacion për disponibilitetin e këtij lloji guri për përdorim të gjerë, por blloqe me përmasa të dobishme për qëllimet tona, aktualisht aty përftohen. Prandaj dhe mendojmë se alternativa më e mirë për materialin që duhet integruar në muratura me blloqe është pikërisht guri i bardhë kompakt, i cili nxirret në Lepenicë.

Përveç disponibilitetit, që për nevojat tona imediate ekziston, ka edhe arsye të tjera për të zgjedhur këtë material. Në këtë mënyrë evitojmë të fusim një lloj të ri guri në sit që do të vinte nga një distancë më e largët dhe do të mund të krijonte konfuzion. Kur konglomerati zbulohet dhe del në sipërfaqe (gjatë gërmimit arkeologjik) ka ngjyrë të përafërt me gurin e Lepenicës. Nga ana tjetër, ndryshimet vizuale midis llojeve pasqyrojnë diferencimin strukturor të tyre dhe në këtë mënyrë integrimi rezulton i dobishëm pasi nuk mund të keqinterpretohen (ngatërrohen)[35].

Fakti që është përdorur vetëm për elementë të dekoruar arkitektonikë dhe jo për blloqe murature masive nuk do të krijojë konfuzion. Kjo edhe sepse muraturat ku do të ndërhyhet me anastilozë nuk ruajnë apo përmbajnë dekorim arkitekturor.

Propozimi ynë ka edhe një arsye që lidhet me konservimin afatgjatë të muraturave në Amantia. Për qëllimin nuk do të mjaftonte vetëm mirëmbajtja rutinë e muraturave të gurit në Amantia, që duhet të përfshijë mbrojtjen nga uji të blloqeve, pastrimin nga depozitimet e dherave apo parandalimin e vegjetacionit në xhepat e blloqeve etj[36], që vështirë

---

[29] Buzo, Hobdari 2014, f. 26.

[30] I njëjti gur i bardhë kompakt me prejardhje të ndryshme është preferuar edhe në Bylis për skulpturën monumentale gjatë antikitetit.

[31] Hobdari, Buzo 2015, f. 293-294, tab. II, 2-5, f. 294, tab. III, 1-2: f. 297, tab. X, 1-2. Elementë antikë prej këtij guri janë ripërdorur edhe për prodhimin e elementëve të instalimeve në bazilikën paleokristiane aty pranë: Po aty, f. 297, tab. VIII, 1-2.

[32] Buzo, Hobdari 2014, f. 28-29, tab. IX, 2-4.

[33] Xhyheri *et al*. 2016, f. 292.

[34] Sot vendbanimet Brataj dhe Lepenicë janë pjesë përbërëse të Komunës Brataj, ndërsa gjatë antikitetit territoret e tyre i përkasin Bashkësisë Amante.

[35] Karta e Restaurimit e Venecias, 1964, neni 9.

[36] Mertens 1995, f. 121.

se mund të kryhet në mënyrë sistematike. Aty ku do të jetë e mundur që mbi blloqet origjinalë të vendosen blloqe prej guri të bardhë të Lepenicës do të garantohej një mbrojtje më e mirë e muraturave. Përdorimi i gëlqerorit të bardhë në varret monumentalë në Nekropolin Verilindor do të jetë edhe një test për këtë lloj guri si në aspektin viziv ashtu edhe në qëndrueshmëri, në periudhë afatgjatë.
Ndërsa për sa i përket përdorimit të gurit artificial për prodhimin e blloqeve të rinj, mendojmë se do të duhet të shmanget në Amantia. Ky i fundit mund të përdoret në rastet e nevojës për të integruar blloqe me forma të veçanta të ruajtur pjesërisht sikurse është arkitrau (pragu i sipërm) i hyrjes së varrit monumental nr. 3 i ruajtur *in situ* në 1/2 e tij[37]. Në rastet e tjera ai duhet të shihet si një alternativë e fundit në rast pamundësie apo kostoje të lartë të integrimit me gur natyror, për më tepër të një lloji tjetër. Sot kemi filluar të konstatojmë dobësitë e gurit artificial të përdorur para rreth 50 vjetësh në monumentet tona (p.sh. buleuterioni i Apolonisë) dhe mendojmë se ky material mundësisht duhet evituar.

Përmbyllje

Puna arkeologjike disavjeçare në Nekropolin Verilindor ka bërë të mundur të përcaktohet linja e duhur e veprimit për sistemimin e kësaj zone, ndërhyrjet e mundura restauruese në monumentet e veçanta dhe sjellja e zonës në parametrat e përshtatshme për t'u futur në skemën e vizitueshmërisë së Parkut Arkeologjik të Amantias[38]. Propozimet tona, të bëra në projektin "Parku Arkeologjik i Amantias – Ndërhyrje restauruese dhe sistemuese në Nekropolin Verilindor", të aprovuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit me vendim nr 147, datë 07 maj 2019, kanë si objekt grupin e varreve monumentalë nr 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 dhe varrin 107 me terrenin përreth tij. Këto dy pika do të shërbejnë si referenca më vonë për avancimin e punës arkeologjike dhe eventualisht restauruese për pjesën tjetër të nekropolit që do të duhet të kryhet në një periudhë shumëvjeçare.
Gërmimi i plotë i varrit monumental nr. 2 në sezonin e vitit 2019[39] ishte në vetvete një hap i punës së integruar arkeologjike dhe restauruese të parashikuar në projektin e aprovuar në KKR. Kjo punë nxorri në pah nevojën për disa përditësime të projektit. Ajo konfirmoi të dhënat që kishim në lidhje me potencialin arkeologjik të sipërfaqeve ku do të ndërhyhet, në mënyrë të veçantë për dendësinë e varrimeve të thjeshta të tipit cist.

[37] Buzo, Hobdari 2017, f. 113.
[38] Ndërhyrja më e rëndësishme restauruese e kryer në Amantia është ringritja (anastiloza) e portës lindore të fortifikimit në fillim vitet '90 (e drejtuar nga L. Papajani).
[39] Raporti i plotë dhe informacioni arkeologjik dhe arkitektonik i përftuar do të jepen në Iliria XLII (në përgatitje).

BIBLIOGRAFIA

1. Anamali 1972: S. Anamali, Amantia (La ville illyrienne d'Amantia), *Iliria* II, 1972, 61-133.
2. Bereti 1988: V. Bereti, Gërmimet arkeologjike të vitit 1988 – Amantia (Vlorë), *Iliria* XVIII/2, 1988, f. 255-256.
3. Bereti 1989: V. Bereti, Gërmimet arkeologjike të vitit 1988 – Amantia, *Iliria* XIX/2, 1989, f. 271-272.
4. Buzo, Hobdari 2014: J. Buzo, E. Hobdari, Nekropoli i Amantias: Varre dhe shpërndarja e tyre gjatë shekujve IV-I p.Kr., *Candavia* 4, 2014, f. 19-74.
5. Buzo, Hobdari 2017: J. Buzo, E. Hobdari, Varri monumental nr.3 i Amantias, *Iliria* XL, 2016, Tiranë 2017, f. 111-126.
6. Buzo, Hobdari 2018: J. Buzo, E. Hobdari, La nécropole d'Amantia, *L'ILLYRIE MÉRIDIONALE ET L'ÉPIRE DANS L'ANTIQUITÉ – VI, Actes du VIe colloque international de Tirana (20 – 23 mai 2015)*, volume II, Tiranë 2018, f. 497-506.
7. Buzo 2018: J. Buzo, Varre ciste të thjeshta nga nekropoli i qytetit antik të Amantias, *Iliria* XLI, 2017, Tiranë 2018, f. 195-212.
8. Buzo *in print*: J. Buzo, Varri monumental nr.12 i Amantias, *Candavia* 8, *in print*.
9. Ceka 1975: N. Ceka, Ndërtimet sepulkrale të qyteteve ilire (Les constructions sépulcrales des cites illyriennes), *Monumentet* 9, 1975, f. 35-53.
10. Hobdari, Buzo 2015: E. Hobdari, J. Buzo, Raport i punës arkeologjike në Amantia (2013-2014),*Iliria* XXXVIII, 2014, Tiranë 2015, f. 293-319.
11. Hobdari, Buzo 2016: E. Hobdari, J. Buzo, Raporti i punës arkeologjike në Amantia gjatë vitit 2015,*Candavia* 6, Tiranë 2016, f. 131-342.
12. Hobdari, Buzo 2018: E. Hobdari, J. Buzo, Amantia 2016: Raporti i kërkimeve arkeologjike dhe propozime për zhvillimin e parkut,*Candavia* 7, Tiranë 2018, f. 305-316.
13. Mertens 1995: D. Mertens, Planning and executing Anastylosis of Stone Buildings, në*Conservation on Archaeological Excavations. With particular reference to the Mediterranean area*, N. P. Stanley Price ed., ICCROM, Romë 1995, f. 113-134.
14. Patch 1904: C. Patch, *SandschakBerat in Albanien, Schriften der Balkan Kommision, AntiquarischeAbteilung* III, Vienë 1904.
15. Xhyheri *et al*. 2016: S. Xhyheri, S. Muçaj, A. Pentkovskiy, I. Ristani, Kërkime arkeologjike në krahinën e Vlorës, Mallakastrës, Myzeqesë dhe Korçës, *Candavia* 6, f. 279-314.

Tab. I



Legjendë

- ●A — Pika orientuese të kufirit të zonës A
- ●1 — Struktura funerare monumentale
- 517,0 — Kuota majash
- Përrua
- Kufiri i zonës së mbrojtur (2006)
- Kufiri i zonës së mbrojtur (2015)

1. Harta e Parkut Arkeologjik të Amantias

Tab. II



1. Plan i pjesshëm i Parkut Arkeologjik të Amantias me Nekropolin Verilindor

Tab. III



1. Plan i pjesshëm i Parkut Arkeologjik të Amantias me Nekropolin Verilindor



2. Foto varri nr. 2 para gërmimit



3. Foto varri nr. 3 pas gërmimit

Tab. IV



1. Planimetri e varrit monumental nr. 2 me shtresën e blloqeve të numëruara.



2. Pamje e varrit monumental nr. 2 pas gërmimit. Me numra blloqet e rivendosur.



3. Mënyra e lëvizjes së blloqeve.



4. Pamje ajrore e kantierit të varrit monumental nr. 2, në përfundim të gërmimit.(korrik 2019)

Tab. V



1. Planimetri e varrit monumental nr. 2



2. Prerje c – c’



3.1. Prerje 1 – 1’



3.2. Prerje 2 – 2’



3.3. Prerje 3 – 3’ dhe Detaj 1

Tab. VI



1. Prerje d – d'



2. Prerje a – a'



3. Prerje b – b'

Tab.VII



1. Sistemimi i propozuar i sektorit të varreve nr. 2 - 7

Tab. VIII



1. Varri monumental 107: Pamje e përgjithshme (2015)



2. Varri monumental 107: Planimetri me sistemimin aktual dhe prerje

Tab. IX



1. Sistemimi i propozuar për sektorin e varrit monumental 107 (faza e parë)



2. Pamja e varrit monumental 107 pas përfundimit të anastilozës (faza II)

Tab. X



1. Seksion i varrit monumental 107 dhe kodrës ku ndodhet me sistemimet e propozuara të skarpatave



2. Detaj 1

Elio HOBDARI
Jamarbër BUZO
Rudina PAPAVASILI

PROPOSAL FOR RESTORATION IN NORTHEASTERN NECROPOLIS OF AMANTIA

Archaeological excavations undertaken in recent years in Amantia by Institute of Archaeology were mainly focused on the Northeastern Necropolis. The excavations were preceded by a site survey conducted in 2011 focusing on funerary structures and the general layout of the ancient necropolis.

From 2013 onwards, dozens of funerary structures have been studied in the Northeastern necropolis area, among which the monumental ones are of special interest. The northeastern Necropolis lies on a series of low hills with almost north-south orientation (Pl. I) and contains some of the most important funerary monuments.

The earliest materials coming from this necropolis date back to the second quarter of 3rd century BC. During 3rd-2nd century, monumental tombs structures coexist with simple *cist* ones and those built of bricks. Tomb structures made of tiles are often discovered very close to them as well as *urnae* placed in shallow pits, which are mainly dated after the middle of 2nd – 1st century AD.

Monumental tombs are often placed in groups, as in the other necropolises of Amantia. Concentration of monumental tombs no. 2-7 is one of the most prominent in the entire Northeastern Necropolis. Another concentration of tombs is observed on the southern extreme of the necropolis, while in the northernmost extreme are the monumental tombs no. 9 and 107. Next to them, on the hill ridge, above Tomb no. 107, there is a concentration of cist tombs (identified with no.8 in necropolis map) (Pl. I) There are probably other still unidentified monumental structures in the area. The northeast necropolis contains almost all types of built tombs generally identified in the territory of Amantia. Tombs no. 2(Pl. IV-VI) and 3 belong to the type with burial chambers with barrel vault, the first with burial vestibule and the second with a dromos. Tomb no. 107 is the largest and qualitative example of the type “built tumulus” (Pl. VIII-IX), while tomb no. 5 is of another type.

In addition to natural factors, human activity has played a major role in the current state of preservation of these tombs. Until the middle of 20th century, in the area was a neighborhood of Sevaster village. Today, there are no traces of the constructions of that time, which have influenced the funerary structures. Construction material obtained from excavation of tomb no. 2 has clear traces of voluntary demolitions. Currently, tomb no. 2 has been completely excavated, while in tomb no.3, the dromos has not been excavated. Integration of this structure is possible,

but it is considered to be more understandable and well presented in its current shape. Tomb no. 107 has been completely excavated as well, excluding only the outer demolished layer. Other funerary structures appear only partially, but we propose anastylosis intervention only for tomb no. 2 and 107. In the first, the objective is to raise the structures up to the first row of springers and the dividing wall of the two spaces up to the door lintel. In the Tomb 107 we aim to identify all the blocks moved from the structure, to arrange the territory by returning it as the original relief and, after its compaction, to handle the complete anastylosis of the circular structure. After this intervention, the interior will be filled in order to create the original tomb. Eventually the monument will be back to its original appearance.

The proposed material for the integration of the anastylosis can not be the local conglomerate used in Amantia's masonry. It is proposed the limestone that can be extracted in Lepenica quarry (*ca*. 10 km from Amantia). This type of stone was used in antiquity in Amantia for architectonic decoration of public and religious buildings; therefore its use can be naturally considered and at the same time distinguished from the original stone blocks. It is also more resistant to natural deterioration factors and could somehow protect the original masonry when placed as coronation of the old masonry.

The area of tombs no. 2-7 (Pl. VII) is intended to be arranged by identifying the entire funerary structures and by securing them.

About the area around Tomb 107, a preliminary arrangement is foreseen that will enable its restoration and valorization. This will serve as a first step in advancing the excavation above the hillside, by discovering other possible tombs and bringing the hill relief to the original shape it had in antiquity (Pl. X).

Petrit BILALI
Dr. Era XHAFERAJ

"DY RRUGËT" – KOLË IDROMENO. DREJT NJË RIINTERPRETIMI KRITIK TË VEPRËS

Sfondi historik

Kolë Idromeno[1*] është figura më e rëndësishme e shek. XIX, nga pikëpamja e jetës artistike dhe lëvizjeve artistike që ndodhën gjatë kësaj periudhe. Jeta dhe vepra e tij kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të shumtë[2]. Idromeno ka qenë një artist shumë dimensional dhe ndër përfaqësuesit e parë të artit të rilindjes shqiptare[3]. Dalloi për stilin e tij të veçantë, intuitën dhe konceptet e spikatura në krijim, të cilin e lëvroi në pikturë, por edhe në fotografi, arkitekturë, etj.

Artisti jetoi në një periudhë të trazuar, me ngarkesa të shumta politike dhe kulturore, të cilat influencuan formimin, gjuhën dhe përzgjedhjen e artikulimit të tij artistik. Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare në shek. XIX, "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", mund të konsiderohet si një nga ngjarjet historike më emblematike, e cila pati një rol vendimtar në zgjimin e identitetit kombëtar dhe stimuloi zhvillimin e literaturës dhe artit kombëtar[4]. Ndonëse ecuria e arteve figurative ndoqi ritme më të ngadalta, pasi filozofia e kohës mbështeste me tepër zhvillimin e artizanatit dhe zejeve, se sa artin e mirëfilltë, sërish shkollat dhe qendrat e organizatave patriotike jashtë vendit, apo shtëpitë e intelektualëve vendas, dashamirës të artit, u kthyen në strehë, ku do të formoheshin dhe do spikasnin piktorë të shumtë[5].

Nuk është as e rastit që ishte pikërisht qyteti i Shkodrës vendi i cili u kthye në një prej qendrave më të rëndësishme të zhvillimit; me një histori mijëravjeçare dhe tradita të shumta, Shkodra mbajti rolin e saj si një qendër e rëndësishme e artit dhe kulturës, me lidhje të shumta tregtare me qytete të rëndësishme të Evropës, si Venecia, Firence, Stambolli, si dhe seli e religjioneve më me influencë në gjithë pjesën veriore të Shqipërisë.

---

[1] * Falënderim i veçantë për drejtorin e Muzeut dhe punonjësit e tij, që mundësuan fotografimin e veprës dhe studimin nga afër të saj, dhe për më tepër për materialet që vunë në dispozicion në lidhje me mjeshtrin e madh të artit shqiptar, Kolë Idromeno.

[2] M. Prenushi, *Kolë Idromeno (1860 – 1939). Jeta dhe Veprat*, Tiranë, 1984, së bashku me bibliografinë përkatëse. Autori i kushton një prej monografive më të plota figurës dhe personalitetit të Kolë Idromenos. L. Miraj, K. Barushi, B. Deda, *Kole Idromeno and the Neoclassical Architecture in Shkodra, University of Business and Technology in Kosovo, International Conference,* 2012, f. 155 – 172; E. Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar (1858-2000),* Tiranë, 2019, f. 28; O. Gripshi, Biblical-philosophical Scenery of Kole Idromeni in "Two Paths of Life", *Anglisticum*, Volume 3, Issue 3, 2014, f. 78 – 82.

[3] Dh. Dhamo, Mbi karakterin kombëtar dhe realist të arteve tona figurative, *Studime Historike*, 2, f. 27.

[4] K. Frashëri, Lëvizja kulturore në vitet e Lidhjes së Prizrenit, në *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II (Rilindja Kombëtare vitet '30 të shekullit XIX – 1912), Tiranë, 2002, f. 204 – 216.

[5] Për formimin e Kolë Idromenos shih monografinë: M. Prenushi, *Kolë Idromeno (1860 – 1939). Jeta dhe Veprat*, Tiranë, 1984.

Ishte pikërisht ky sfond kompleks historik dhe kulturor, ku lindi dhe u mbrujt figura e Kolë Idromenos, dhe po ashtu komplekse dhe e larmishme do të ishte edhe tematika e artit të tij, si një qëndrim kritik ndaj realitetit që e rrethon, një art që flet me konceptet e tij, një art analizues i kryeveprave letrare që bënë epokë, një art denoncues dhe qortues. Vepra e tij e pasur, e cila përfshin një shumësi tablosh, skicash, fotografish, përcjell mesazhe të shumta intelektuale, politike, shoqërore, dashurie. Këto dimensione mund të analizohen edhe në tablonë "Dy rrugët", një nga veprat më të famshme dhe mbresëlënëse të artistit, një shembull i suksesshëm i subjektit dhe narrativës religjioze, e pikturuar me porosi të misioneve fetare, ku nuk mungojnë njohuritë e thella të artistit dhe qëndrimet e tij mbi fenë e krishterë dhe rrymat artistike që përshkuan artin e periudhës së tij. Ajo që shohim është një artist i pjekur me talent në kompozim, me zë dhe me personalitet të dallueshëm nga bashkëkohësit e tij dhe me një mjeshtëri të pakrahasueshme dhe stil krijues që kapërcen nga realizmi, tek impresionizmi dhe baroku.

Përshkrimi dhe interpretimi i tablosë

Vepra "Dy rrugët" e Kolë Idromenos (sot pjesë e muzeut historik të Shkodrës) është një ndër shembujt e gjallë të kulturës dhe njohjes aq komplekse të autorit. Tabloja e realizuar rreth vitit 1896, ka përmasa 196 x 168 cm dhe paraqet 210 figura të plota njerëzore, të realizuara në miniaturë me teknikën e vajit mbi telajo[6]. Në kulmin e kompozimit, në qendër të tij, paraqitet Trinia e Shenjtë, ku përfytyrohen tre figurat kryesore: Ati Sabaoth me nimbus trekëndor, simbol i Trinisë[7], Krishti me simbolin e Kryqit, dhe Shpirti i Shenjtë, të shoqëruar nga procesioni i të Drejtëve të ndarë në dy pjesë. Në grupin e pjesëmarrësve në gjykim mund identifikohen figurat e katër ungjillorëve - pranë të cilëve simbolet e tyre, demi, luani, shqiponja dhe engjëlli - por edhe të apostujve të tjerë.

Përgjatë terrenit të thyer, paraqitet rrugëtimi i qetë dhe paqësor i të zgjedhurve të regjistruar nga engjëjt drejt gjykimit, deri në kulmin e tablosë, ku ndodhet Parajsa, vendi ku ata do të shpërblehen. Këtu përfshihen grupet e të drejtëve mirënjohës, ku bazuar në veshjet e tyre bëjnë pjesë dhe njerëz që i përkasin shtresës së lartë sociale, grupet e të varfërve të veshur me kostume të thjeshta popullore, të gjithë të prirë nga grupi i murgjve dhe priftërinjve, në pjesën e sipërme të kompozimit. Kryeengjëjt si lajmëtarë të Perëndisë për ditën e Gjykimin të Fundit, e cila do të realizohet në varësi të bëmave të individëve, lidhen gjithashtu me përfshirjen e këtyre grupeve në pjesën e sipërme të pikturës.

Simbolika e qengjit gjen shprehje edhe në tablonë e Idromenos. Qengji, i cili ka qenë një prej simboleve më të qëndrueshme në ikonografinë e krishterë, përfaqësonte jo vetëm besimtarin, por ishte njëkohësisht simbol i sakrificës hyjnore, paraqitet në pjesën e sipërme, në formën e një kopeje të vogël, duke kullotur në bimësinë e ulët të terrenit shkëmbor, përkrah grupeve që luten dhe pushojnë. Një tjetër simbolikë përfaqëson edhe dhia, ku sipas traditës së Krishterë, ajo përfaqëson të mallkuarit, siç vërehet edhe në përshkrimin e Gjykimit të Fundit nga Mateu (Mt 25: 32 – 41), sipas të cilit Krishti si një bari

[6] Që nga koha e krijimit të saj tabloja "Dy rrugët" ka kaluar peripeci të mëdha, për t'u trashëguar publikut shqiptar si një aset kulturor në ditët e sotme. Në vitet '20 raportohet të jetë realizuar një restaurim i saj, i cili nuk ka prekur idenë kryesore të kompozimit, ndërsa në vitin 1974 një tjetër restaurim është realizuar nga sektori i Artit, pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë. Shih për këtë ndërhyrje: A. Sadikaj, Restaurimi i tablosë "Dy rrugët" e piktorit Kolë Idromeno, *Monumentet* 11, 1976, f. 107-113. Gjatë lëvizjeve antikomuniste të dhjetorit të vitit 1990 në Shkodër dhe heqjes së bustit të diktatorit, ish Muzeu Ateist i Shkodrës pësoi dëmtime, që përfshinë edhe objektet e ekspozuara aty, një pjesë e mirë e të cilave tashmë kanë humbur pa lënë gjurmë. Piktura "Dy rrugët" u gjet rastësisht nga Gjergj Spathari dhe miku i tij Nikolin Kocaj, dy artistë shkodranë, e zhvendosur nga vendi i saj i ekspozimit, dhe e dëmtuar. Në vitin 1992 piktura iu nënshtrua restaurimit nga restauratorja Majlinda Agolli, pranë Galerisë Kombëtare të Arteve.

[7] A. N. Didron, *Christian Iconography or The history of Christian art in the Middle Ages*, Vol. 1, 1886, f. 30.

ndan delet nga cjeptë. Nuk është e rastit që Kolë Idromeno, njohës i mirë i simbolikës dhe i artit të Rilindjes dhe artistëve rilindës, veçanërisht në Itali, të cilët përjetësuan në zhanrin e narrativës religjioze simbolikën e kafshëve antike dhe mesjetare, paraqet cjeptë si shoqërues të grupit të të mallkuarve, duke përdorur edhe një herë funksionin e kafshës si simbol i mëkatarit[8]. Edhe në këtë rast imazhi i kafshëve vazhdon të veprojë si një metaforë, duke mbartur domethënie, të cilat nuk janë sipërfaqësisht të dukshme për shikuesin.

Në kontrast me atmosferën e patrazuar të rrugës drejt Parajsës, në gjysmën e poshtme të kompozimit trajtohet rruga drejt Ferrit, pikënisja e së cilës pasqyrohet në mënyrë simbolike nëpërmjet një strukture monumentale në formën e një harku "triumfi", nga ku vërshon një procesion i dendur njerëzor, prej të mashtruarish dhe mëkatarësh. Këta shfaqen në grupe të shoqëruar nga imazhet antropomorfe të demonëve me trupa të errët, flatra, brirë dhe bisht, të realizuara në mënyrë mjaft mbresëlënëse, paraqitja e të cilëve huazon elementë nga imazhet antike me një karakter mjaft popullor të Panit dhe të Satirëve[9], të cilët torturojnë mëkatarët, prej të cilëve dallojmë grupin e vrasësve, ahengxhinjve, hokatarët dembelë, kapadainjtë krenarë, pijanecët, koprracin që refuzojë të japë lëmoshë për gruan e varfër me fëmijë që i shtrin dorën apo mashtruesin e portretizuar nëpërmjet fallxhores, etj., ndonëse për pjesën më të madhe të personazheve të paraqitur nuk përcaktohet mëkati apo vesi. Trajektorja në dukje e gjallë, festive dhe në lulëzim drejt vesit, me kostumet shumëngjyrëshe, veprimet e vrullshme dhe dinamizmin e gjesteve, ndërpritet ndërsa arrin në një fund duke u zbehur nëpërmjet vdekjes! Pikërisht këtu, në pjesën fundore, shfaqet Lumi i Zjarrtë, një nga paraqitjet më piktoreske dhe karakteristike të kompozimit të Gjykimit të Fundit, me Djallin në formën e një përbindëshi, i ngjashëm me djajtë e tjerë por i ndryshëm për shkak të dimensioneve shumë më të mëdha, dhe shpirtrat e torturuar për mëkate të ndryshme përgjithësisht të realizuar në monokromi. Kjo pjesë, e trajtuar në formën e një krateri me dallgë flakëruese, të realizuar si një masë me ngjyrë të kuqe të errët, të përzierë me portokalli, e rrethuar prej njollave të errëta deri në të zi të shkëmbinjve, përcakton kufirin e fundit, ose më mirë, kufirin e fundit të errësirës.

Në pamje të parë, vepra prezanton një kompozim apokaliptik, perspektivën e Ardhjes së Dytë dhe ngjarjen e saj qendrore, Ditën e tmerrshme të Gjykimit, ikonografia e të cilës është frymëzuar si nga Testamenti i Vjetër edhe i Ri, kryesisht nga Apokalipsi i Gjonit dhe libri i Danielit. Imazhet e Gjykimit të Fundit, ishin mjaft të përhapura në ikonografinë fetare, katolike dhe ortodokse[10], gjatë shek. XIX, por shtjellimi i vizionit apokaliptik prej Kolë Idromenos ka nuanca të veçanta individualizmi. Në ballafaqimin midis veseve dhe virtyteve, pra, mëkateve themelore, si grykësia, epshi, lakmia / koprracia, hidhërimi / dëshpërimi, zemërimi, përtacia, lavdia, krenaria[11] – të pasqyruara në gjysmën e poshtme të tablosë – përkundrejt dëlirësisë/pastërtisë, vetëpërmbajtjes, përkujdesjes, përulësisë, zemërgjerësisë / bamirësisë, mirësisë / mirënjohjes, durimit / dhembshurisë - të pasqyruara në pjesën e sipërme të tablosë – protagonistët janë frymëzuar nga një sfond lokal, me veshje familjare për kontekstin vendas, kostumografi popullore dhe mbi të gjitha me një simbolikë të theksuar për të

[8] Shih për simbolikën e kafshëve në pikturë: S. Cohen, *Animals as disguised symbols in Renaissance art*, Leiden – Boston, 2008, f. 22 dhe 220.

[9] Për paraqitjen e demonëve në pikturën pas bizantine, shih: M. K. Garidis, *Etudes sur le Jugement dernier post-byzantine du XVe à la fin du XIXe siècle. Iconographie – Esthetique*, Thessaloniki 1985, 31-62.

[10] M. W. Smith, The Apocalypse of John, *College Art Journal*, Vol. 9, No. 3 (Spring, 1950), f. 295 – 307.

[11] Si literaturë për mëkatet themelore shih: M. Bloomfield, *The Seven Deadly Sins*, Lansing: Michigan State College Press, 1952.

denoncuar plagët e shoqërisë shkodrane dhe asaj shqiptare në përgjithësi të fundit të shek. XIX.

Por krahas një leksioni në edukimin moral të njerëzve, Kolë Idromeno kërkon të na njohë me një dilemë të përhershme të Njerëzimit, një tematikë që ka ngacmuar dhe shqetësuar gjithmonë artistët, atë të zgjedhjes midis virtytit dhe vesit; dhe pikërisht këtu qëndron arsyeja që ndonëse në një vepër të porositur, me qëllime të qarta, del në pah personaliteti i piktorit, i cili e mënjanon veten nga predikimet ungjillore, duke e trajtuar dhe konsideruar vetveten si një njeri me dobësi, një njeri të botës, dhe duke e integruar portretin e tij në grupin e ahengxhinjve. Pra, një tablo që në pamje të parë paraqitet si një leksion fetar, një variant i paraqitjeve apokaliptike dhe i kujton Njerëzimit vlerën e virtytit, por edhe një alegori midis së mirës dhe së keqes, "Dy rrugëve". Ajo na shfaq edhe një tjetër aspekt të Kolë Idromenos, pikërisht njohuritë e tij të thella rreth kostumografisë tradicionale duke na dhënë një leksion të mirëfilltë etnografik dhe historik nëpërmjet veshjes së personazheve të trajtuar në miniaturë me kostume tradicionale shqiptare, të veriut shqiptar, dhe duke përdorur këtë element si një mjet identifikimi si krahinor, fisnor, gjinor, fetar, deri tek rangjet shoqërore, nga zanatçiu i thjeshtë e deri tek njerëzit që mbanin funksione zyrtare, etj. Ndërthurja në një tematikë fetare të mirëpërcaktuar në kanone dhe përmbajtje si Gjyqi i Fundit, edhe e shqetësimeve shoqërore, e dallon artin e Kolë Idromenos, i cili merr dhe karakter denoncues, duke prekur dramën e realitetit të kohës së tij, atë të gjakmarrjes dhe të vëllavrasjes. Pra, piktori eksploron historinë dhe realitetin, të shkuarën dhe të tashmen, duke na shfaqur sfidat sociale dhe praktike me të cilat mëkatet cenojnë spiritualitetin, etikën dhe jetën e përditshme.

Vepra mbart influenca të mëdha nga kryeveprat e artit botëror, siç vërehet në perceptimin e Parajsës dhe ndërtimin e saj, një frymë që lindi me rilindësit italianë dhe përfshiu mbarë Europën. Njëkohësisht, influenca perëndimore tek Idromeno vërehet dhe në kujdesin e treguar ndaj paraqitjes së qenies njerëzore, si nga pikëpamja e fizionomisë dhe anatomisë edhe në dhënien e emocioneve. Përdorimi i pasur i ngjyrave të shndritshme, kostumet shumëngjyrëshe dhe gjallëria e lëvizjeve, të kujtojnë pikturat e rilindësve italianë, veçanërisht të Veroneses dhe Kanaletos, vepra e të cilëve duket se e ka frymëzuar së tepërmi, duke i kthyer këta në mësues *post – mortem* për artistin e ri/student gjatë qëndrimit të tij në Venedik. Por dramaticiteti, ndjenjat e forta dhe pasioni i shtjelluar veçanërisht në gjysmën e poshtme të tablosë, të kujtojnë herë lëvizjet e theksuara të vizatimeve të Rubensit dhe herë vënë në dukje një prekje lehtë të romanticizmit italian, një stil i cili karakterizohet nga pasioni dhe ndjenjat e forta, por në çdo rast bashkohen nga frymëzimi që marrin artistët nga bota e mistershme mesjetare. Megjithatë, në çdo rast nuk mungon individualizmi, ngacmimi që merr artisti nga konteksti vendas, dhe që nxjerr në pah gjenialitetin e Idromenos botën e tij të pasur dhe shumëdimensionale, duke përdorur hyrjen e kalasë së Shkodrës si motiv për hyrjen drejt Parajsës.

E parë në tërësinë e saj, "Dy rrugët", një pikturë e porositur nga misionet fetare, ikonografia e së cilës ishte përgjithësisht e përcaktuar si një detaj i kompozimit mjaft të njohur në kishat perëndimore dhe lindore, atë të Apokalipsit. Kjo tematikë, gjatë shekujve pëson shumë ndryshime dhe risi me elementë të rinj me prejardhje laike, nga jeta e përditshme, traditat lokale, kushtet sociale të çdo kohe, akoma dhe nga besëtytnitë e masave të gjera, tematika të veçuara grafike, laografike, të cilat e kanë origjinën nga konceptet apo tradita të lashta, në kombinim gjithmonë me mësimet e kishës. Kolë Idromeno arrin të përçojë nëpërmjet veprës së tij jo vetëm luftën midis së mirës dhe së keqes, por duke përdorur një tematikë tërësisht fetare, denoncon me artin e tij çështje tërësisht laike dhe realiste, duke u frymëzuar në kontekstin shoqëror dhe historik që e rrethon, duke e bërë të vështirë përcaktimin e kësaj vepre si një tablo me përmbajtje tërësisht fetare madje duke i dhënë dhe titullin simbolik dhe laik "Dy rrugët".



Dy Rrugët, Kolë Idromeno, vaj në Kanavacë

Petrit BILALI
Dr. Era XHAFERAJ

"TWO PATHS OF LIFE" – KOLË IDROMENO. TOWARD A REINTERPRETATION OF THE PAINTING

Kolë Idromeno is one of the most important Albanian artistic personalities of 19th century, in terms of art and art movements that occurred over this period. A multidimensional artist and one of the most widely recognized representatives of the art of Albanian Renaissance for the impressive diversity of his oeuvre, as he produced not only paintings but also drawings, photographs, etc. He lived in Shkodra during a period of political and social unrest. As such, many of his works confronted the complex social, political, and economic consequences of the turmoil such being a mechanism for conveying multiple intellectual, political, social and even love messages. These dimensions of his work are present in the "Two paths of life", a successful example of religious art subject and narrative, where the artist imbued the painting with emotions, in many cases with high drama, revealing deep knowledge of Christian faith, art and symbolism and simultaneously mastery of the techniques and artistic trends that permeated the art of his period.

Although from a first glance the tableau presents an apocalyptic composition, a traditional Christian iconography, bound up with the late medieval theme of the punishments of the damned at the Last Judgment, he also incorporated an individual style noted for its clarity, rich colour, effortless composition, and grandeur that was distinctly his own. The painting is divided into an upper and lower register; the upper half is dominated by the representation of Holy Trinity placed in the center of the panel and the four evangelists with their symbols accompanied by a large group of the righteous and holy apostles divided in two at either side. The lower part of the panel depicts the sinful mankind and the punishments in Hell, the result of man's sinfulness. It depicts a large body of mortals and demons accompanying them and depending banished into hell. At the end of their procession they are scuttled and tormented by demons toward the right hand side. Some of the devils drag the condemned using a chain, in a passage in the lower right, four demons drag souls towards a pit where another devil, different from the rest by its distinctly large dimensions, wait at a raging fire.

Confronting virtues and vices the painter incorporates the scenes into a local context, with the protagonists depicted in miniature with a traditional outfit, and using the symbolic of vices and man's sinfulness as a tool to draw the attention toward and to denounce the wounds that concerned the society of 19th century Shkodra and Albania generally. Although the panel is commissioned by the religious mission with a subject that has a clearly defined iconography, again it reveals painters' distinct personality which transforms his work not only into

a lecture for educating people reminding them the value of virtue or an allegorical representation of good and bad, "the two paths", but an ethnographic and historical lecture, with the characters dressed up with traditional outfit of northern Albania, and using this element as an instrument for regional, tribal, gender, religious and social rank identification. The combination of the religious subject with social concerns and challenges discerns the art of Kolë Idromeno, ascribing to it the denouncing character, an art created as a response to social unrest, treating the wounds and the drama produced by blood feud and fratricide. The painter explores the history and reality, the past and the present, and introduces the viewer with the social challenges and the sins which violate spirituality, ethics and everyday life.

The oeuvre bears influences from the masterpieces that circulated in European milieu, as noted from its structure and the perception of Paradise. Western influences are noted also in the rendering of the human representations, the precise anatomical correctness, and authentic emotionality and expression. The rich use of bright colours, the multicolour costumes and the vivacity of movements echoes the style of Italian Renaissance painters, especially of Veronese, and of Canaletto. During his stay in Venice, he most have acquired a deep knowledge of ancient and recent Italian art, which served as the basis of his own distinctive style. The drama developing in the lower half of the panel, the intensity of expression and movements, sometimes recall the pronounced movements of Rubens's drawings and sometimes point out a slight touch of Italian romanticism. In each case distinguishes Idromeno's individualism and the impulse that the artist receives from his local environment and context, highlighting his genius, rich and multidimensional inner world. The combination of the apocalyptic subject to convey social issues violate the definition of the panel of Kolë Idromeno as completely religious work, which gave to his painting the symbolic and secular title "two paths of life".

Dritan ÇOKU

XHAMIA NË FSHATIN VOKOPOLË TË BERATIT

Fshati Vokopolë i komunës Tërpan gjendet në skajin më jugor të rrethit të Beratit. Ka qenë një qendër krahinore dhe qendër e hershme banimi me zhvillim të lart kulturor[1].

Në këtë fshat, gjendet një xhami e vjetër (Fig. 1-5). Pas Luftës së Dytë Botërore, ajo u kthye në shkollë, për një kohë të shkurtër, pasi shkolla në lagjen e sipërme (në krye të Xhoxhajt) u shkatërrua gjatë luftës[2]. *"…Nëse përpara Çlirimit propaganda fetare nëpërmjet librave, gazetave dhe revistave të saj mbizotëronte ndaj propagandës ateiste, gjatë viteve të pushtetit popullor ky raport u përmbys..."*[3] Në mesin e viteve '50 të shek. XX, minareja e xhamisë u shkatërrua. Kooperativa bujqësore në fshat u krijua në vitin 1957. Xhamia në atë kohë u përdor si magazinë (për drithra etj.). Deri në këtë vit shërbeu edhe hoxha i xhamisë z. Halil Ago. Pas viteve '90 të shek. XX, xhamia u përdor për një kohë të shkurtër si bilardo (rreth dy vjet)[4].

Gjatë vitit 2018, pas përgatitjes së studimit nga ana jonë dhe propozimit për shpallje monument kulture të kategorisë së parë[5], në shkurt të 2019 xhamia e Vokopolës fillimisht shpallet në mbrojtje paraprake[6] dhe në nëntor po të këtij viti deklarohet si pasuri kulturore "monument kulture i kategorisë së parë"[7].

Përshkrimi arkitektonik

Objekti paraqet një ndërtim të tipit sallë me kupolë (TAB. 1-3), që për nga përmasat e planit 6,92 x 6,92 m, afrohet me xhamitë e Allajbegisë, të Velabishtit dhe atë të Përmetit. Xhamia përbëhet nga salla e lutjeve, minarja, nga e cila sot dallohen

---

[1] Plaku, Zylyftar., *Berati Enciklopedi*, Tiranë: Jonalda, pa datë, f. 811.

[2] E dhënë prej z.Ali Hoxha, banor i vjetër i fshatit.

[3] Basha, M.Ali., *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë, 2011, f. 433.

[4] Këto të dhëna janë marrë prej z. Ali Hoxha, banor i vjetër i fshatit.

[5] Skicimi, rilevimi (29.10.2018), përpunimi grafik dhe studimi mbi këtë objekt është kryer nga autori i artikullit. Ky material u dërgua nga DRKK-Berat me shkresë Nr. 536 Prot., datë 12.12.2018 dhe pas shqyrtimit të tij, për xhaminë e Vokopolës u nxorr një Urdhër nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore "Për shpallje në mbrojtje paraprake", Nr. 424 Prot., datë 22.02.2019.

[6] Arkivi i DRTK-Berat, Institucioni i shpalljes: Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri", Urdhër për shpallje në mbrojtje paraprake, Nr. 424 Prot., datë 22.02.2019.

[7] Arkivi i DRTK-Berat, Institucioni i shpalljes: Ministria e Kulturës, Urdhër Nr. 675, datë 13.11.2019, "Për deklarimin pasuri kulturore të objektit "Xhamia e Vokopolës", në fshatin Vokopolë, Berat.

gjurmë nga bazamenti dhe portiku, ekzistenca e të cilit vërtetohet nga vazhdimi i gjurmës së murit në qoshen veriperëndimore të xhamisë (Fig. 6). Sot ky portik nuk ekziston. Hyrja për në faltore është nga ana veriore, me një portë që mbulohet me hark të ulët prej guri. Në të dyja anët e portës ka nga një dritare. Dritaret e poshtme kanë kangjella hekuri.

Përballë hyrjes, në brendësi, ndodhet nikja e mihrabit, e cila përfundon në pjesën e sipërme me stalaktite dhe katër dritare. Dy të sipërmet janë me hark. Në krahun e djathtë të sallës ndodhet porta e ulët për në minare, sot e murosur.

Salla e lutjeve mbulohet me kupolë sferike mbi katër trompa në këndet e katrorit. Kupola është e ndërtuar fillimisht me gurë ngjyrë gushëpëllumbi, pastaj vazhdon dhe përfundon me gurë smërçi. Salla ndriçohet bollshëm nga dy dhe katër dritare në secilën faqe. Dritaret janë të vendosura: në anën e hyrjes dy dritare poshtë, në dy anësoret nga një dritare poshtë dhe një lart dhe në anën jugore dy poshtë dhe dy lart. Këtë vendosje me këto hapësira drite, e kushtëzon përmasa e vogël e xhamisë.

Dritaret e radhës së poshtme, të ngritura pak nga trualli përreth xhamisë janë drejtkëndëshe, me arkitra guri njëcopësh. Mbi arkitra kemi një radhë gurësh dhe një hark shkarkues në formë fundlundre, ndërtuar me gurë smërçi si dhe me gurë celnik* ngjyrë gushëpëllumbi. Dritaret e sipërme janë trajtuar më thjesht: janë mbuluar vetëm me një hark prej guri, gjysmërrethor. Dyshemeja është realizuar me pllaka guri.

Në anën e jashtme xhamia përbëhet nga vëllimi kubik dhe kupola mbi tambur. Kupola ka qenë e mbuluar me rrasa guri, sot është me tjegulla. Vëllimi kubik përfundon me çati me trekëndësha të ulur në qoshet dhe, mbi të, me një ngushtim të lehtë, ngrihet tamburi tetëfaqësh.

Në pamjen lindore të xhamisë është gjurma e bazamentit të minares (Fig. 7), që duket pjesërisht (për shkak të mbulimit të saj nga rrëshqitjet e dheut dhe bimësisë së ulët dhe të lartë).

Në muraturën e xhamisë janë përdorur dy lloje gurësh: guri i bardhë dhe guri celnik. Të dy këta janë nxjerrë nga zona (Vokopola). Muratura është ndërtuar me gurë të rregullt e të lidhur me llaç gëlqereje. Në brendësi ruhen pjesërisht gjurmë të suvatimit të vjetër.

Datimi

Në mungesë të të dhënave mbishkrimore apo burimore, vendosja në kohë e xhamisë së vjetër të Vokopolës është e vështirë. Kështu që na mbetet të bëjmë krahasime tipologjike, si në pikëpamje të planimetrisë, ashtu edhe të teknikës së ndërtimit me xhami të tjera të vendit tonë. Duke u nisur nga përpjesëtimet e rënda, por në të njëjtën kohë forma të vona në ndërtimin e saj vëllimor e planimetrik (të tilla janë forma e tamburit, teknika e ndërtimit dhe trajtimi i brendshëm), karakteristika si te xhamia e vjetër e Përmetit[8], nisim të mendojmë për xhaminë e vjetër si një xhami të shek. XVII.

Gjendja ekzistuese

Aktualisht gjendja e xhamisë dhe territorit përreth saj lënë për të dëshiruar. Xhamia nuk ka dritare, derë, madje nga mosvënia dorë edhe e banorëve të zonës, brenda saj ka mbartje dheu 0,2 m. Nga ana lindore e xhamisë prej agjentëve atmosferikë ka rrëshqitje të dherave, që ka sjellë ngritjen e nivelit të terrenit, duke u mbuluar kështu gati gjysma e kësaj pamjeje (Fig. 8). Të njëjtin problem, por më të pakët e ka edhe ana jugore (Fig. 4) dhe ajo veriore (Fig. 2). Si brenda, ashtu edhe jashtë xhamisë janë kryer gërmime të paligjshme (Fig. 9). Objekti ka lagështi si dhe dëmtime të suvatimeve të brendshme (Fig. 9-12).

Përfundimi

Ndër monumentet e kultit mysliman, xhamitë zënë

[8] ***** Gur i fortë, si çelik, me ngjyrë të hirtë i nxjerrë nga zona (kavot e Vokopolës).
Meksi, Aleksandër., *Arkitektura e xhamive të Shqipërisë (shekujt XV – XIX)*, Tiranë: Uegen, 2007, f. 67.

një vend kryesor nga numri, vlerat dhe përhapja. Me ndërtimin e tyre, gati në gjithë territorin e Shqipërisë, ato përbëjnë një dukuri arkitektonike me rëndësi të veçantë[9].

Xhamia e Vokopolës duhet t'i nënshtrohet sa më parë ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese, të cilat do të parandalonin në kohë degradimet e thella të mundshme dhe do të përmirësonin gjendjen e këtij monumenti me vlera historiko-kulturore, duke e bërë funksional për besimtarët myslimanë, jetëgjatë dhe duke shërbyer në funksion të trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

[9] Meksi, Aleksandër., *Vep. cit.*, f. 11.



Fig. 1: Xhamia e vjetër në fshatin Vokopolë të Beratit.



2: Pamja veriore e xhamisë.



3: Pamja perëndimore e xhamisë.



Fig. 4: Pamja jugore e xhamisë.



Fig. 5: Pamja lindore e xhamisë.



Fig. 6: Gjurmë muri të portikut, në qoshen veriperëndimore të xhamisë.



Fig. 7: Gjurmë të bazamentit të minares së xhamisë



Fig. 8: Rreth gjysma e pamjes lindore e mbuluar nga rrëshqitja e dherave prej agjentëve atmosferik.



Fig. 9: Pamje nga gërmimet e paligjshme brenda të xhamisë.



Fig. 10: Pamje nga faqja e brendshme jugore e murit të xhamisë.



Fig. 11: Pamje nga faqja e brendshme lindore e murit të xhamisë.



Fig. 12: Pamje nga faqet e brendshme perëndimore e murit të xhamisë.

TAB. 1



Xhamia në fshatin Vokopolë të Beratit. Gjendja ekzistuese – Pamja veriore, Planimetria, Prerja 1-1.

TAB. II



Xhamia në fshatin Vokopolë të Beratit. Gjendja ekzistuese – Pamja perëndimore, Prerja 2-2.

TAB. III

XHAMIA E VOKOPOLËS, FSHATI VOKOPOLË
KOMUNA TËRPAN - BERAT



PAMJA JUGORE



PAMJA LINDORE

Xhamia në fshatin Vokopolë të Beratit. Gjendja ekzistuese – Pamja jugore, lindore.

Dritan ÇOKU

THE MOSQUE IN THE VOKOPOLA VILLAGE OF BERAT

The village of Vokopola in the commune of Terpan is at the southernmost edge of the district of Berat. In this village, there is an old mosque which was turned for a short period into a school after War World II. Following the establishment of the agricultural cooperatives (1957) it was used as a storehouse for the agricultural products, and after the 1990s the mosque was used as a billiard saloon for a short period (two years). In the middle of the 1950s, the minaret of the mosque was destroyed. In November 2019, this object was declared a cultural asset: "Monument of Culture of the First Category".

The typology of the building is a hall with a dome, with a plan 6,92 x 6,92 m. It is like the mosques of Allajbegi, Velabisht and Permet. The mosque is composed of the prayer hall, the minaret, and the portico. Some traces of the base of the minaret are still visible today. Today the portico does not exist except for the remains of a wall along the northwestern corner of the mosque. Outside, the mosque has cubic volume and a dome on a drum.

It is difficult to date the old mosque of Vokopola as there is not source data or inscriptions. We can only do typological comparisons with other constructions in our country, regarding both the plan and the construction technique. Based on the proportions of the main elements, and the quite recent form of the volume and plan of the building (such as the shape of the drum, the construction technique and the interior), which are like the Mosques of Permet, we assume that the mosque might belong to the XVII century.

The mosque of Vokopola should undergo restorative interventions soon, which would prevent on time the potential deep degradation and improve the condition of this monument with historical and cultural values, making it functional for Muslim believers, and a durable asset for cultural heritage and tourism.

Mariglen MESHINI
Kriledjan ÇIPA
Arjol PORJA
Dorina GJERGJI
Ela MIZIRI

RAPORTI PARAPRAK I GËRMIMEVE ARKEOLOGJIKE NË AMANTIA GJATË VITIT 2020

Si rrjedhojë e një vale aktivitetesh klandestine dhe aktesh të pa përgjegjshme që prekën varrezën antike të parkut arkeologjik të Amantias[1], Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në I.K.T.K dhe Sektori i Parqeve Arkeologjike në D.R.T.K-Vlorë realizuan dy fushata gërmimesh arkeologjike shpëtimi përgjatë verës dhe vjeshtës së vitit 2020. Në fushatën e parë që zgjati rreth 1 muaj (nga fundi i muajit Korrik dhe deri në fundin e muajit Gusht) ndërhyrjet arkeologjike u përqendruan në nekropolin verilindor të Amantias, ndërsa në fushatën e dytë që zgjati rreth një javë (në muajin Nëntor) ku gërmimet u realizuan edhe në zonën e akropolit. Sipas katalogut të varreve të realizuar nga D.R.T.K-Vlorë ndërhyrjet arkeologjike prekën varret nr. 9, 16, 28 dhe 29 të nekropolit verilindor, si dhe varrin nr. 44 në zonën e akropolit. Disa nga varret i përkasin periudhës helenistike, ndërsa dy prej tyre kanë elemente datues të periudhës mesjetare (varri nr. 16, 44), periudhë e cila është shumë pak e njohur në Amantia. Në këtë raport të shkurtër po prezantojmë një informacion rreth metodologjisë së gërmimit arkeologjik, kontekseve arkeologjike, si dhe datimeve paraprake. Po ashtu, përshkrimet do të shoqërohen edhe me një informacion rreth masave paraprake të konservimit për zonat e gërmuara. Të gjitha objektet e rikuperuara nga gërmimi ju nënshtruan procesit të restaurimit dhe konservimit[2]. Në këtë raport po ndalemi vetëm në rezultatet e restaurimit të disa prej objekteve arkeologjike.

Varri monumental i dëmtuar nr. 9

Në muajin shtator të vitit 2018 u konstatua një varr i dëmtuar nga mjete mekanike (tipi ekskavator) në vendin e quajtur "Maja e Dorbrit", një kodër që ngrihet direkt mbi rrugën që lidh fshatrat Ploçë dhe Amonicë (Fig. 1, Tab.1). Ajo është maja e fundit me gjetje arkeologjike në veri të vargut kodrinor,

[1] Për një informacion përmbledhës mbi qytetin antik të Amantias shih Anamali 1972, f. 61-133.

[2] Pjesa më e madhe e objekteve të qeramikës si dhe objekteve metalike të rikuperuara nga varret, u trajtuan në laboratorin e restaurimit të projektit shqiptaro-zviceran të Orikumit nga Barbara G**ü**imil dhe ekipi i saj. Objektet e qeramikës së varrit nr. 29 janë trajtuar nga Klejdi Zguro me bashkëpunimin e Kiara Xhelili. Gjethet e një kurore prej ari, një terakotë, si dhe një enë prej qelqi e restauruar me prejardhje nga varret nr. 28 dhe 29, po i prezantojmë në këtë raport. Restaurimi i tyre është realizuar nga Barbara G**ü**imil. Falendrojmë të gjithë kolegët për punën e kryer në restaurimin e objekteve arkeologjike.



Fig. 1 Pamje e varrit të dëmtuar nr. 9 dhe qytetit antik të Amantias në sfond

ku gjenden të shpërndarë varret e nekropolit verilindor. Gjeomorfologjia e kodrës është argjilore-shtufore. Gjatë vëzhgimit sipërfaqësor u konstatuan masa dheu, gur shtufor natyror dhe blloqeve antik të punuar. Pjesa më e madhe e blloqeve antike që dalloheshin në sipërfaqe ishin hedhur jashtë gropës së gërmuar dhe gjendeshin të shpërndara në një grykë të vogël në lindje. Nga gropa e hapur me gërmim mekanik ruheshin vetëm profilet e deformuara të pjesës veriore dhe perëndimore. Në pjesën qendrore në dheun e gropës dallohej një përqendrim blloqesh antik, të cilët krijonin përshtypjen e një strukture të qëndrueshme. Për të verifikuar nëse kishim të bënim me një strukturë të tillë fillimisht gërmimi u përqendrua në këtë pjesë të kuadratit[3]. Nga gërmimi u evidentuan disa blloqe antikë (Fig. 2, Tab.1), të cilët nuk ishin pjesë e një strukture, por ishin përqendruar aty nga gërmimi i rrëmujshëm i ekskavatorit. Me siguri blloqet kanë qenë pjesë e muraturës së strukturës së shkatërruar. Pas heqjes dhe sistemimit të tyre në terrenin e sheshtë afër zonës

[3] Me anë të vendimit nr. 277, datë 17.10.2018 Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë miratoi relacionin e verifikimit të paraqitur nga A.SH.A dhe D.R.T.K-Vlorë, si dhe vendosi për gërmimin arkeologjik të shpëtimit.

së gërmimit, vijoi gërmimi i mëtejshëm i gjithë kuadratit. Gërmimi vijoi duke hequr fillimisht volumet e mëdha të dherave, si dhe blloqet e tjerë të shpërndarë brenda tij. Në dherat e hedhur, përveç blloqeve antikë u gjet shumë pak qeramikë e fragmentuar, por asnjë element diagnostik. Gërmimi i kuadratit arriti deri në tabanin natyror. Tabani përbëhej nga dheu i fortë shtufor dhe shkëmbinj shtufor. Brenda kuadratit të hapur nuk u gjet asnjë strukturë e ruajtur, pasi e gjithë struktura e varrit ishte shkatërruar nga gërmimi klandestin. Në kuadratin e gërmuar ruheshin vetëm profilet perëndimore dhe veriore (Fig. 3, 4), ndërsa pjesa lindore dhe jugore ishte hequr nga gërmimi i paautorizuar. Kuadrati arriti përmasat 12 x 11 m, ndërsa thellësia maksimale e tij arriti në 2,50 m. Në pjesën veriore jashtë kuadratit të gërmimit u gjet një strukturë muri me blloqe konglomerati dhe shtufi, që duhet t'i përkasin një varri[4] (Fig. 5). Muri kishte orientim veri-jug dhe ishte rreth 1.40 m i gjatë. Blloku i konglomeratit kishte përmasa 1 m x 40 cm x 20 cm, ndërsa blloku gëlqeror 39 cm x 40 cm x 15 cm. Pasi u realizua dokumentimi fotografik struktura u mbulua për ta mbrojtur nga ndonjë dëmtim i mundshëm. Të njëzetenjë blloqet antik të mbledhur nga zona e gërmuar dhe përreth



Fig. 3 Pamje e stratigrafisë në profilin perëndimor.



Fig. 5 Pamje e strukturës antike jashtë kuadratit.



Fig. 4 Pamje e stratigrafisë në profilin verior.



Fig. 6 Pamje e blloqeve antike të sistemuar në sheshin e kuadratit.

[4] Duke supozuar se struktura është pjesë e një varri e quajtëm varri nr. 31.

u sistemuan në sheshin e kuadratit (Fig. 6), si dhe u krye dokumentimi grafik e fotografik i tyre. Nuk mund të thuhet me siguri nëse të gjithë blloqet i përkasin varrit të dëmtuar. Është shumë e mundur që varri i dëmtuar nga gërmimet e paautorizuara të jetë varri i identifikuar si varri nr. 9 në katalogun e krijuar nga projekti i Institutit të Arkeologjisë[5], i cili korrespondon edhe me numrin e vendosur për këtë varr në katalogun e krijuar nga ana jonë. Përshkrimi në katalogun e Institutit të Arkeologjisë jep të dhëna të pakta për varrin, pasi ai ka qenë pak i dukshëm në sipërfaqe dhe mjaft i dëmtuar. Janë raportuar disa blloqe segmenti, të cilët kanë sugjeruar një varr monumental me mbulim qemeri[6]. Blloqet kanë forma dhe përmasa të ndryshme si kuadratike, drejtkëndore dhe disa të harkuar. Njëri prej tyre është bllok ortostati, ndërsa në një tjetër dallohet një paturë që ka shërbyer për puthitjen e blloqeve[7]. Pjesa më e madhe e tyre janë blloqe prej guri konglomerat, por ka edhe pak blloqe prej guri shtufor. Nga format dhe përmasat e blloqeve nuk është e mundur të krijohet një ide e tipologjisë së varrit të dëmtuar apo të elementeve të arkitekturës së tij, me përjashtim të faktit se varri ka qenë ndërtim me një formulim monumental.

Terreni i qëndrueshëm i "Majës së Dorbrit" është shfrytëzuar edhe për vendosjen e varreve të tjerë. Në pjesën veriore të majës, në sipërfaqe dallohen përqendrime të tjera blloqesh antik dhe strukturash me blloqe antik, të cilët tregojnë praninë e varreve të tjerë monumental. Gjithashtu në terren ka edhe prani varresh me arkitekturë të thjeshtë. Përveç materialit të konglomeratit për ndërtimin e këtyre varreve si elemente plotësuese janë përdorur edhe blloqe shtufor e gëlqeror. Të gjitha strukturat e varreve të tjera janë prekur nga aktiviteti klandestin. Dokumentimi i këtyre strukturave është i domosdoshëm, pasi rreziku i dëmtimit të tyre nga veprimtaria klandestine dhe aktet vandale është gjithnjë i pranishëm.

Varri nr. 16

Në muajin gusht të vitit 2019, gjatë inspektimeve në nekropolin verilindor u konstatua një varr me arkitekturë të thjeshtë i gërmuar nga individë të paautorizuar, që u katalogua si varri nr. 16. Varri me përmasa 2 m x 60 cm ishte ndërtuar me katër pllaka të mëdha guri shtufor, dy të gjata anash dhe dy të shkurtra. Orientimi i boshtit gjatësor ishte verilindje-jugperëndim. Gërmimi klandestin **në pjesën verilindore ishte realizuar në formën e një sondazhi, ndërsa në pjesën tjetër ishin hapur vetëm konturet e mureve anësore** (Fig. 7), duke e përgatitur **për një gërmim të plotë klandestin në të ardhmen.** Nga vëzhgimi i brendësisë së varrit dhe zonës përreth nuk pati gjetje arkeologjike. Gërmimi i shpëtimit dhe dokumentimi i varrit nr. 16 u realizua në muajin gusht të vitit 2020[8]. Për nxjerrjen e kontureve të varrit u hap një kuadrat përreth tij. Në shtresën e dheut (Shtresa 001) të kuadratit u gjetën fragmente qeramike të periudhës helenistike. Pas nxjerrjes së kontureve të varrit gërmimi vijoi në pjesën e brendshme të tij. Situata e depozitimeve në varr ishte komplekse, për shkak të ripërdorimit të varrit në periudha të ndryshme. Situata më e qartë u dokumentua në shtresën e fundit (Shtresa 005) pranë tabanit të varrit, ku dallohej një individ në pozicionin e tij fillestar (Fig. 8). Në tabanin e varrit në thellësinë 85 cm, pas heqjes së skeletit u gjet një vëth i tipit "në trajtë me vile rrushi" (Fig. 9), tipik për periudhën e mesjetës (shek. IX-X)[9]. Arkitektura e varrit dhe konteksti ku ndodhet mendojmë se i

[5] Buzo, Hobdari 2014, f. 26, Tab VII, 4, 5.

[6] Buzo, Hobdari 2014, f. 26.

[7] Blloqet kanë këto përmasa 50 x 40 x 39 cm, 80 x 53 x 46 cm, 48 x 45 x 50 cm, 47 x 47 x 48 cm, 80 x 46 x 33 cm, 73 x 48 x 36 cm.

[8] Vendim i K.K.T.K.M, Nr. 57, datë 19.02.2020.

[9] Falënderojmë koleget Etleva Nallbani dhe Sabina Veseli për sugjerimet rreth objektit.



Fig. 7 Varri nr. 16, në gjendje të dëmtuar nga gërmimet klandestine. Fig. 7 Varri nr. 16, në gjendje të dëmtuar nga gërmimet klandestine.



Fig. 8 Varri nr. 16, me ritin e varrimit in situ.

përket periudhës helenistike, ndërsa gjetjet dhe fazat e ripërdorimit i përkasin mesjetës. Për mbrojtjen e varrit nga dëmtime të tjera u realizua rimbulimi.

Varri monumental nr. 28

Ndodhet buzë rrugës që lidh fshatin Ploçë me fshatin Amonicë, përballë hyrjes së parku arkeologjik të Amantias. Varri është pjesë e nekropolit verilindor. Prania e strukturave arkeologjike dhe varreve në



Fig. 9 Pamje e vëthit të gjetur në varrin nr. 16 (Foto B. Güimil).

këtë zonë të nekropolit është bërë e njohur gjatë punimeve për rikonstruksionin e rrugës në vitin 2013. Nga punimet në profilin verilindor të rrugës kishin dalë në sipërfaqe një numër i madh blloqesh antike, si dhe muret anësore të disa varreve me tulla, njëri prej të cilëve (varri nr. 1) u dokumentua nga D.R.T.K-Vlorë në vitin 2019[10]. Varri nr.28, u zbulua nga ndërhyrjet klandestine në fillim të vitit 2020. Klandestinët kishin spostuar një nga blloqet anësor të murit (Fig. 10, Tab.1). Në terren gjendeshin fragmente qeramike dhe eshtrash. Për të kuptuar shtrirjen e varrit në pjesën e gërmuar nga klandestinët si dhe stratigrafinë e depozitimeve kulturore u hap një kuadrat me përmasa 2 x 2,50 m[11] (Fig. 11), ku dolën blloqet e këndit jugperëndimor të varrit, si dhe një shtresë tullash (Shtresa 008) në brendësi të kuadratit. Me thellimin e tij deri në taban doli një shtresë (Shtresa 009) me qeramikë dhe eshtra (Fig. 12). Gjithashtu në këtë shtresë u gjet edhe një objekt ari. Pasi u bë e qartë se kemi të bëjmë me një varr të periudhës helenistike me mure me blloqe guri dhe strukturë tullash nga brenda, nisi zgjerimi i kuadratit për nxjerrjen e kontureve të varrit. Gjatë

[10] Çipa 2020, f. 1-62.

[11] Gërmimi arkeologjik u realizua në zbatim të vendimit të K.K.T.K.M Nr. 203, datë 02.07.2020.



Fig. 11 Pamje e sondazhit.



Fig. 12 Pamje e shtresës arkeologjike 009.

zgjerimit të kudratit në pjesën lindore në profil doli një varr me muraturë tulle i mbuluar me pllaka guri (varri nr. 29). Nga varri nr. 28 doli radha e sipërme e blloqeve (Fig. 13, Tab.1). Krahas strukturës kuadratike të brendshme, doli një strukturë e dytë në formë L-je nga veriperëndimi, një bllok i veçuar në veriperëndim, si dhe një bllok i veçuar në lindje i identifikuar që në hapjen e sondazhit. Në pjesën e brendshme të varrit u identifikua një shtresë e rrëzuar me tulla harkore dhe drejtkëndore, si dhe në pjesën jugore një shtresë me gurë të madhësive mesatare. Nga ana perëndimore gërmimi vijoi deri në bllokun e poshtëm të mureve. Nga jugu, pas heqjes së shtresës së gurëve u nxor hyrja dhe muri jugor. Varri ka planimetri drejtkëndore me përmasa 2.88 x 3.84 m, me thellësi maksimale nga brenda deri në 1 m. Në pjesën e brendshme të varrit pasi u hoq shtresa e tullave të rrëzuara doli shtresa e tabanit (Shtresa 009), ku u vu re një përqendrim i materialeve në këndet jugperëndimore dhe veriperëndimore (Fig. 14, Tab.1). Gjithashtu *in situ* në këndin verilindor u gjetën mbetjet e një strukture tullash, që me siguri i përket një varri me mur tulle brenda strukturës me blloqe guri. Materiali kockor ishte shumë i pakët. Inventari shoqërues i varrimit ishte mjaft i pasur dhe përbëhej nga objekte qeramike, objekte metalike, si dhe një objekt ari. Me përjashtim të 5 kandilave të ruajtur pothuajse të plotë dhe një unguentari, pjesa tjetër e qeramikës ishte e fragmentuar, dhe jo gjithmonë ishte e mundur të kuptoheshin format specifike. Mbi bazën e elementëve morfologjik u identifikuan rreth 5 forma të mbyllura me vernik pa ngjyrë dhe me shenja pikturimi tashmë të zbehur. Gjithashtu nuk mungonin as enët e përdorimit të përditshëm. Qeramika me vernik të zi përfaqësohej nga një pjatë, një stamnos dhe fundi i një ene të mbyllur, ndoshta një pelike. Kandilat i përkasin kryesisht tipit Broneer XII dhe Broneer XI[12]. Gjithashtu pjesë e inventarit ishin disa elemente dekorative të koroplastikës. Nga objektet e restauruara veçojmë një terakotë, si dhe gjethet prej floriri të një kurore (Fig. 15, 16). Një pjesë e mirë e objekteve metalike prej bronzi dhe hekuri janë të fragmentuara. Objektet më të konservuara janë gozhdët, pjesë bizhuterish prej bronzi, si dhe maja e një shigjete. U gjetën 8 monedha bronzi, shumica e të cilave janë prerje të Amantias dhe Epirit. Gjithashtu, nuk mungonin as objekte të lojërave antike siç janë astragalët dhe gurët e lojës. Pas rikuperimit të materialit arkeologjik, duke qenë se tabani shtufor i

[12] Falenderojmë kolegun italian Carlo de Mitri për vlerësimin dhe sugjerimet e dhëna mbi materialin e qeramikës së varrit nr. 28 dhe 29.



Fig. 15 Terakota e restauruar.



Fig. 16 Gjethe prej ari të restauruara.

tij ishte shumë i fortë për t'u gërmuar deri në themelin e varrit, u krye një sondazh në këndin juglindor për verifikimin e lartësisë së murit anësor nga brenda (Fig. 17). Si masë paraprake konservimi, për drenazhimin e ujërave u thellua një kanal buzë rrugës automobilistike nga jugu, si dhe u rimbush me dhè zona e gërmuar deri në lartësinë e themelit të murit. Gjithashtu, u rivendos në vendin e tij në këndin jugor të murit perëndimor blloku i nxjerrë nga klandestinët.

Varri nr. 28 i përket varreve monumentale të tipit Π-shape me strukturë blloqesh guri, të cilat inkuadrojnë brenda tyre varre ciste me muraturë tulle (Fig. 18, Tab.1, Fig.19). Përfaqësuesi më i njohur në Amantia i këtij tipi është i quajturi "Varri i Çifutit"[13]. Duke u nisur nga tipologjia e varrit dhe datimi paraprak i objekteve, si një datim të përgjithshëm për varrin nr. 28 propozojmë shek. III p.Kr.

Varri nr. 29

Në profilin lindor të kuadratit, gjatë gërmimit të varrit monumental nr. 28 doli muri perëndimor dhe një pjesë e pllakave të mbulimit të një varri cist, i cili morri nr. 29 (Fig. 20, Tab.1). Distanca midis dy varreve sigurohej nga disa gurë me përmasa mesatare të vendosur në hapësirën midis mureve anësor të tyre (shih: Fig. 19). Gjatë procesit të gërmimit të varrit 28 muri anësor i varrit nr. 29 u dëmtua nga gërmues klandestinë, për këtë arsye në nëntor të vitit 2020 varri ju nënshtrua gërmimit arkeologjik dhe dokumentimit[14]. Fillimisht u hoqën shtresat e sipërme kulturore (Shtresa nr. 14 dhe 15). Varri ishte i tipit me muraturë tulle i mbuluar me tre pllaka guri. Orientimi i boshtit gjatësor ishte lindje-perëndim. Ruheshin vetëm dy pllakat e mbulimit pasi njëra prej tyre kishte rënë brenda varrit. Pas dokumentimit të mbulesës gërmimi u përqendrua në pjesën e brendshme të

[13] Ceka 1975, f. 37; Buzo, Hobdari 2014, f. 32; Shih gjithashtu raportin Çipa 2020, f. 24-34.
[14] Në zbatim të vendimit të K.K.T.K.M Nr. 280, datë 17.08.2020.



Fig. 17 Pamje e sondazhit në këndin jugperëndimor.



Fig. 19 Planvendosje dhe planimetri e varreve 28 dhe 29.

varrit. Riti i varrimit ishte me trupvënie me një individ të rritur. Trupi ishte i shtrirë dhe koka e vendosur nga jugu (Fig. 21, Tab.1). Inventari i varrit ishte shumë i pasur me objekte. Objektet gjendeshin të shpërndara në të gjithë gjatësinë e varrit edhe poshtë pllakës së rënë brenda gropës. Në një pjesë të objekteve të qeramikës që ruheshin në gjendje të mirë ndërhyrjet për restaurimin e tyre ishin minimale, ndërsa në objektet e fragmentuara u realizua restaurim i plotë. Inventari i objekteve të qeramikës përbëhet nga piksida, *kantar*ë, *unguentar*ë, *lagynos, pjat*ë, *skyfos, lekythos*, amfora dhe kandil. Pjesa më e madhe e tyre i përket shek. III-II p.Kr. Inventari i objekteve metalike përbëhet nga 11 monedha bronzi prerje të Amantias dhe Epirit, si dhe gozhda hekuri. Objekti më i veçantë i inventarit është një kupë prej qelqi e realizuar me spirale prej fijesh ari, me fund sferik (Fig. 22). Për pjesën e buzës është përdorur qelq blu, ndërsa për pjesën tjetër qelq transparent. Përgjithësisht këto enë luksi datojnë në periudhën e vonë helenistike shek. II p.Kr, por megjithatë datimi dhe një studim më i thelluar i origjinës dhe teknikës së prodhimit do kryhet në të ardhmen. Ena u gjet tërësisht e thyer dhe e fragmentuar në pjesën e kraharorit të individit të varrosur dhe restaurimi i saj u bë pothuajse i plotë. Pjesë e inventarit ishin edhe 4 astragalë. Kuadrati i gërmuar është 3,40 m i gjatë, 1,48 m i gjerë dhe 1,74 m i thellë. Përmasat maksimale të varrit janë 2,68 cm x 1,23 cm, me lartësi maksimale të mureve anësore 80 cm[15]. Tipologjia dhe inventari i varrit sugjeron një datim relativ midis shek III dhe II p.Kr. Ky tip varri është mjaft i përhapur në nekropolin

[15] Për shkak të ekspozimit ndaj agjentëve atmosferik tullat dëmtohen (thërmohen apo shpërbëhen), duke shkaktuar rrënimin gradual të varrit. Për konsolidimin e strukturave të varrit nr. 29, por dhe varrit monumental nr. 28 D.R.T.K-Vlorë hartoi një projekt restaurimi dhe konservimi, i cili tashmë ka marrë miratimin e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (Vendim Nr. 130, datë 12.03.2021) dhe pritet të zbatohet në vitin 2022.



Fig. 22 Ena prej qelqi e gjetur në varrin nr. 29, pas restaurimit (Foto Carlo de Mitri).



Fig. 23 Pamje e varrit nr. 44 pranë hyrjes me mbulim qemeri.

e Amantias, të Orikumit dhe Apollonisë, ku gjenden edhe ekzemplarët më të hershëm[16].

Varri nr.44

Varri nr. 44 ndodhet në pjesën e akropolit antik, ngjitur me hyrjen me mbulim qemeri (Fig. 23). Varri ishte gërmuar nga klandestinët në pjesën perëndimore. Për nxjerrjen e plotë të kontureve të varrit dhe



Fig. 24 Pamje e kontekstit arkeologjik në varrin nr. 44.

dokumentimin e arkitekturës së tij u hap një kuadrat me përmasa 1 x 2 m, me thellësi maksimale 60 cm[17]. Pas hapjes së kuadratit u dokumentua mbulesa e varrit me katër rasa guri. Pas heqjes së pllakave nisi gërmimi i gropës së varrit. Varrimi ishte realizuar me trupvënie, me kokën nga perëndimi (Fig. 24). Nga ndërhyrjet klandestine ishin lëvizur vetëm gjymtyrët e sipërme dhe pjesa e kafkës. Si inventar shoqërues u gjetën tre monedha argjendi. Monedhat dhe arkitektura e varrit sugjerojnë për një datim rreth shek. XII-XIII. Varri ishte rreth 1.80 m i gjatë, 60 cm i gjerë dhe 40 cm i thellë. Pas përfundimit të dokumentimit varri u rimbulua.

16 Për një trajtim të tipologjisë së varreve të periudhës helenistike me muraturë tulle shih: Çipa, Tota 2018, f. 460-476.

17 Gërmimi arkeologjik i shpëtimit u realizua në zbatim të vendimit të K.K.T.K.M Nr. 381, datë 06.11.2020.

Mariglen MESHINI
Kriledjan ÇIPA
Arjol PORJA
Dorina GJERGJI
Ela MIZIRI

PRELIMINARY REPORT OF ARCHEOLOGICAL EXCAVATIONS IN AMANTIA DURING 2020

As a result of a series of clandestine activities, treasure hunting and vandal acts that affect the ancient cemetery of the archaeological park of Amantia, the Directorate of Archaeological Service at the National Institute of Cultural Heritage (IKTK) in cooperation with the Sector of Archaeological Parks at the Regional Directorate of Cultural Heritage of Vlora (DRTK) organized two archaeological rescue excavations during the summer and autumn of 2020. In the first excavation which lasted about one month (from the end of July till the end of August) archaeological interventions were concentrated in the northeastern part of Necropolis in Amantia, while the second which lasted about a week (in November), excavations were also carried out in the Acropolis area. According to the graves catalog realized by D.R.T.K.-Vlora, archaeological excavations affect graves no. 9, 16, 28, 29 of the northeastern part of Necropolis, as well as grave no. 44 in the Acropolis Area. Some of the tombs are dated back from Hellenistic period, while two of them have dating elements from the medieval period (tomb no. 16, 44), a period which is very little known in Amantia. In this short report we are presenting information about the methodology of archaeological excavation, archaeological contexts, as well as preliminary dating. The descriptions will be also accompanied by information on precautionary measures for the excavated area. All the objects recovered during the excavations underwent the restoration and conservation process.

Frederik STAMATI
Migena DIBRA

MBI KONSERVIMIN E FLAMURIT TË KONGRESIT TË LUSHNJES

Pak histori

Në Fondin Etnografik me materialet Tekstil-Lesh të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit, ruhet ndër të tjera edhe flamuri i Kongresit të Lushnjës (Fig. 1).

Ky flamur qëndroi në sallën e shtëpisë muze, ku zhvilloi punimet Kongresi, nga data 21 deri më 31 janar 1920. Flamurin e çoi në mjediset e sallës Nënprefekti i Lushnjës Veli Vasjari[1]. Më vonë, por që nuk shihet se kur, ai e mori dhe e ruajti, derisa në vitin 1928 e dhuroi për Muzeun Kombëtar[2].

Në vitin 1946 - 47 flamuri kaloi në arkivat e Institutit të Shkencave dhe më vonë, në bazë të organizimeve të tjera, në fondin etnografik të Institutit të Histori Gjuhësisë në vartësi të Universitetit Shtetëror të Tiranës, në fondin etnografik të Institutit të Kulturës Popullore në varësi të Akademisë së Shkencave, në fondin etnografik të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe së fundmi në po këtë Institut, në varësi të Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Gjendja e konservimit

Vëzhgimi me sy të lirë (Fig. 2).

Flamuri ka dimensionet 140 cm me 70 cm.

Nga të katër anët ka një palosje prej rreth 9-10 mm, e cila është qepur me makinë qepëse, duke përdorur pe të zi.

Në qendër, nga të dyja anët, është shqiponja e zezë dykrenore, në të cilën dallohen sytë e bardhë. Shqiponja dhe sytë e saj janë të montuara mbi pëlhurën e kuqe. Fillimisht mbi pëlhurën bazë të flamurit janë "fiksuar" sytë, të realizuar me një pëlhurë të bardhë. Pastaj mbi pëlhurën bazë është vendosur një pëlhurë e zezë e mëndafshtë, e mbi të një model shqiponje. Shqiponja është qepur njëherësh nga të dyja anët e flamurit me anë të një makine qepëse. Gjatë qepjes ka ndodhur një tërheqje e lehtë e pëlhurës së zezë, e cila formon një rrudhë, duke i dhënë reliev shqiponjës. Vendi i syve është hapur, duke prerë me gërshërë pëlhurën e zezë.

Në njërën anë të flamurit janë montuar tre hallka metalike. Për lidhjen e hallkave është përdorur si përforcuese një copë e zezë, e qepur pa kujdes mbi pëlhurën e kuqe të flamurit. Mendojmë se hallkat janë shtuar më vonë se koha kur është përgatitur flamuri.

Nën shqiponjë, nga të dyja anët është vula, e vendosur në Lushnjë më datë 20 janar 1920, e cila siguron vërtetësinë e flamurit historik.

Nga vëzhgimi me sy të lirë konstatohet se pëlhura e kuqe është dëmtuar shumë rëndë, duke pësuar



Fig. 1. Flamuri i Kongresit të Lushnjës, pas konservimit



Fig. 2. Flamuri i Kongresit të Lushnjës në çastin e identifikimit.

grisje në drejtimin e bazës, pra, duke u këputur përgjithësisht filli i indit (Fig. 3). Pëlhura e zezë nuk është dëmtuar fare. Edhe pëlhura e kuqe nën shqiponjë nuk duket e dëmtuar.

Duke shqyrtuar dëmtimet e pëlhurës vërejmë se dëmtimi është në anën e kundërt të hallkave. Nga vëzhgimet e shumë flamujve konstatohet se në flamuj dëmtohet më rëndë ana e kundërt e fiksimit të flamurit, pra ajo që valëvitet më tepër nga era dhe sa më e fuqishme era, aq më i madh është dëmtimi. Nga kjo arrijmë në përfundimin se ky flamur, veç përdorimit të mundshëm në sallën ku zhvilloi punimet Kongresi, është valëvitur patjetër edhe në ndonjë shtizë, ku është ngritur me litar, e ku ka qëndruar disa ditë. Aty pëlhura e flamurit ka marrë goditjen e parë dëmtuese në strukturën e saj, por ende e pagrisur.

Gjatë palosjes, apo shpalosjes, pëlhura e kuqe lëshon pluhur të kuq, që vjen nga dëmtimi i fibrave të tekstilit.

Në të tri hallkat duken njolla ndryshku.

Lloji i fibrave.

Analizat me mikroskop biologjik treguan se pëlhura e kuqe e flamurit dhe ajo e zeza e shqiponjës janë prej mëndafshi natyror.

Përbërja kimike

Analizat me XRF, (Fluoreshencë e rrezeve X), të kryera në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar[3], treguan se pëlhura e kuqe e mëndafshtë, përmban elementët Sn (kallaj), Si (silic), P (fosfor), Ca (kalçium) dhe K (kalium).

Shqyrtimi i pëlhurës së kuqe me anë të aparaturave që përdoren për mamografi[4], tregoi një imprenjim të dukshëm me elementë metalikë të shtuar në mëndafsh.

Analizat e pëlhurës së zezë të mëndafshtë, të kryera me anë të SEM, (Scaning Electron Microscopy), në Laboratorin e Kriminalistikës[5], treguan mungesën e elementëve metalikë të shtuar.

Analizat e ngjyruesit të kuq.

Analizat[6] treguan se ngjyruesi i përdorur është ngjyrues sintetik, si më poshtë:

-Basic red 1, (rhodamine 6G)
-Basic red 1 derivative
-Një ngjyrues i kuq i panjohur
-Basic violet 10, (rhodamine B)
- Acid red 9, (karminë për mëndafsh, ose silk scarlet).
- Basic violet 10 derivative

Qëndrueshmëria në ujë.

Ngjyra e kuqe e pëlhurës bazë dhe ajo e pëlhurës së zezë të shqiponjës, janë të paqëndrueshme në banjë ujore.

Aciditeti.

pH në banjën ujore të pëlhurës së kuqe[7] është 5.25,



a. me efekt INDI

B. me efekt BAZE

Thurje Atlas jo e rregullt



Fig. 3. Dëmtimi i pëlhurës së mëndafshtë. Pamje e pjesshme.



Fig. 4. Dëmtimi i fibrave të mëndafshit, të pëlhurës së flamurit të Kongresit të Lushnjës. Foto e marrë me anë të SEM.

gjë që duhet të vijë nga dekompozimi i materialit proteinik i fillit të mëndafshit, ose nga proceset e ngjyrimit.

Përcaktimi i strukturës së pëlhurës së kuqe.

U krye në Fakultetin e inxhinierisë tekstile[8] dhe paraqitet në vizatimin e mëposhtëm:

Nga pikëpamja e ndërhyrjeve konservuese, kjo strukturë sugjeron lëvizjet e penelave, ose duarve mbi pëlhurën e mëndafshtë, nga e majta në të djathtë, ose e kundërta.

Arsyeja e dëmtimit të pëlhurës së mëndafshtë

Në bazë të analizave rezulton se pëlhura e kuqe bën pjesë në mëndafshet e rënduar[9], të trajtuar me kimikate, për të rritur peshën dhe shtuar fitimet. Rëndimi në këtë rast është realizuar me shtimin e kallajit dhe të silicit, duke u bërë shkak për prishjen më të rëndë të mëndafsheve. Gjatë këtij trajtimi, siç është vërtetuar me analizën e XRD, (X Rays Difraction), në mëndafsh krijohet minerali kristalin $3SiO_2.SnO_2$, i cili e brishtëzon fibrën e mëndafshit, duke e bërë të thyeshme.

Fotot e mara me anë të SEM, (Scaning Electron Microscopy).

U bënë në Institutin "Jožef Stefan" të Ljubljanës nga prof. dr. Maja Remskar dhe tregojnë më së miri situatën në të cilën ndodhet pëlhura e mëndafshtë dhe dëmtimin e saj[10] (Fig. 4). Gjithashtu ato tregojnë për një depozitim pluhuri mbi fibra.

Shqyrtimi i hallkave.

Shqyrtimi optik në stereomikroskop tregoi se hallkat janë prej hekuri të zinguar.

Trajtimi konservues.

1. Trajtimi i hallkave. Fillimisht u pastruan mekanikisht nga depozitimi sipërfaqësor i ndryshkut. Pastaj u trajtuan me një lëndë kompleksante deri në largimin e plotë të ndryshkut. Mbas shpëlarjes me ujë të distiluar dhe tharjes me aceton, hallkat u llakuan me Paraloid B 72 të tretur në aceton me koncentrimin 5%.
2. Flamuri u zhyt në një banjë me ujë të demineralizuar për të përmirësuar brishtësinë e fibrave dhe për të larguar pluhurat dhe papastërtitë e tjera të depozituara. Trajtimi u bë për një periudhë të shkurtër kohore, jo më shumë se 10 minuta. Mbas këtij trajtimi ngjyra e kuqe "u freskua".
3. U pozicionuan të gjitha pjesët e dëmtuara të pëlhurës, duke i mbajtur nga mbrapa të lidhura me

shirita tekstili të hollë prej mëndafshi të ngjyrosur në një ton të përafërt me pëlhurën e flamurit. Ngjitja u bë me niseshte gruri të modifikuar në mjedis acid klorhidrik[11].

4. Në vendet ku mungon pëlhura origjinale u vendos pëlhurë mëndafshi e ngjyer një ton më poshtë se origjinali.

5. Flamurit i u ngjit nga mbrapa një pëlhurë e hollë mëndafshi, e ngjyer në një ton të përshtatshëm.

Pëlhurat e reja prej mëndafshi të përdorura për plotësimin e pjesëve që mungojnë dhe për hastarosjen e plotë, u kontrolluan për praninë e elementëve të tjerë dhe rezultuan të jenë mëndafsh pa shtesa.

Mbas tharjes vihet re një rrudhosje e lehtë e pëlhurës origjinale, e cila mendojmë se vjen nga koeficientet e ndryshëm të bymimit dhe tkurrjes së mëndafshit të parënduar dhe mëndafshit të rënduar dhe me strukturë të ndryshuar.

Lidhur me këtë mendohet që në periudhën e nxehtë të vitit të bëhet një shtrirje e detyruar nën xham dhe me pesha.

Rekomandime për ruajtjen në fondin etnografik:

Rekomandohet që flamuri të ruhet në një mjedis arkivor që plotëson kërkesat e mëposhtme:

- Të jetë një mjedis pa pluhura,
- Të jetë një mjedis i pandotur nga produktet e shpërbërjes së materialit drusor, ose me bazë lëndën e parë prej druri,
-Të jetë një mjedis ku ndotja atmosferike të mos kalojë kufijtë prej 5µgram/m^3 të oksideve të squfurit dhe oksideve të azotit.
- Të jetë një mjedis me lagështi relative rreth 55% dhe temperaturë të ulët, e jo më shumë se 13^0 C, në bazë të parametrave që sugjerohen për ruajtjen e tekstileve.
- Të ruhet I shtrirë në një dollap metalik, i bërë prej materiali të pandryshkshëm.
- Të preket me doreza pambuku, ose doreza kirurgjikale.

Rekomandime për ekspozim

- Të ekspozohet me raste dhe në periudha të shkurtra kohore, në mjedis me ndriçim me llamba tungsten, në një nivel 50 lux, me rrezeatim UV deri në 75 µwatt/lumen.
- Të ekspozohet në një mjedis me temperaturë deri në 18° C, me dinamikë plus-minus 1^0 C në ditë.
- Të ekspozohet në një mjedis me lagështi relative 55%, me luhatje ditore plus - minus 5%
- Të ekspozohet në një mjedis me ndotje atmosferike prej jo me shume se 5 µgr/m^3 okside të squfurit dhe të azotit.
- Të ekspozohet në një mjedis pa pluhura dhe blozë.
- Të ekspozohet në një mjedis pa filtrim të ajrit me anë të elektrofiltrave.
- Të ekspozohet në një vitrinë të mbyllur me xham, ku hapësira flamur-xham të mos jetë më pak se 15 cm.

Rekomandime për transport

- Të pështillet rulo në një tub plastik prej polipropileni, me diametër 12 cm.
- Gjatë mbështjelljes të përdoret fletë ndarëse Melinex.
- Të mbështillet me një këllëf prej kambriku të pazbardhur.

Referencat

1. Ferro, N. “Lushnje, ditët e Kongresit”, *DITA*, 22. I. 2016
2. AQSH. Fondi 195. Viti 1930. Dosja 122. Faqe 20 – 29
3. Analizat me XRF u kryen nga Prof. Dr. Niko Civici në laboratorët e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar.
4. Shqyrtimi me aparaturat që përdoren për kryerjen e mamografisë u bë në Qendrën Orthodhokse Diagnostikuese “UNGJILLIZIMI” në Tiranë.
5. Analizat me SEM u kryen tek Instituti i Policisë Shkencore në drejtorinë e

Përgjithshme të policisë së Shtetit, nga msc. Nikolin Duraj, fizikan.
6. Analizat e ngjyruesit të kuq u bënë nga Ina VanderBerghe, në Textile Research Lab, Royal Institute for Cultutal Heritage (KIK-IRPA). Brussels, Belgium.
7. Matja e pH u bë nga Dr. Anisa Dhroso në laboratoret e Departamentit të Kimisë Industriale të Fakultetit të Shkencave Natyrore.
8. Analiza e strukturës tekstil u krye nga msc. Riana Hida, pedagoge në Fakultetin e Inxhinierisë Tekstile në Universitetin Politeknik.
9. Marei Hacke, *Reviews in Conservation,* number 9, 2008
10. Falenderojmë Prof. Maja Remskar për fotot e marra me anë të SEM në laboratorët e Institutit "Jozef Stefan" të Ljubljanës si dhe prof. Šiga Šmith, për ndihmesën e dhënë.
11. G. Van Stene and L. Masschelein – Keiner. *Modified starch for conservation purposes. Studies in Conservation.* Volume 25. Nr 2. May, 1980.

Frederik STAMATI
Migena DIBRA

ON THE CONSERVATION OF THE FLAG OF LUSHNJA CONGRESS

The flag of the Lushnja Congress is kept in the Ethnographic Fund of the Institute of Cultural Anthropology and Art Studies. The state of its storage was very bad. The damage has come gradually by itself.

Many analyzes were done to determine the path of conservative intervention.

XRF methods were used to identify the elements present. The type of fibers and their damage were determined by optical microscopy. By means of SEM, the structure of the fibers and the degree of mechanical damage were seen. By chromatographic methods, the dyes used were determined. The pH of the fabric was also determined, as well as the type of fabric knitting, and the durability during washing. The analysis determined that the cause of the damage of the silk came because it was aggravated from the tin and silicon compounds, which lead to the self-degradation of silk.

For conservation, the method of silk priming with modified starch adhesive was used. The result was quite good.

At the end of the article, the preservation storage and exposure parameters are given.



FORTIFIKIMET E ANTIKITETIT TË VONË DHE TË MESJETËS NË SHQIPËRI

QYTETE, KALA, FORTESA, KËSHTJELLA

Gjerak Karaiskaj

Prof. Dr. Aleksandër MEKSI

GJERAK KARAISKAJ, *FORTIFIKIMET E ANTIKITETIT TË VONË DHE MESJETËS NË SHQIPËRI, QYTETE, KALA, KËSHTJELLA,* Tiranë 2021

Recension

Monografia që përmbledh fortifikimet e antikitetit të vonë dhe të mesjetës, deri në periudhën e pashallëqeve të mëdha shqiptare i Prof. Dr. Gjerak Karaiskajt, i botuar fillimisht në Gjermani në vitin 2010, është rezultat i një pune dhjetëravjeçare të autorit, gjatë veprimtarisë së tij restauruese dhe shkencore në Institutin e Monumenteve të Kulturës. Një bursë njëvjeçare e sponsorizuar nga fondacioni Gerta Henkel, e fituar në vitin 1992 me konkurs ndërkombëtar, në saj të rezultateve shkencore të arritura prej tij, e cila u akordohet profesorëve të huaj të shquar, për të kryer studime dhe publikime, që do t'iu shërbejnë studentëve gjermanë, i dha mundësi ta zgjerojë dhe ta thellojë këtë temë nëpërmjet shfrytëzimit të një literature më të pasur krahasuese, duke i parë këto ndërtime në një kuadër më të gjerë, që përfshijnë Perandorinë romake dhe bizantinë për periudhën e vonë antike dhe Perandorinë bizantine dhe Evropën perëndimore e lindore për periudhën mesjetare. Nëpërmjet krahasimeve të shumta dhe shfrytëzimit të burimeve historike përcaktohet vendi që zënë fortifikimet në Shqipëri në kuadrin e perandorive të mëdha, marrëdhëniet dhe ndikimet reciproke në rrethana dhe periudha të caktuara historike.

Për periudhën e antikitetit të vonë, janë shfrytëzuar burimet historike të kohës dhe në mënyrë të veçantë dy veprat themelore të Prokopit nga Cesarea, historianit të perandorit Justinian I, "*Mbi ndërtimet*" dhe "*Lufta gotike* "ku shfrytëzohen jo vetëm të gjitha burimet që kanë lidhje të drejtpërdrejta apo të tërthorta me territorin e Shqipërisë, por hetohen edhe fortifikime të tjera të Perandorisë Romako-bizantine në prizmin e të dhënave të përfituara nga këto burime, por duke i parë ato me syrin e specialistit të kësaj fushe studimore.

Për sa i përket periudhës mesjetare në fushën e ndërtimeve mbrojtëse, një periudhë pak e prekur nga studiuesit në territorin e Ballkanit, por edhe në përgjithësi në territoret ku shtrihej Perandoria bizantine, për shkak të vështirësive që paraqet kjo periudhë në zbërthimin e fazave të ndërtimit, por edhe për mungesën, shpesh herë të plotë të burimeve historike, autorit i është dashur të bëjë një punë skrupuloze në terren dhe krahasime të shumta të elementeve ndërtimore nga vende të ndryshme të Perandorisë bizantine dhe gjithashtu të dallojë në to ndikimet perëndimore, sidomos pas shfaqjes së armës së artilerisë me barut. Nga ana tjetër ai sheh shumë huazime të elementeve përbërës të fortifikimeve, të çuara në Europën perëndimore dhe qendrore nga kryqtarët, që e kanë origjinën në Perandorinë bizantine, ku shtrihej edhe territori

i Shqipërisë dhe jo vetëm në vendet arabe siç është menduar së shumti. Në territoret që ndikuan drejtpërdrejt në përhapjen e teknikave të përparuara të fortifikimeve mesjetare në Europë bën pjesë edhe territori shqiptar, me qytetet e tija bregdetare, nga më të rëndësishmet në brigjet perëndimore të Perandorinë bizantine.

Monografia përbëhet prej tetë kapitujsh që trajtojnë këtë gjini monumentesh, që janë të shtrira në gjithë territorin e vendit tonë nga Antikiteti i Vonë e gjatë gjithë Mesjetës (përfshirë shek. XIX) së bashku me karakteristikat dhe elementët e tyre thelbësorë. Këto kapituj trajtojnë:

Qytete, kështjella dhe ndërtime të tjera mbrojtëse, funksionin, të gjitha format dhe tipologjia e tyre, si dhe në mënyrë të hollësishme të gjithë elementët e ndërtimit në shumëllojshmërinë e tyre, për të tre periudhat: Antikitetit i Vonë, Mesjeta dhe ato të shekujve XV-XIX. Nuk janë lënë pa trajtuar dhe kontributet, specifikat dhe përdorimi i tyre për periudha historike të veçanta.

Një vend të veçantë zë paraqitja e operacioneve kundra tyre (rrethimet) dhe armëve të përdorura gjatë shekujve.

Studimi i detajuar i fortifikimeve në territorin e Shqipërisë lindi dhe si një nevojë e domosdoshme në shërbim të hartimit të projekteve të restaurimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së substancës historike të tyre, për sot dhe për brezat që do të vijnë. Për këtë autorit i është dashur të studiojë në veçanti çdo element ndërtimor të tyre, duke filluar nga teknika e ndërtimit, kullat, portat, frëngjitë, erkerët etj., duke zbuluar origjinën dhe evolucionin e tyre në kohë. Në këtë kuptim, studimi është një manual, që u shërben jo vetëm arkeologëve në kërkimet e ardhshme më të thelluara të këtyre objekteve të shoqëruara me gërmime arkeologjike sistematike, por edhe restauratorëve, në përballjen me objektin e tyre të restaurimit, duke e kuptuar dhe interpretuar atë në një nivel më të lartë shkencor.

Veç kësaj, libri mbyllet me një katalog me 51 fortifikime mesjetare, të shoqëruara me planimetritë e tyre, ku përfshihen pothuajse të gjitha fortifikimet mesjetare më të rëndësishme të Shqipërisë. Për datimin e tyre janë shfrytëzuar të gjitha burimet historike të njohura nga autori dhe të dhënat teknike. Kjo pjesë edhe pse i trajton këto fortifikime në mënyrë koncize, duke iu përmbajtur qëllimit të librit, është me interes edhe për çdo lexues të thjeshtë. Monografisë nuk i mungojnë dhe të dhënat e detyrueshme, si referencat dhe bibliografia e përdorur.

Libri përbëhet prej 276 faqesh dhe ka 60 skica të elementëve dhe strukturave ndërtimorë si dhe 134 foto.

Shtëpia botuese "Dr. Kovač" e cila e botoi për herë të parë këtë studim në gjermanisht, është një nga tre shtëpitë botuese më të rëndësishme në Gjermani për librin shkencor. Qëllimi kryesor i saj është furnizimi me botime cilësore, i bibliotekave shkencore dhe të universiteteve në vendet gjermanisht folëse, në bazë të kërkesave të tyre. Megjithatë ka raste, që librat e kësaj shtëpie botuese shpërndahen dhe përtej këtij rajoni, siç është rasti i librit në fjalë, i cili është shpërndarë edhe në vende të tjera të komunitetit Evropian dhe në SH.B.A.

Botimi dinjitoz në shqip i këtij libri nga shtëpia botuese ***Berk***, që duhet falënderuar për këtë nismë, është një ndihmesë në përhapjen e arritjeve shkencore nga studiuesit shqiptarë, si për specialistët e fushës së arkeologjisë dhe restaurimit ashtu edhe për publikun e gjerë kureshtar për njohjen e një kategorie kaq interesante të monumenteve. Duhet pranuar se botimi në gjuhën shqipe i punimeve të albanologëve shqiptarë, monografi e artikuj, dhe jo vetëm i tyre, është për t'u lavdëruar dhe njëherazi një domosdoshmëri për përhapjen e rezultateve më të fundit shkencore studiuesve vendas dhe të interesuarve për dije në këtë lëmë, por dhe një pasuri për bibliotekat e vendit.

Prof. Aleksandër MEKSI

GJERAK KARAISKAJ, *LATE ANTIQUITY AND MEDIEVAL FORTIFICATIONS IN ALBANIA, CITIES, FORTRESSES, CASTLES,*
Tirana 2021

Review

The monograph summarizes the fortifications of late antiquity and the Middle Ages, up to the period of the great Albanian Pashaliks. The detailed study of the fortifications in the territory of Albania arose as a necessary need in the service of drafting projects for the restoration, protection and preservation of their historical substance. It is the result of the author's decades of work during his restoration and research activity at the Institute of Cultural Monuments.

Through numerous comparisons and the use of historical sources, the place occupied by fortifications in Albania within the framework of great empires, relations and mutual influences in certain historical circumstances and periods is determined.

The monograph consists of eight chapters that deal with this genre of monuments, with a wide geographical scope, which includes the entire territory of Albania, from Late Antiquity throughout the Middle Ages (including the XIX century).

They deal with cities, castles and other defensive structures, their function, their form and typology, as well as, in details, all building elements in their variety. A special place is occupied by the presentation of operations against them (sieges) and weapons used over the centuries.

The book closes with a catalog of 51 medieval fortifications, accompanied by graphic documentation. The monograph does not lack auxiliary apparatus, mandatory data, such as references and bibliography used.

The dignified publication in Albanian of this book by the Berk Publishing House, which should be thanked for this initiative, is an aid to the dissemination of scientific achievements by Albanian scholars, both for specialists in the field of archeology and a basic source for restoration interventions, as well as even for the general public interested in recognizing such an interesting category of monuments.

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

PIRRO THOMO

VENDBANIME DHE BANESA FSHATARE NË SHQIPËRINË E VERIUT



As. Prof. Dr. Armand VOKSHI

PIRRO THOMO, *VENDBANIME E BANESA TË SHQIPËRISË VERIORE*, Tiranë, 2021

Recension

Ribotimin e librit "Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore" i Shtëpisë Botuese 8 nëntori të vitit 1981 e konsiderojmë si një botim të munguar prej shumë vitesh nga botimi i parë, tashmë prej kohësh i ezauruar në libraritë tona.

Monografia bart ende vlera të spikatura njohëse teorike e praktike. Së pari, ajo është rezultat i një veprimtarie shumëvjeçare gjurmuese në terren dhe duke i studiuar materialet e përftuara, është arritur në një studim përgjithësues e krahasues. Së dyti, shpërndarja e gjerë gjeografike e ekspeditave gjurmuese, nga Mali i Dajtit në jug e deri në krahinat e Malësisë së Mbishkodrës e të Valbonës në veri, por dhe matanë kufirit në krahinat e Rrafshit të Dukagjinit në Kosovë, ka siguruar evidentimin e një pasurie të paçmueshme të trashëgimisë ndërtimore.

Analiza historike, arkitektonike, konstruktive e dekorative e materialit, e ka shpënë autorin të na japë një kuadër të plotë të tipologjisë së tij, si dhe ndjekjen e evolucionit tipologjik, të cilat përbënin dhe bazën për argumentimin e përfundimeve të arritura.

Gjatë kësaj analize, në krahina të ndryshme janë vënë re tipare të ngjashme arkitektonike të ndërtesave. Ato, duke ruajtur të njëjtën zgjidhje planimetrike e funksionale, kanë variuar në formulimin arkitektonik të jashtëm, siç janë shembujt nga krahinat e masivit Qendror: Dibrës, Matit, Çermenikës, Malësisë së Krujës e Tiranës etj. Nga ana tjetër, banesat në krahina të ndryshme përfaqësojnë dhe faza të ndryshme të një linje zhvillimi, por ndërsa në disa krahina ajo mbetet në një stad të caktuar zhvillimi, në krahina të tjera mund të pësojë përpunime arkitektonike e konstruktive të mëtejshme, fenomen që e takojmë në krahinat e Hasit Malësisë së Gjakovës e Rrafshit të Dukagjinit, por dhe në krahinën e Matit, ku përpunimi konstruktiv i banesave çoi në formimin e banesave të fortifikuara, ose të Kullave. Këto ngjashmëri kanë dhënë mundësinë që krahinat e ndryshme të Shqipërisë Veriore të grupohen në njësi më të mëdha. Kështu janë veçuar grupe të mëdha krahinash që shtrihen në pjesën veriperëndimore, verilindore dhe në masivin qendror të Shqipërisë Veriore. Brenda këtij grupimi ka krahina ose dhe ndërtesa me tipare specifike arkitektonike ose me tipare të përziera të grupeve të ndryshme, por megjithatë ato nuk e cenojnë ndarjen e përgjithshme tipologjike.

Përveç këtyre edhe problemet e tjera të krijimit të veprave arkitektonike, si raporti ndërmjet programit dhe realizimit të veprës, ndërmjet faktorëve tipizim dhe larmi, lidhjet ndërmjet formulimit arkitektonik,

realizimit konstruktiv dhe përpunimit dekorativ dhe materialeve rrethanore, terrenit e përvojës së mjeshtërve të ndërtimit, nuk kanë mbetur jashtë vëmendjes në këtë trajtim. Vlera e monografisë qëndron dhe në faktin se autori ka operuar në një fushë thuajse të pa lëvruar, të paktën në lëmin e arkitekturës, duke e renditur atë radhën e studiuesve të parë dhe të pakët në këtë lëmë.

Monografia bart dhe vlera praktike, sepse krahas njohjes, dokumentimit dhe klasifikimit të kësaj pasurie kulturore të popullit tonë, ka shërbyer njëkohësisht dhe për vlerësimin, seleksionimin dhe përcaktimin e ekzemplarëve më përfaqësueses të çdo tipi banese ose të çdo hallke zhvillimi për t'u vënë në mbrojtje shtetërore me cilësimin e tyre si Monumente Kulture. Duke na dhënë një material më të gjerë se sa monumentet e mbrojtura, do të mund të gjykohet dhe mbi drejtësinë e vlerësimit për këto monumente.

Për vetë kërkesat dhe mundësitë e Shtëpisë Botuese, monografia "Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore" u botua me disa shkurtime dhe me cilësi jo të përshtatshme tipografike dhe në përputhje me karakterin e monografisë si një botim i fushës së arkitekturës.

Në këtë ribotim është synuar të plotësohet monografia me materiale të munguara nga botimi i parë, të përforcohet argumentimi i çështjeve të shtruara, si dhe të pasurohet në mënyrë sasiore e cilësore me material ilustrativ, pa cenuar idetë themelore të botimit të parë.

Shpreh bindjen se metodologjia e parashtrimit të materialit dhe rezultatet e arritura në këtë ribotim do të jenë të vlefshme për një rreth të gjerë studiuesish: për historianë e etnografë që do të njihen me organizimin ekonomik, shoqëror e familjar të popullsisë së krahinave në studim; restauratorë që do të gjejnë në monografi një material historik e autentik për hartimin e projekteve të restaurimit; inxhinierë e arkitektë, por dhe studentë për njohjen e traditave ndërtimore të popullit tonë.

As. Prof. Armand VOKSHI

PIRRO THOMO, *SETTLEMENTS AND DWELLINGS OF NORTHERN ALBANIA*, Tirana, 2021

Review

"Settlements and dwellings of northern Albania" is a valuable publication that carries outstanding theoretical and practical cognitive values. First, this publication is the result of many years of field research activity. By studying the obtained materials, a general and comparative study has been reached. Second, the wide geographical distribution of tracking expeditions, from Dajti Mountain in the south to the provinces of Malësia of Mbishkodra and Valbona in the north, but also across the border in the provinces of the Dukagjini Plain in Kosovo, has provided evidence of a wealth invaluable of our construction heritage.

The historical, architectural, constructive and decorative analysis of the material has led the author to give us a complete framework of his typology, as well as the pursuit of typological evolution, which were the basis for arguing the conclusions reached.

Apart from these, other problems of creating architectural works, such as the relationship between the program and the realization of the work, between the typification and variety factors, the connections between architectural formulation, constructive realization and decorative processing and circumstantial materials, the terrain and experience of construction masters, do not have remained out of focus in this treatment. The value of the monograph also lies in the fact that the author has operated in an almost unexplored field, at least in the field of architecture, ranking it among the first and few scholars in this field.

The monograph also carries practical value, because in addition to recognizing, documenting and classifying this cultural wealth of our people, it has also served for the evaluation, selection and determination of the most representative specimens of each type of housing or each development link to be placed in state protection with their designation as Cultural Monuments. By giving us a wider material than the protected monuments, it will be possible to judge on the fairness of the evaluation for these monuments.

The methodology of submitting the material and the results achieved in this reprint will be valuable for a wide circle of scholars: for historians and ethnographers who will be acquainted with the economic, social and family organization of the population of the provinces under study; restorers who will find in the monograph a historical and authentic material for the design of restoration projects; engineers and architects, but also students for the knowledge of the construction traditions of our people.

KRONIKË PUNIMESH RESTAURUESE

KISHA E SHËN E PREMTES, LUKOVË

Kisha e Shën e Premtes ngrihet në mes të ullishtave të fshatit Lukovë, në një pozitë piktoreske, prej nga hapet një pamje e gjerë e detit Jon.

Kisha është e tipit bazilikal me kupolë. Në mungesë të të dhënave epigrafike, mendohet se i përket shekullit XVII.

Endodhurjashtëfshatitdhepapërkujdesjemirëmbajtëse, kisha ishte pushtuar nga një bimësi e dendur. Pastrimi nga bimësia zbuloi një gjendje katastrofike me çarje të konsiderueshme në muraturë, degradim të sistemit të mbulesës së kurbëzuar, deri në rrënime të një pjese të saj. Ndërhyrjet konsoliduese konsistuan në rivendosjen e qëndrueshmërisë statike të monumentit dhe rikthimit të aftësisë mbajtëse të saj. Kjo u arrit me qepjet e të çarave, fugatimeve dhe injektimeve si në muraturë ashtu dhe në sistemin e mbulesës, rivendosjen e tirandave, të cilat mungonin në sistemin e mbulesës, si dhe në rikthimin e gjeometrisë së këtij sistemi, kur vëreheshin dëmtime të pjesshme.

Në këtë fazë të ndërhyrjeve u vendos që pjesët e rrëzuara të sistemit të kurbëzuar të mbulesës të mos rindërtoheshin, por pjesa e rrëzuar të mbulohej me çati druri.

Ndërhyrjet u kryen sipas projektit dhe kujdesit të IKTK dhe u realizuan nga Firma AD-STAR me drejtues Ing. Restaurator Alfred Çoma.





Fig. 1, 2. Kisha e pushtuar nga bimësia

Kisha e Shën e Premtes, Lukovë



3. Pjesë nga projekti i konsolidimit dhe restaurimit









4, 5, 6, 7. Gjendje e kishës mbas pastrimit të bimësisë





8. Rivendosja e tirandave 9. Mbulesa e pjesës së rrëzuar me çati druri



10. Monumenti mbas konsolidimit dhe restaurimit

NDËRHYRJE EMERGJENTE NË KISHËN E SHËN KOLLIT VODICË, KOLONJË

Kisha e Shën Kollit në Vodicë të Kolonjës është ndërtuar në vitin 1820 dhe i përket kishave të tipit njënefëshe me kupolë në pjesën qendrore të lartësuar mbi një tambur. Kupola mbështetet mbi katër pilastra që dalin nga qoshet e murit. Pjesa tjetër e naosit mbulohet me qemer guri dhe tavane. Në pjesën jugore të kishës ngrihet kambanorja me lartësi 10m. Kulla e kambanores është ndërtuar me mur guri çmërs të punuar.

Pas viteve 2000 në këtë objekt janë kryer ndërhyrje jo të pranueshme, si suvatime të mureve të gurit, vendosje breza b/a apo mbulesa me tjegulla që zëvendësoi mbulesën origjinale me rasa guri.

Kohët e fundit problem shqetësues ishte shfaqur qëndrueshmëria e kambanores, sidomos në mbështetjet e saj, të cilat kishin pësuar shmangie nga vertikaliteti dhe cedim në sipërfaqen e tokës, e cila, në bazë të vëzhgimeve të kryera, vazhdonte akoma. Nga matjet e kryera në vend në Mars të vitit 2019 inklinimi i kolonës ishte 15 cm, dhe në tetor 2020 inklinimi arriti në 20 cm. Gjithashtu në muret e kambanores vëreheshin çarje të konsiderueshme, degradim të tirandave të drurit, si dhe çarje të kupolave të saj.

Projekti i restaurimi i hartuar nga DRTK Korçë në vitin 2019 ishte i plotë, por duke u nisur nga gjendja aktuale u konkludua për ndërhyrje urgjente për konsolidimin e kambanores.

Ndërhyrjet për konsolidimin e kambanores konsistuan në:

- Pajantimin e tre arkadave të kambanores, të cilat u realizuan me materiale druri. Por duke marrë parasysh ngarkesat, dy arkadat anësore u plotësuan me mur tulle të plota për të rritur sigurinë mbas çmontimit të kolonave. Njëkohësisht, u realizua edhe pajantimi në faqen jugore të kambanores deri në 1/3 e lartësisë me tubo hekuri dhe panele druri.
- U realizua pajantimi i kreut të kolonave në katër qoshet e tyre me konstruksion hekuri
- Mbas përfundimit të pajantimit u krye çmontimi i kolonave (një nga një) dhe heqja e tirandave të drurit, të cilët ishin të degraduara dhe jashtë funksionit.
- Gurët e kolonave u sistemuan sipas radhës dhe u shënuan me numra për t'u rivendosur në pozicionet fillestare.
- Mbas kryerjes së sondazheve në themelet kolonave, u krye përforcimi i tyre. Në qendër të kolonave u vendosën profile dopjo "T" të mbështetura në pllaka metalike të fiksuara në përforcimin e themeleve me b/a.
- U krye zëvendësimi i tirandave të drurit me tiranda metalike, të cilët u veshën me dru.
- U realizuan qepjet e çarjeve në muret me metodën shqep-qep, konsolidimi i pjesës së suvatuar, fugatimet, si dhe qepja e çarjeve dhe restaurimi i kupolës në pjesën e kambanores.

Ndërhyrja në këtë monument u mundësua falë mbështetjes financiare të banorëve të fshatit Vodicë dhe Bashkisë Kolonjë dhe u realizua nga DRTK Korçë në bashkëpunim me IKTK, nën drejtimin e Ark. Res. Arben Spaho, Ark. Res. Amanda Cici dhe Ark. Res. Fotjon Qirinxhi.









Foto 1. Çarjet e mureve.

2 Çmontimi i kolonave.

3. Inklinimi i kolonave.

4. Mbas ndërhyrjes.







5. Numërimi i gurëve

6. Pajantimi

7. Qepja e çarjeve dhe fugatimi



8. Skica puntelimi

KISHA E SHËN SALVADORIT (SHPËTIMTARIT) NË RUBIK, MIRDITË

Në popull njihet me emrin kisha e Shelbuemit. Është ndërtuar mbi një breg shkëmbor, në hyrje të qytetit të Rubikut. Nga kisha e vjetër ruhet vetëm një pjesë, që sot luan rolin e mjedisit të altarit të kishës së re. Për datimin e saj na ndihmon përmendja e saj në vitin 1166 si "San Salvatori Arbanensis" dhe mbishkrimi në pikturën murale, që mban datën 1272.

Në përputhje me projektin e restaurimit u krye zhveshja e suvasë nga faqja lindore e kishës. Kujdes i veçantë iu kushtua apsidës të fazës fillestare të monumentit për të konstatuar elementet e fshehura nga suvatimi, të cilat do të na udhëheqin në restaurimin e saj. Përqendrimi i vëmendjes te apsida u bë për arsye se, ashtu si dhe në shumë monumente të kultit, është ky element që përmban ngarkesën më të madhe dekorative.

Mbas heqjes së suvasë u konstatua:

1. Elementet e formulimit arkitektonik e dekorativ, pilastrat dhe harqet në kreun e muraturës së apsidës ishin realizuar me gurë çmërsi.
2. Muratura e apsidës është realizuar me reshta të alternuar me gurë gëlqerorë dhe gurë çmërsi
3. Mbi gurët e çmërsit të muraturës dhe pilastrave kanë mbetur pjesë patine 3-5 mm. të realizuara me gëlqere dhe pluhur çmërsi, teknikë kjo jo e panjohur dhe në monumente të tjera.

Elementet e zbuluara çuan në këto përfundime:

1. Përdorimi i gurit çmërs, si material me cilësi të mira dekorative dhe lehtësisht i punueshëm, është gjetur si material tepër i përshtatshëm për trajtimin arkitektoniko-dekorativ në pilastrat dhe harqet.
2. Alternimi i radhëve me gurë çmërs me ato me gurë gëlqerorë nuk është bërë, veçse për qëllime dekorative.
3. Për të mbrojtur elementet prej çmërsit nga dëmtimet, ato janë veshur me një patinë, mbeturinat e së cilës janë ende të ruajtura mbi sipërfaqet e tyre.

Mbas zhveshjes nga suvatimi gjendja e muraturës dhe e elementeve dekorative duket e dëmtuar dhe vende-vende vërehen dhe thyerje pjesore.

Për punimet restauruese në vazhdim u propozua:

a) Përpunimi i muraturës me fugatime për të evidentuar qartë apsidën, si elementin më të rëndësishëm të monumentit.
b) Muratura e apsidës të ripërtërihet duke nxjerrë në dukje elementet dekorative dhe duke plotësuar pjesërisht ato pjesë që janë dëmtuar.
c) Në këtë fazë të restaurimit nuk do të rekomandonim patinimin e elementeve dekorative, por vetëm ruajtjen e tyre, si dëshmi e teknikës origjinale të monumentit.

Mbi gjendjen e kishës së re

Në gjendjen e sotme, me përjashtim të pamjes perëndimore, kisha është tërësisht e suvatuar. Sipas projektit, suvatimi duhet të meremetohet dhe të ruhet, përveç fazës së parë të monumentit.

Suvatimi i godinës është bërë vitet e fundit dhe për këtë është përdorur llaçi i çimentos, siç rezulton nga

analizat laboratorike. Është i ditur fakti se suvatimi me llaç çimentoje sjell pasoja negative në ndërtesën ku aplikohet. Ajo e mban lagështinë dhe, nga ana tjetër, ajo krijon një shtresë të papërshkueshme duke e mbajtur lagështinë në brendësi të ndërtesës dhe duke penguar ajrosjen e saj. Si rezultat, suvaja me llaç çimentoje nuk është jetëgjatë.

Nga këto pasoja negative nuk ka shpëtuar dhe suvatimi i monumentit në shqyrtim. Pa kaluar një kohë e gjatë nga bërja e suvatimit, vërehen dëmtime serioze të saj, dekompozime, rënie, mbufatjeje, dëmtime, të cilat, nuk janë të riparueshme. Por edhe në qoftë se pranohet ideja e meremetimit të suvasë, për arsye të pozicionit ku ndodhet monumenti, si tepër i ekspozuar ndaj agjentëve atmosferikë, si dhe për efektet negative të llaçit të çimentos, korrozioni i suvatimit do të jetë i vazhdueshëm. Për arsyet e parashtruara më sipër, u propozua që monumenti të zhvishet nga suvatimi.

Fotot historike, më të vjetrat nga të cilat datojnë të viteve ’50, dëshmojmë se në një fazë të caktuar historike monumenti ka qenë i pasuvatuar. Ato, si dhe sondazhet, dëshmojnë se në muraturë nuk ka munguar dhe përkujdesja dekorative. Elementet arkitektonike, dritaret e murosura, janë gjithashtu të dhëna të vlefshme për njohjen e historisë së monumentit.

Propozimet e mësipërme u miratuan nga KKTKM.

Në përfundim të punimeve dolën në dritë vlerat e vërteta historike e arkitektoniko-dekorative të monumentit, të cilat ishin të fshehura nga suvatimi i viteve të fundit.

Restaurimi i kishës së Shën Salvadorit (Shpëtimtarit) u mundësuan falë financimit të Bashkimit Evropian dhe mbështetjes shkencore të UNOPS-it dhe Ministrisë së Kulturës dhe u realizuan nga Firma AD-STAR, me Administrator Ing. Restaurator Alfred Çoma dhe me Drejtues Teknik Prof. Dr. Pirro Thomo.



1. Gjendja e monumentit para restaurimit



2. Foto historike kur monumenti ishte i pasuvatuar



3. Dekoracioni i apsidës i suvatuar







4. Gjurmë të dekoracionit të apsidës mbas zhveshjes së suvasë

5. Pamja e apsidës mbas restaurimit

6. Evidentimi i dekoracionit të apsidës mbas restaurimit



7. Foto historike kur monumenti ishte i pasuvatuar



8. Dëmtime të suvasë në kishën e re







9, 10, 11. Monumenti mbas restaurimit

KISHA E SHËN NDOIT NË KEPIN E RODONIT

Kisha e Shën Ndoit ndodhet pranë kalasë s*ë* Skënderbeut n*ë* Kepin e Rodonit. Sipas burimeve historike të vitit 1418 në këtë vend ngrihej një manastir i Shën Mërisë. Nga një dëshmi e vitit 1599 njohim që ky manastir, i cili tashmë festonte në memorie të Shën Andonit të Paduas, përfshihej në juridiksionin e Kishës Katolike dhe, m*ë* konkretisht *në urdhrin e françeskanëve. Sipas traditës*, manastiri ishte rindërtuar nga Mamica, motra e Gjergj Kastriot Skënderbeut. Sot kisha është e njohur si e Shën Andonit, Shnanoj me dialektin vendas, dhe blatimi i saj fillestar si e Shën Mërisë është harruar. Monumentin e vizitoi në fund të shek. XIX konsulli austriak Theodor Ippen (1861 - 1935), i cili publikoi një përshkrim mjaft të detajuar, disa fotografi, një plan dhe një skicë të pikturës murale të apsidës së kishës.

Tipologjikisht nga kompozimi planimetrik dhe ndërtimi strukturor kisha i përket tipit romanik, me pilastra në forme kryqi, mbulesë me qemer cilindrik dhe arkada në muret gjatësore. Në brendësi ruhen fragmente të pakta të pikturës murale.

Kisha kishte arritur në gjendje rrënoje, ndërsa në vitin 2000 u kryen ndërhyrje tërësore restauruese.

Ndërkohë tërmeti i nëntorit 2019 kishte shkaktuar dëmtime të konsiderueshme të strukturës mbajtëse. Në kuadrin e ndërhyrjeve për eliminimin e dëmtimeve të shkaktuara nga tërmeti edhe në monumentet e kulturës, u ndërmorën ndërhyrje konsoliduese, të cilat konsistuan në qepjen dhe injektimin e çarjeve, fugatime, si dhe plotësime të fragmenteve të rrëzuara apo të degraduara.

Ndërhyrjet konsoliduese u mundësuan falë financimit të Bashkimit Evropian dhe mbështetjes shkencore të UNOPS-it dhe Ministrisë së Kulturës dhe u realizuan nga Firma AD-STAR, me Administrator Ing. Restaurator Alfred Çoma dhe me Drejtues Teknik Prof. Dr. Pirro Thomo.





1, 2. Gjendja e kishës para restaurimit të vitit 2000





3,4. Pamje të kishës mbas restaurimit të vitit 2000









5-8. Dëmtime të monumentit nga tërmeti i nëntorit 2019

KULLA C E MUREVE FORTIFIKUESE TË DURRËSIT

Kulla C është pjesë e mureve fortifikuese të ndërtuara nga perandori i Bizantit Anastasi I (491-518), mbas dëmtimeve të tyre nga tërmeti i vitit 345, si dhe mbas shkatërrimeve që shkaktoi pushtimi i qytetit nga gotët në vitin 479. Dëmtimi që pësoi kulla nga tërmeti i nëntorit 2019, kur një pjesë e saj u rrëzua, nxorën në dritë disa të dhëna me rëndësi. Në fragmentet e rrëzuara u zbuluan shumë tulla me mbishkrime që përmbanin monogramin e perandorit Anastas. Në pjesën e mbetur mbas rrëzimit të një pjese të kullës u shfaqën shumë qartë fazat historike të ndërtimit. Nga tërmetet më të hershme, mbase nga tërmeti i vitit 1273, një pjesë e kullës së periudhës së Anastasit u rrëzua dhe gjatë viteve 1274-1280, e njohur dhe si periudha Anzhuine u bë rindërtimi i saj, por duke u tërhequr më në brendësi të kullës dhe duke e prishur trajtën e rregullt gjeometrike të saj. Në një fazë të tretë, gjatë shek. XVII, e njohur dhe si periudha e ndërhyrjes osmane, kësaj kulle i është bërë shtimi i një murature guri të pjerrët, për të përforcuar atë ekzistuesen.

Pjesët e rrëzuara nga tërmeti i nëntorit 2019 ishin të përmasave shumë të mëdha, mesatarisht 12 m3. Ky fakt krijoi idenë bazë të restaurimit, rivendosjen e blloqeve në vendin e origjinës, pra që rindërtimi i saj të bëhej më materialet sa më autentike.

Që të arrihej ky synim kërkohej një studim multidisiplinor:

- studimi historik evidentoi zhvillimin dhe ndryshimet në kohë të monumentit
- studimi arkeologjik me sondazhe dhe gërmime të pjesshme zbuloi themelet e fazës fillestare të kullës, kuotën e dyshemesë së pjesës së brendshme të kullës, si dhe gjendjen e muraturave dhe themeleve të zbuluara nga sondazhet. Gjithashtu, ato zbuluan ekzistencën e zgavrave të konsiderueshme në themelet e kullës, të cilat paraqisnin rrezikshmëri në qëndrueshmërinë e monumentit
- studimi i gjendjes statike të monumentit, përcaktimin e kapacitetit mbajtës të strukturës, përcaktimin e shkaqeve të kolapsit nga lëkundjet sizmike nëpërmjet analizës sizmike përmes llogaritjeve kinematike. Gjithashtu, me anë të provave laboratorike u përcaktuan vetitë fiziko-mekanike të materialeve të ndërtimit, tullave e llaçit. Me vendosjen e sensorëve u bë e mundur monitorimi i çarjeve në muraturë, qoftë dhe për një kohë të shkurtër
- studimi gjeoteknik na dha të dhëna mbi përbërjen e tabanit, thellësisë së themeleve, ndërsa eksplorimi me gjeoradar evidentoi prezencën e gjurmëve të themeleve të kullës.

Të dhënat e përftuara nga ky studim shumëplanësh shërbyen jo vetëm për plotësimin e projektit fillestar, por përcaktuan dhe radhën dhe mënyrën e ndërhyrjeve, të cilat konsistuan në:

- Dokumentimin e saktë të blloqeve të rrëzuar
- Largimin e blloqeve të rrëzuar nga vendi mbas rrëzimit
- Puntelimin e pjesës së mbetur të kullës për shmangien e ndonjë rreziku eventual

- Konsolidimin e pjesëve të mbetura të kullës, mureve të periudhës bizantine dhe anzhuine me fugatime, plotësime të pjesshme të fragmenteve munguese, qepjeve, injektimeve, konsolidimin e themeleve
- Mbushje e zgavrave të zbuluara në themelet e kullës
- Rivendosja e blloqeve të rrëzuar në vendet e origjinës
- Paralelisht me rivendosjen e blloqeve u krye dhe qepja e pjesëve të veçanta të kullës për të krijuar kompaktësinë e gjithë strukturës dhe sigurimin e një konturi të mbyllur, si masë efikase mbrojtëse nga lëkundjet sizmike
- Plotësimin e muraturës munguese të mbetur mbas rivendosjes së blloqeve të rrëzuar.

Projektimi dhe restaurimi i kullës C të kalasë së Durrësit u krye nga CHwB-Shqipëri nga ark. Restauratore Lejla Hadzic, Elena Mamami, Stavri Burda etj., me konsulencën shkencore të Prof. Dr. Gjerak Karaiskaj dhe Prof. Dr. Pirro Thomo dhe me mbështetje teknike nga Laboratori ALTEA & Gjeostudio, me drejtues Ing. Gjeolog Skënder Allkja, dhe Studioja Teknike AVE CIONSULTING, me Ing. Konstruktorë Arben Dervishaj dhe Ervin Paci, dhe u realizuan nga Firma AD-STAR, me drejtues Alfred Çoma. Projektimi dhe restaurimi u mundësuan falë mbështetjes financiare të Fondit të Ambasadorit për Trashëgiminë Kulturore (AFCP), Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit për Zhvillimin Ndërkombëtar (SIDA) dhe mbështetjes shkencore të Fondit Botëror të Monumenteve dhe Ministrisë së Kulturës.



1. Gjendja mbas restaurimit të 2009



2.Kolapsi i kullës nga Tërmeti









3.Gjendja mbas Tërmetit



4. Spostimi i blloqeve të rrëzuar



5. Përforcime të kullës



6. Sondazhe me gjeoradar për zbulimin e gjurmëve të themelit të Kullës



7. Sondazhe gjeologjike



8. Vendosja e sensorëve



9. Gjetje arkeologjike



10. Punime konsolidimi



11. Përgatitja e bazamentit





12.1,2. Vendosja e blloqeve në vendin e origjinës

NDËRHYRJE EMERGJENTE NË KULLËN E SAHATIT NË KALANË E KRUJËS

Kalaja e Krujës ngrihet mbi një masiv shkëmbor të shkëputur nga mali Sarisalltëk dhe formacionet shkëmbore përreth. Është një nga monumentet më të vlefshëm për komunitetin vendas të Krujës, simbol i qëndresës së parë shqiptare kundër osmanëve me në krye Skënderbeun, heroin tonë kombëtar.

Kulla e Sahatit në kalanë e Krujës mendohet se është ndërtuar rreth shekullit XI-XII, fillimisht si një kullë vëzhgimi dhe sinjalizimi, e cila ishte e pajisur edhe me një kambanë. Në pjesën e poshtme të saj, mund të dallohet teknika e periudhës bizantine, muraturë guri e kombinuar me rreshta tullash.

Tërmeti i vitit 1617 duket se ka shkaktuar dëme në pjesën e sipërme të Kullës së Sahatit. Ndërhyrjet që pasuan ndryshuan formën e trungut të piramidës, të lexueshme qartë në fasadat jugperëndimore dhe juglindore, ku baza më e gjerë e fazës së mëparshme rruhet akoma. Tërmeti i vitit 2019 që goditi Shqipërinë e Mesme, shkaktoi dëme të mëdha në muret e kullës, veçanërisht në pjesën e sipërme, duke rrezikuar dhe shembjen e saj.

Në vitin 2019, CHwB-Shqipëri, falë mbështetjes së Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit për Zhvillimin Ndërkombëtar (SIDA), Fondit Princ Klaus dhe mbështetjes shkencore të Fondit Botëror të Monumenteve dhe Ministrisë së Kulturës, filloi procesin e restaurimit që ndjek tre faza ndërhyrjesh:

- Faza 1 – Stabilizimi emergjent
- Faza 2 – Projektimi i masave konservuese
- Faza 3 – Implementimi i punimeve konservuese

Qëllimi i fazës së parë është të zvogëlojë në një periudhë afatshkurtër rrezikun e kolapsit, ndërkohë që është duke u hartuar ndërhyrja përfundimtare. Stabilizimi emergjent do të përmirësojnë kapacitetin e strukturës për një periudhë të konsiderueshme kohe, duke krijuar mundësi për dokumentimin e mëtejshëm të kullës, si dhe realizimin e projektit përfundimtar të konservimit.

CHwB Albania do të marrë në konsideratë edhe çështjen e përforcimit të bazës shkëmbore, problem ky që do të trajtohet në një projekt të veçantë, por që ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin e kullës.

Hapat e ndërhyrjes stabilizuese:

Përforcimi paraprak, kryesisht në 2/3 e vëllimit të sipërm të kullës, duke përdorur fasha poliesteri dhe pajanda druri.

Konsolidimi i muraturës së kullës në pjesët ku ka dëmtime të rënda.

Përforcim i plotë i kullës me elemente unazore çeliku të tensionuar.

Monitorim digjital i vazhdueshëm i çarjeve.



Fig.1,2 Kulla e Sahatit pas tërmetit të nëntorit 2019





Fig. 3 Kulla e Sahatit pas tërmetit të nëntorit 2019.
Fig. 4 Vendosja e pajandave të drunjta dhe fashave të poliesterit.



Fig.5 Vendosja e pajandave të drunjta në nivelin e kolonadës.



Fig.6 Plotësimi dhe konsolidimi i muraturës në kulmin perëndimor nën kolonadë.









Fig.7 Plotësimi dhe konsolidimi i muraturës së brendshme në fasadën jugperëndimore.

Fig.8 Vendosja e pllakave dhe tirandave të çelikut.

Fig.9 Elementet e tensionimit të kavove të çelikut.

Fig.10 Elementet e ndërhyrjes stabilizuese të aplikuar.



Fig.11 Matësit digjitalë të çarjeve të pozicionuar në muraturën e brendshme.

KISHA E SHËN THANASIT, VOSKOPOJË

Ato pak gjëra të çmueshme që kanë arritur të shpëtojnë dhe që dëshmojnë për shkëlqimin kulturor dhe fuqinë ekonomike të Voskopojës gjatë shek. 18, e cila është periudha më kulmore e zhvillimit të qytetit, janë dhe kishat e saj, pa studimin e të cilave historia e Voskopojës nuk do të ishte e plotë. Një nga ato është dhe kisha e Shën Thanasit, e cila ngrihet në pjesën verilindore të qytetit, në lagjen e dikurshme të Shën Thanasit ose të Skamnelit.

Dy mbishkrime na japin si datë ndërtimi vitin 1724, ndërsa një i tretë vitin 1721. Mbishkrimi i katërt na njeh me piktorët korçarë Konstandini dhe Athanasi, të cilët e pikturuan në vitin 1745. Një mbishkrim tjetër me shumë interes na njeh me mjeshtrit e ndërtimit, për të cilët në përgjithësi të dhënat janë shumë të pakta. Ata kanë qenë Adhronisi, Mihali, Pavli, Manthoja dhe Kosta nga fshati Krimi i Kosturit, emrat e të cilëve janë të gdhendura në dy kryqe që dekorojnë hajatin e kishës.

Nga ana tipologjike kisha i përket të njëjtit tipi arkitektonik, si dhe tri kishat e tjera të Voskopojës të së njëjtës periudhë: ato janë bazilika trenefëshe, të mbuluara me një sistem harqesh, qemerësh e kalotash sferike.

Nga ana kompozicionale këto bazilika janë të përbëra nga naosi, narteksi nga ana perëndimore dhe hajati nga ana jugore. Por të gjitha këto pjesë kompozicionale ruhen të plota vetëm në kishën e Shën Kollit, ndërsa në atë të Shën Thanasit është prishur narteksi.

Teknika e ndërtimit është mjaft solide. Muratura është ndërtuar me gurë të skuadruar të lidhura me llaç gëlqereje me fugatura shumë të holla. Një përkujdesje më të madhe dekorative ka apsida dhe, në mënyrë të veçantë, hajati, ku përpunimi dekorativ është arritur nëpërmjet kombinimit të gurit poroz prej çmërsi me tulla, që të dy materiale me ngjyra të ngrohta, si dhe nga përdorimi i bollshëm i motiveve të shumëllojshme dekorative të realizuara me tulla, tjegulla e gurë çmërsi, si korniza në formë kurrizpeshku, kryqe, bredha të stilizuara, pjata qeramike të smaltuara etj.

Ndërkohë, dëmtimi i strukturës mbajtëse dhe rrjedhimisht i mbulesës me tjegulla të çatisë, rrezikonte dhe dëmtimin e pikturës murale me një vlerë të lartë artistike, kështu që ndërhyrjet konsistonin në konsolidimin e sistemit të kurbëzuar të mbulesës, si dhe restaurimin e strukturës dhe mbulesës së çatisë.

Ndërhyrja u mundësua falë financimit të ABI Bank (American Bank of Investments), dhe u realizua nga Firma AD-STAR me drejtues Ing. Restaurator Alfred Çoma.



1. Tipologjia e kishës



2. Pamja jugperëndimore



3. Piktura murale



4. Dekoracioni i hajatit me emrat e mjeshtërve



5. Gjendja e interierit nga dëmtimi i çatisë



6. Dëmtimi i çatisë



7. Gjatë punimeve të restaurimit